



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Nr. 31 Regj. Them.
Datë regjistrimi 13.05.2026

Nr. 31 Vendimi
Datë vendimi 10.06.2026

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”
“CAKTIM MASE SIGURIMP”

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga:

GJYQTARE – FLOJERA DAVIDHI

Në dhomë këshillimi, sot më datë 10.06.2026, ditë e mërkurë, ora 12:00, pasi mora në shqyrtim mbi aktet, çështjen penale me nr. 31 regj.them., datë regjistrimi 13.05.2026, që i përket:

Kërkues: Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorët Elida Kaçkini dhe Altin Dumani.

Objekti: Caktimin e masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues, për personat nën hetim, si më poshtë vijon:

Personat nën hetim: 1. Ardian Zykaj, i biri i Zykë dhe Selvi, i datëlindjes 16.08.1970, me nr. personal H00816134J, lindur në Vlorë dhe banues në rrugën “Llazar Pulluqi”, nd. 11, h. 1, ap. 10, NjA 5, Tiranë, me gjendje civile beqar, me një fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, *alias Blerim Miftari*, datëlindja 02.02.1974, me kartë identiteti kosovare me nr. ID0346115 dhe pasaportë Kosovare me nr. P00815094, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Trafikimi i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “Grup i strukturuar kriminal” dhe “Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

2. Alfredo Hamzai, i biri i Sali dhe i Dallandyshe, lindur më 19.06.1972, në Vlorë, me nr. personal H20619083S, lindur në Vlorë dhe banues në rrugën “Demokracia”, nd. 001, Vlorë, me gjendje civile i divorcuar, me dy fëmijë, me gjendje gjyqësore i dënuar (jashtë Shqipërisë), *alias Genc Bedini*, dtl.

17.11.1974 me numër dokumenti kosovar ID1547638 dhe numër pasaporte P01644289, *alias Genci Tanasi*, dtl. 13.08.1972, me numër personal 1408972450130 dhe numër pasaporte të Maqedonisë së Veriut K1187590, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal.

3. Adrian Rama, i biri i Besnik dhe Drita, i datëlindjes 26.08.1983, lindur në Tiranë dhe banues në rrugën “Abdyl Frashëri”, h.1, nd. 1814, ap. 19, Tiranë, me nr. personal I30826059T, me gjendje civile i divorcuar, pa fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/1, 334/1 të Kodit Penal.

4. Erjon Rama, i biri i Besnik dhe Drita, i datëlindjes 05.03.1986, lindur në Tiranë dhe banues në rrugën “Shyqyri Ishmi”, nd. 20, h. 1, NjA 2, Tiranë, me nr. personal I60305071N, me gjendje civile beqar, me një fëmijë të mitur, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/2, 334/1 i Kodit Penal.

5. Orgest Birçaj, i biri i Fatosh dhe i Filoreta, i datëlindjes 15.05.1983, lindur në Vlorë dhe banues në rrugën “Mevlan Halim Dervishaj”, nd. 33, h.1, Vlorë, me nr. personal I30515124P, me gjendje civile beqar, me një fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/2 e 334/1 të Kodit Penal.

6. Orest Sota, i biri i Lifter dhe i Antoneta, i datëlindjes 04.01.1992, lindur në Vlorë dhe banues në rrugën “Grigor Heba”, nd. 1831, në Tiranë, me nr. personal J20104040Q, me gjendje civile beqar, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë*

kriminale”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

7. Elton Memeti, i biri i Gjergji dhe Floresha, i datëlindjes 17.07.1984, lindur në Tepelenë dhe banues në rrugën “Naim Frashëri”, nd. 60, h. 3/5, ap. 21, NjA 7, Tiranë, me nr. personal I40717083O, me gjendje civile beqar, pa fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

8. Artur Shehu, i biri i Ramis dhe Enise, i datëlindjes 29.07.1966, lindur në Vlorë dhe banues në SHBA, me nr. personal G60729063O, shtetas shqiptar dhe i pajisur me pasaportë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal.

9. Leonard Bishaj, i biri i Ferik dhe Drite, datëlindja 24.03.1969, lindur në Vlorë dhe banues në rrugën “Murat Tërbaçi”, nd. 73, h.3, ap. 19, Vlorë, me nr. personal G90324083R, me gjendje civile i martuar me dy fëmijë madhorë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

10. Arben Ismailaj, i biri i Kadri dhe i Sefire, lindur më 13.08.1963, lindur në Vlorë dhe banues në rrugën “Ymer Rahima”, nd. 19, h. 5, ap. 5, Vlorë, me nr. personal G30813102F, me gjendje civile i martuar, me dy fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*” parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

11. Edmond Jaupi, i biri i Sami dhe Pëllumbesh, datëlindja 21.09.1975, lindur në Tepelenë dhe banues në rrugën “Bajram Curri”, p. 23-1-1, nd. 034, NjA 5,

Tiranë, me nr. personal H50921098S, me gjendje civile i martuar, me dy fëmijë madhorë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*” kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenet 287/3 të Kodit Penal.

12. Besnik Myftari, i biri i Haziz dhe i Hatixhe, i datëlindjes 14.04.1968, me nr. personal G80414170N, lindur në Tiranë dhe banues në rrugën “Ismail Qemali”, nd. 18, h. 3, ap. 10, NjA 5, Tiranë, me gjendje civile i martuar, me tre fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë parashikuar nga neni 287/3 të Kodit Penal.

13. Dritan Aga, i biri i Dalip dhe i Ruzhdies, i datëlindjes 11.11.1981, lindur në Tiranë dhe banues në rrugën “Pjetër Budi”, nd. 19, h. 4, Ap. 26, NjA 2, Tiranë, me nr. personal I11111036A me gjendje gjyqësore beqar, me dy fëmijë të mitur, me gjendje gjyqësore i dënuar më parë, “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

14. Luçiano Koçeku alias **Artur Mersin Koçeku**, i biri i Mersim dhe i Sulltane, i datëlindjes 25.01.1982, me nr. personal I20125096T, lindur në Bulqizë Dibër dhe banues në rrugën “Erisa Fatmir Poleshi”, Nd 83, H.1, Paskuqan, 1047, Kamëz, me gjendje civile beqar, me tre fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për veprat penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

15. Dino alias **Abedin Koçeku**, i biri i Mersim dhe i Sulltane, i datëlindjes 18.04.1975, me nr. personal H50418100F, i lindur në Fushë Lurë dhe banues në rrugën “Abdyl Elmazi”, Nd 174, H.1, Paskuqan, 1047, Kamëz, me gjendje civile i divorcuar, me fëmijë, me gjendje civile i martuar, me shtetësi shqiptare, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

16. Ervin Koçeku, i biri i Mersim dhe i Sulltane, i datëlindjes 24.02.1986, me nr. personal I60224104R, lindur në Bulqizë, Dibër dhe banues në rrugën “Erisa Fatmir Poleshi”, Nd 85, H.1, Paskuqan, 1047, Kamëz, me gjendje civile i martuar me tre fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë i dyshuar për

kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

17. Astrit Vladi, i biri i Shaqir dhe i Mendie, i datëlindjes 17.05.1976, me nr. personal H60517084R, lindur në Armollë dhe banues në rrugën “Migjeni”, nd. 16, H1, Njësia Administrative nr. 11, 1026, Tiranë, me gjendje civile i martuar me dy fëmijë, aktualisht i arrestuar për llogari të një procedimi tjetër, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

18. Kastriot Vladi, i biri i Shaqir dhe i Mendie, i datëlindjes 18.04.1986, me nr. personal I60418022I, lindur në Fushë-Luë Dibër dhe banues në rrugën “Ilia Plasa”, Nd 13; H 1, Njësia Administrative nr. 11; 1029, Tiranë, me gjendje civile i martuar, me gjendje i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

19. Gëzim Islami, i biri i Vehap dhe i Qete, i datëlindjes 15.04.1963, me nr. personal G80415340L, i lindur në Herbel Dibër dhe banues me rrugën “Koli Bano”, Nd 15, H.1, Ap 1, Njësia Administrative nr. 11, Njësia bashkiake nr 11; 1026 Tiranë, me gjendje civile i martuar me fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

20. Ilir Shtufi, i biri i Xhemal dhe i Zonjë, i datëlindjes 13.10.1973, me nr. personal H31013090C, lindur në Tiranë dhe banues në adresën rrugën “Kajo Karafili”, nd .14, hyrja 2 apt 53, Njësia Administrative nr. 10, Tiranë, me gjendje civile i martuar, me fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë; i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim, në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.



Baza ligjore:

Nenet 244, 230, 237, 238, 242, 228, 229 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të cilët kanë kërkuar ndaj personave nën hetim **Ardian Zykaj (alias Blerim Miftari), Alfredo Hamzai (alias Genc Bedini, alias Genci Tanasi), Adrian Rama, Orgest Birçaj, Orest Sota, Elton Memeti, Artur Shehu, Arben Ismailaj, Dritan Aga, Luçiano Koçeku (alias Artur Mersin Koçeku), Dino alias Abedin Koçeku, Ervin Koçeku, Astrit Vladi, Kastriot Vladi, Ilir Shtufi**, caktimin si masë sigurimi personale shtrënguese atë të “*arrestit në burg*”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale; ndaj personave nën hetim **Gëzim Islami, Leonard Bishaj, Edmond Jaupi, Besnik Myftari, Erjon Rama**, caktimin si masë sigurimit personale shtrënguese atë të “*arrestit në shtëpi*”, parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale; të dyshuar për kryerjen e veprave penale respektive, si dhe mori në shqyrtim dhe administroi të gjitha provat shkresore të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar,

VËREN SE:

I. Procedura

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr. 287, të vitit 2021 për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale*” kryer në formën e bashkëpunimit të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal dhe “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale apo grupi i strukturuar kriminal*” parashikuar nga nenet 287 e 28/4, 333/a dhe 334/1 i Kodit Penal të Republikës të Shqipërisë.

Në datën 07.05.2024 është shtuar vepra penale e “*Trafikimit të lëndëve narkotike*” e kryer në formën e bashkëpunimit të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a dhe 28/4 të Kodit Penal.

Në datën 11.05.2026 është urdhëruar regjistrimi në regjistrin e njoftimit të veprave penale si person që i atribuohet vepra penale emri i shtetasve **Alfredo Hamzai, Ardian Zykaj, Adrian Rama, Artur Shehu, Leonard Bishaj, Arben Ismailaj, Elton Memeti, Erjon Rama, Edmond Jaupi, Besnik Myftari, Orgest Birçaj, Orest Sota, Dritan Aga, Luçiano Koçeku, Astrit Vladi, Kastriot Vladi, Dino Koçeku, Ervin Koçeku, Gëzim Islami, Ilir Shtufi**.

Në datën 12.05.2026 është ndarë procedimi penal duke u numërtuar me numër 287/1 të vitit 2021 në ngarkim të personave nën hetim të lartpërmendur.

Në datën 13.05.2026, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në vijim referuar si Gjykata ose Gjykata e Posaçme) duke paraqitur kërkesën objekt gjykimi, sikurse është cituar në pjesën hyrëse të këtij vendimi gjyqësor.

Përpara shqyrtimit të çështjes, Gjykata analizoi kryesisht (*proprio motu*) nëse ka juridiksion për shqyrtimin e çështjes, si dhe nëse ka kompetencë lëndore për gjykimin e saj në referim të neneve 74¹ dhe 75/a² të K.Pr.Penale. Ky është një parakusht procedural, pasi nëse një gjykatë nuk ka juridiksion dhe kompetencë për të gjykuar të akuzuarin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është e “krijuar me ligj”, sipas kuptimit të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane³.

Marrë në konsideratë përcaktimet e bëra nga neni 69⁴ i K.Pr.Penale, si dhe faktin se procedimi penal nr. 287/1 i vitit 2021 i Prokurorisë së Posaçmë është regjistruar dhe po hetohet në vijim, ndër të tjera, edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 333/a të K.Penal, bazuar në nenin 75/a, shkronja “b” të K.Pr.P. e që parashikon se: “**Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykon: ... b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal**”, Gjykata e Posaçme është kompetente për gjykimin e çështjes objekt shqyrtimi.

Në zbatim të parimit themelor kushtetues për një gjykim të drejtë nga një gjykatë e krijuar me ligj⁵, kompetente, e pavarur dhe e paanshme (neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ) gjykimi i çështjes u bë me trup gjykues të përbërë nga 1 (një) gjyqtar, pasi në zbatim të nenit 13, pika 2⁶ të K.Pr.Penale, kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake gjykohen në shkallë të parë nga një gjyqtar, ndërsa gjyqtarja në fjalë rezulton të jetë gjyqtare e hetimeve paraprake të procedimit penal nr. 287/1 të vitit 2021 të Prokurorisë së Posaçme, duke qenë se ky procedim është i ndarë nga ai 287 i vitit 2021 dhe gjyqtarja është gjyqtare e hetimeve paraprake në kuadër të këtij procedimi penal.

Gjyqtarja e çështjes, mori kërkesën penale në shqyrtim, në dhomë këshillimi, në referim të nenit 244, pika 1 të K.Pr.Penale, dhe duke qenë se vendimi jepet i arsyetuar, patur në konsideratë volumin e

¹ Ky nen parashikon se: “1. Gjykata e rrethit gjyqësor është kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”.

² Ky nen parashikon se: “Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet ...244, paragrafi 2, ...259, paragrafi 2... të Kodit Penal; b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal...”.


³ Vendimi nr.11, datë 23.04.2009 i Gjykatës Kushtetuese.

⁴ Ky nen parashikon se: “1. Juridiksioni penal ushtrohet nga gjykatat penale sipas rregullave të caktuara në këtë Kod. 2. Gjykata penale shqyrton gjithçka që është e nevojshme për marrjen e vendimit dhe vendos sipas rregullave të caktuara me ligj”.

⁵ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 18.05.2005; nr. 14, datë 17.04.2007 ka argumentuar ndër të tjera se: “...faza “gjykatë ... e caktuar me ligj” në nenin 42/2 të Kushtetutës mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështje konkrete”.

⁶ Neni 13/2 parashikon se: “Gjykatat e rretheve gjyqësore dhe Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykojnë me një gjyqtar: a) kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake;...”.

kërkesës, po ashtu të fashikujve hetimorë, dhe kompleksitetin e çështjes, gjykata disponoi përfundimisht për kërkesën e prokurorëve më datë 10 qershor 2026.



II. Rrethanat e faktit dhe burimet e provave

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr. 287, të vitit 2021 për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale*” kryer në formën e bashkëpunimit të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal dhe “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale apo grupi i strukturuar kriminal*” parashikuar nga nenet 287 e 28/4, 333/a dhe 334/1 i Kodit Penal të Republikës të Shqipërisë.

Në datën 07.05.2024 është shtuar vepra penale e “*Trafikimit të lëndëve narkotike*”, e kryer në formën e bashkëpunimit të veçantë, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a dhe 28/4 të Kodit Penal.

Në datën 11.05.2026 është urdhëruar regjistrimi në regjistrin e njoftimit të veprave penale si person që i atribuohet vepra penale emri i shtetasve **Alfredo Hamzai, Ardian Zykaj, Adrian Rama, Artur Shehu, Leonard Bishaj, Arben Ismailaj, Elton Memeti, Erjon Rama, Edmond Jaupi, Besnik Myftari, Orgest Birçaj, Orest Sota, Dritan Aga, Luçiano Koçeku, Astrit Vladi, Kastriot Vladi, Dino Koçeku, Ervin Koçeku, Gëzim Islami, Ilir Shtufi.**

Në datën 12.05.2026 është ndarë procedimi penal, duke u numërtuar me numër 287/1 të vitit 2021, në ngarkim të personave nën hetim të lartpërmendur.

II. Rrethanat e faktit dhe burimet e provave

1.1 Nga tërësia e hetimeve të kryera në kuadër të këtij procedim penal rezulton se janë grumbulluar prova nga të cilat krijohet dyshimi i arsyeshëm për caktimin e masave të sigurimit personal shtrëngues për personat nën hetim si më poshtë vijon:

- 1) **Ardian Zykaj**, i biri i Zykë dhe Selvi, i datëlindjes 16.08.1970, me nr personal H00816134J, lindur në Vlorë dhe banues në rrugën L Lazar Pulluqi, nd. 11, h. 1, ap. 10, NjA 5, Tiranë, me gjendje civile beqar, me një fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, *alias Blerim Miftari*, datëlindja 02.02.1974, me kartë identiteti Kosovare me nr. ID0546115 dhe pasaportë Kosovare me nr. P00815094, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.
- 2) **Alfredo Hamzai**, i biri i Sali dhe i Dallandyshe, lindur më 19.06.1972, në Vlorë, me nr. personal H20619083S, lindur në Vlorë dhe banues në Rrugën Demokracia, nd. 001, Vlorë, me gjendje civile i divorcuar, me dy fëmijë, me gjendje gjyqësore i dënuar (jashtë Shqipërisë), *alias Genc*

Bedini, dtl. 17.11.1974 me numër dokumenti kosovar ID1547638 dhe numër pasaporte P01644289, *alias Genci Tanasi*, dtl. 13.08.1972, me numër personal 1408972450130 dhe numër pasaporte të Maqedonisë së Veriut K1187590, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal.

- 3) **Adrian Rama**, i biri i Besnik dhe Drita, i datëlindjes 26.08.1983, lindur në Tiranë dhe banues në rrugën Abdyl Frashëri, h.1, nd. 1814, ap. 19, Tiranë, me nr. personal I30826059T, me gjendje civile i divorcuar, pa fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/1, 334/1 të Kodit Penal.
- 4) **Erjon Rama**, i biri i Besnik dhe Drita, i datëlindjes 05.03.1986, lindur në Tiranë dhe banues në rrugën Shyqyri Ishmi, , nd. 20, h. 1, NjA 2, Tiranë, me nr. personal I60305071N, me gjendje civile beqar, me një fëmijë të mitur, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/2, 334/1 i Kodit Penal.
- 5) **Orgest Birçaj**, i biri i Fatosh dhe i Filoreta, i datëlindjes 15.05.1983, lindur në Vlorë dhe banues në rrugën Mevlan Halim Dervishaj, nd. 33, h.1, Vlorë, me nr. personal I30515124P, me gjendje civile beqar, me një fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/2 e 334/1 të Kodit Penal.
- 6) **Orest Sota**, i biri i Lefter dhe i Antoneta, i datëlindjes 04.01.1992, lindur në Vlorë dhe banues në rrugën Grigor Heba, nd. 1831, në Tiranë, me nr personal J20104040Q, me gjendje civile beqar, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

- 7) **Elton Memeti**, i biri i Gjergji dhe Floresha, i datëlindjes 17.07.1984, lindur në Tepelenë dhe banues në rrugën Naim Frashëri, nd. 60, h. 3/5, ap. 21, NjA 7, Tiranë, me nr. personal I40717083O, me gjendje civile beqar, pa fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale "*Trafikimi i narkotikëve*", kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, "*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*", kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, "*Grup i strukturuar kriminal*" dhe "*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.
- 8) **Artur Shehu**, i biri i Ramis dhe Enise, i datëlindjes 29.07.1966, lindur në Vlorë dhe banues në SHBA, me nr. personal G60729063O, shtetas shqiptar dhe i pajisur me pasaportë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale "*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*", kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, "*Grup i strukturuar kriminal*" dhe "*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal.
- 9) **Leonard Bishaj**, i biri i Ferik dhe Drite, datëlindja 24.03.1969, lindur në Vlorë dhe banues në rrugën Murat Tërbaçi, nd. 73, h.3, ap. 19, Vlorë, me nr. personal G90324083R, me gjendje civile i martuar me dy fëmijë madhorë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale "*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*", kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, "*Grup i strukturuar kriminal*" dhe "*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.
- 10) **Arben Ismailaj**, i biri i Kadri dhe i Sefire, lindur më 13.08.1963, lindur në Vlorë dhe banues në Rrugën Ymer Rahima, nd. 19, h. 5, ap. 5, Vlorë, me numër personal G30813102F, me gjendje civile i martuar, me dy fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale "*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*", kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, "*Grup i strukturuar kriminal*" dhe "*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*" parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.
- 11) **Edmond Jaupi**, i biri i Sami dhe Pëllumbesh, datëlindja 21.09.1975, lindur në Tepelenë dhe banues në Rrugën Bajram Curri, p. 23-1-1, nd. 034, NjA 5, Tiranë, me nr. personal H50921098S, me gjendje civile i martuar, me dy fëmijë madhorë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale "*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*" kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenet 287/3 të Kodit Penal.
- 12) **Besnik Myftari**, i biri i Haziz dhe i Hatixhe, i datëlindjes 14.04.1968, me nr. personal G80414170N, lindur në Tiranë dhe banues në rrugën Ismail Qemali, nd. 18, h. 3, ap. 10, NjA 5, Tiranë, me gjendje civile i martuar, me tre fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i

dyshuar për kryerjen e veprave penale *“Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”*, kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë parashikuar nga neni 287/3 të Kodit Penal

- 13) **Dritan Aga**, i biri i Dalip dhe i Ruzhdies, i datëlindjes 11.11.1981, lindur në Tiranë dhe banues në rrugën Pjetër Budi, nd. 19, h. 4, Ap. 26, NjA 2, Tiranë, me nr. personal I11111036A me gjendje gjyqësore beqar, me dy fëmijë të mitur, me gjendje gjyqësore i dënuar më parë, *Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, *“Grup i strukturuar kriminal”* dhe *“Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”*, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.
- 14) **Luçiano Koçeku** alias **Artur Mersin Koçeku**, i biri i Mersim dhe i Sulltane, i datëlindjes 25.01.1982, me numër personal I20125096T, lindur në Bulqizë Dibër dhe banues në rrugën ‘Erisa Fatmir Poleshi’, Nd 83, H.1, Paskuqan, 1047, Kamëz, me gjendje civile beqar, me tre fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për veprat penale *“Trafikimi i narkotikëve”*, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, *“Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”*, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, *“Grup i strukturuar kriminal”* dhe *“Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”*, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.
- 15) **Dino** alias **Abedin Koçeku**, i biri i Mersim dhe i Sulltane, i datëlindjes 18.04.1975, me numer personal H50418100F, i lindur në Fushë Lurë dhe banues në rrugën ‘Abdyl Elmazi, Nd 174, H.1, Paskuqan, 1047’, Kamëz, me gjendje civile i divorcuar, me fëmijë, me gjendje civile i martuar, me shtetësi shqiptare, i dyshuar për kryerjen e veprave penale *“Trafikimi i narkotikëve”*, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, *“Grup i strukturuar kriminal”* dhe *“Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”*, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.
- 16) **Ervin Koçeku** i biri i Mersim dhe i Sulltane, i datëlindjes 24.02.1986, me numër personal I60224104R, lindur në Bulqizë, Dibër dhe banues në rrugën ‘Erisa Fatmir Poleshi’, Nd 85, H.1, Paskuqan, 1047, Kamëz, me gjendje civile i martuar me tre fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë i dyshuar për kryerjen e veprave penale *“Trafikimi i narkotikëve”*, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, *“Grup i strukturuar kriminal”* dhe *“Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”*, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.
- 17) **Astrit Vladi**, i biri i Shaqir dhe i Mendie, i datëlindjes 17.05.1976, me numër personal H60517084R, lindur në Armollë dhe banues në rrugën ‘Migjeni, nd 16, H1, Njesia Administrative nr 11, 1026, Tiranë, me gjendje civile i martuar me dy fëmijë, aktualisht i arrestuar për llogari të një procedimi tjetër, i dyshuar për kryerjen e veprave penale *“Trafikimi i narkotikëve”*, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, *“Grup*

i strukturuar kriminal” dhe “ Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

- 18) **Kastriot Vladi**, i biri Shaqir dhe i Mendie, i datëlindjes 18.04.1986, me numër personal I60418022I, lindur në Fushë-Luë Dibër dhe banues në rrugën Ilia Plasa, Nd 13; H 1, Njësia Administrative nr 11; 1029, Tiranë, me gjendje civile i martuar, me gjendje i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.
- 19) **Gëzim Islami**, i biri i Vehap dhe i Qete, i datëlindjes 15.04.1963, me numër personal G80415340L, i lindur në Herbel Dibër dhe banues me adresë “Koli Bano, Nd 15, H.1, Ap 1, Njësia Administrative nr 11, Njësia bashkiake nr 11; 1026 Tiranë, me gjendje civile i martuar me fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.
- 20) **Ilir Shtufi**, i biri i Xhemal dhe Zonjë i datëlindjes 13.10.1973, me numër personal H31013090C, lindur në Tiranë dhe banues në adresën rruga “Kajo Karafili”, nd .14, hyrja 2 apt 53, Njësia Administrative nr. 10, Tiranë, me gjendje civile i martuar, me fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë; i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

Përgjatë hetimeve të zhvilluara në kuadër të procedimit penal nr. 287, të vitit 2021 është dokumentuar veprimtaria kriminale e një grupi kriminal të përbërë nga shtetas shqiptarë, të përfshirë të paktën që prej vitit 2018 e në vijim në veprimtari kriminale, të trafikimit të lëndëve narkotike dhe pastrimit të produkteve të veprës penale.

1.2 Fillimet e procedimit penal

2.2.1 Të dhënat e përfutur nga procedimi pasuror nr. 10/2020.

Nga veprimet hetimore, të kryera në kuadër të hetimit pasuror në kuadër të ligjit Nr. 10 192, datë 3.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” të ndryshuar (i njohur ndryshe si *ligji antimafia*) në lidhje me shtetasin Denis Matoshi, janë përfutur, ndër të tjera, të dhëna që ai kishte përfutur me anë të kontratës së dhurimit, në datën 16.02.2015 një sipërfaqe toke prej 500 m²

sipërfaqe toke nga ana e shtetasve Qefsere dhe Eqerem Grori, si dhe Osman Dervishi (*bashkëpronarë trualli*) në rrugën “Dervish Hima”, Zona Kadastrale, nr .8160, Tiranë.

Me vendimin me nr. 29, datë 07.11.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur sekuestroja mbi pasurinë, që i përkiste subjektit Denis Matoshi, konkretisht pasuria e llojit “Truall”, me nr. pasurie 6/438 sipërfaqe 5269 m², Zona Kadastrale 8160, rruga “Dervish Hima” Tiranë, pjesa takuese 2163/30000 në pronësi të shtetasit Denis Naim Matoshi, pasuri që është në bashkëpronësi, si dhe mbi të drejtën e shtetasit Denis Matoshi për të përfituar vlerën e shpronësimit nga Komisioni i Posaçëm për Shpronësim, për shpronësimin në pasurinë me nr. 6/380, Z.K. 8160, rruga “Dervish Hima” si bashkëpronar në këtë pasuri në pjesë takuese 120005/1680000, me vlerë paraprake të shpronësimit 8.180.125.82 lekë (*aktualisht kjo pasuri është konfiskuar*).

2.2.2 Kjo sipërfaqe toke ndodhet në Zonën Kadastrale me nr. 8160, pranë stadiumit “Air Albania”, Tiranë. Sipërfaqja totale e kësaj pasurie me nr. 6/380, Z.K. 8160 ka qenë 6979 m². Kjo pasuri është ndarë për arsye të regjistrimit të V.K.M 797, datë 09.11.2016, në dy pasuri:

1. **Pasuria me nr.6/437, vol. 47, fq. 27, Z.K. 8160, me sipërfaqe 1710 m²**, për të cilën është lëshuar certifikatë pronësie, në datë 28.03.2017 sipërfaqe e cila është *shpronësuar*. Kjo pasi Bashkia e Tiranës, në mbështetje të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, për “*Pronat e paluajtshme të shtetit*”, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, për “*Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*”, të VKM-së nr. 500, datë 14.8.2001, për “*Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore*”, në zbatim të vendimit nr. 797, datë 9.11.2016, të Këshillit të Ministrave, për “*Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Asfaltimi i rrugëve dhe trotuarit pranë stadiumit “Qemal Stafa”, Tiranë, kërkon regjistrimin e pasurive truall, sipas planimetrisë së shpronësimit, në kuadrin e realizimit të projektit “Asfaltimi i rrugëve dhe trotuarit pranë stadiumit “Qemal Stafa”, Tiranë*”, që ndodhen në Zonën Kadastrale 8160, indeks harte TR-S-12.13, rruga “Dervish Hima”, Tiranë. Sipas VKM bashkëlidhur është tabela e dëmshpërblimeve ku për pasurinë nr.6/380, volum 33, faqe 132, Z.K. 8160, shuma e dëmshpërblimit është 114,516,990 lekë.
2. **Pasurinë nr.6/438, vol. 47, fq. 28, Z.K. 8160, me sipërfaqe 5269 m²**, për të cilën është lëshuar certifikatë pronësie në emër të bashkëpronarëve Grori, Dervishi, Nikolla etj., në datë 08.05.2017.

2.2.3 Nga dokumentacioni i marrë pranë Agjensisë së Kadastrës, mbi historikun e veprimeve të kryera mbi këtë pasuri, janë përfutur të dhëna në drejtim të veprimeve të shumta dhuruese të kryera në mënyrë të vazhdueshme, nga bashkëpronarët e truallit, në drejtim të personave nën hetim (*Artur Shehu, Elton Memeti*), apo personave të tretë, të cilët më pas ia kanë dhuruar njëri-tjetrit, në një hark kohor nga viti 2015 e në vijim deri në vitin 2022, kohë e cila përkon edhe me shpronësimin më pas të këtij trualli, me Vendim të Këshillit të Ministrave, me destinacion “*Shkolla e Biçikletave*”. Sipas VKM-së nr. 510, datë 27.07.2022 pasuria me nr. 6/438 me sipërfaqe 5269 m² shpronësohet kundrejt vlerës 352859661 lekë me çmim 66.969 lekë.

Në lidhje me këtë sipërfaqe toke, një pjesë e bashkëpronarëve, kishin nënshkruar në vitin 2020 kontrata sipërmarrje me shoqërinë “A@AMIV” sh.p.k., shoqëri me ortak shtetasin Joanis Liçaj (Klodian Liçaj), banues në Vlorë, e regjistruar vetëm në vitin 2020, pa patur licensë dhe kapital të nevojshëm për të nxjerrë një leje zhvillimi.

2.2.4 Nga analizimi i veprimeve të shumta juridike në dukje të ligjshme, për shkak të intensitetit të veprimeve dhe personave të përfshirë në të, ndër të tjera janë përfituar indicie të mjaftueshme për të regjistruar kryesisht procedimin penal nr. 287, të vitit 2021 për veprën penale “*Pastrim i Produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*” kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal; “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprimeve nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*” vepra këto të parashikuara nga nenet 287/1; 28/4; 333/a dhe 334/1 të Kodit Penal.

2.2.5 Gjatë kohës që çështja ishte në hetim (maj të vitit 2022) dhe kohë që përkonte me paraqitjen pranë Gjykatës të kërkesës për konfiskim të pasurive të shtetasit Eldi Dizdari, grupi kriminal ka filluar lëvizjet e tij, duke përdorur edhe institucionin shtetëror të Agjencisë së Kadastrës, në përpjekje për të marrë të dhëna nëse pranë Prokurorisë së Posaçme ka patur çështje ndaj tyre, kohë kjo që përkon edhe me operacionin e kryer në Belgjikë në kuadër të çështjes “Black Eagle”⁷, dosje për të cilën është përfutur informacion përgjatë hetimeve. Hetimet janë zhvilluar në mënyrë paralele dhe për të cilat autoritetet përkatëse kanë dërguar edhe letërporosi pranë autoriteve reciproke, në mënyrë të pavarur, duke u lidhur më pas me njëra-tjetrën.

Pranë Prokurorisë së Posaçme është paraqitur një kërkesë nga shtetasit Myzejen Rama, Besnik Rama dhe Andi Grori (bashkëpronarë të truallit) duke kërkuar dhënien e pëlqimit për zhvillimin e pronës dhe po këto ditë nga Agjencia e Kadastrës Jug Tiranë është kërkuar informacion, nëse për personin nën hetim **Artur Shehu**, po zhvilloheshin hetime, pasi në këtë zyrë ishin paraqitur dy kontrata dhurimi të lidhur ndërmjet shtetasit **Artur Shehu** (dhe shtetasve Xhesika Dodaj (bashkëjetuese e shtetasit Fation Kola) dhe Malvina Canaj, (bashkëjetuesja e shtetasit Ervis Çela), (ky i fundit i arrestuar për veprën penale të trafikimit të lëndës narkotike), të cilave ai iu dhuronte sipërfaqet e tokës të së njëjtës Zonë Kadastrale të përfituara nga dhurime të mëparshme.

Përgjatë kësaj kohe kanë filluar revokimet e kontratave të lidhura me shoqërinë “A@AMIV” sh.p.k., dhe në vitin 2022 nëpërmjet përgjimeve të komunikimeve të bashkëpronarëve, por edhe personit nën hetim **Adrian Rama**, është mësuar se ishte ky i fundit, i cili qëndronte dhe orientonte veprimet me pronën dhe pas shkresës së dërguar në SPAK, nga Agjencia e Kadastrës, ku kërkonte informacion mbi personin nën hetim Artur Shehu, duke krijuar kështu indicie për lidhje të mundshme të tyre mes njëri-tjetrit.

1.3 Zhvillimi i mëtejshëm i hetimeve nëpërmjet dërgimit të letërporosive

2.3.1 Për të vijuar më tej, përgjatë hetimeve janë siguruar informacione se autoritetet spanjolle po kryenin hetime në lidhje me personat nën hetim **Adrian Rama** dhe **Artur Shehu**, ku në vijim të dhënave të përfutura nëpërmjet takimeve policore të zhvilluara ndërmjet oficerëve të policisë së Byrosë Kombëtare të Hetimit pranë SPAK me autoritetet policore të Spanjës, Palma Di Majorka (gjykata e hetimit nr.2) është kërkuar me anë të letërporosisë drejtuar autoriteteve të Mbretërisë së

⁷ Ang. “Black Eagle”-Shq. “Shqiponja e Zezë”.

Spanjës informacioni nëse nga ana e këtyre autoriteteve po zhvilloheshin hetime për personat nën hetim **Adrian Rama** dhe **Artur Shehu**.

Me anë të kësaj letërporosie janë dërguar të dhëna me rëndësi për hetimin, të zhvilluara më tej me anë të letërporosisë drejtuar autoriteteve belge, dhe dërgimit nga ana e tyre të të dhënave nga dosja e quajtur "**Black Eagle-Shqiponja e Zezë**" dhe **vendimit të Gjykatës së Brukselit me nr. 024/4729, të datës 27 Qershor 2024**, dhënë për personin nën hetim **Alfredo Hamzai**, i dënuar në kuadër të kësaj dosje me 8 (tetë) vjet burgim, për veprimtarinë kriminale të trafikimit të narkotikëve. Gjithashtu, mbi bazën e kërkesës drejtuar Europol dhe më pas me anë të letërporosisë dërguar autoriteteve franceze është mundësuar sigurimi i komunikimeve të SkyEcc dhe kryer analizimi i tyre, ku nga tërësia e të dhënave ka rezultuar e dokumentuar veprimtaria kriminale e trafikimit ndërkombëtar të drogës e bashkë me të edhe ajo e pastrimit të parave.

Nga analizimi i të dhënave të përfuara⁸ (nga autoritetet gjyqësore të Drejtësisë së Mbretërisë së Spanjës të procedimit penal që ata kanë pasur në ndjekje; në komunikimet e kryera prej tyre në platformën e enkriptuar SkyEcc, nga përgjimet e komunikimeve elektronike, si edhe në analizim të akteve noteriale të lidhura mes tyre dhe personave të tretë të autorizuar prej tyre) janë mësuar të dhëna të rëndësishme lidhur me personat nën hetim, të cilët konsistojnë:

- në takime të zhvilluara në Majorka, Belgjikë e Aruba, takime të cilat konsistuar në vitet 2018-2021 kryesisht në kuadër të veprimtarisë kriminale të trafikimit të narkotikëve, por edhe për investime në Shqipëri;
- në përfshirje me veprime konkrete në kuadër të trafikimit të lëndëve narkotike me një shtrirje ndërkombëtare dhe në tonelata të konsiderueshme, si edhe qarkullimin e shumave monetare në vlera disa miliona euro të gjeneruara këto prej ketij aktiviteti të paligjshëm;
- në kryerjen e veprimeve noteriale mbi blerje të pasurive të paluajtshme, investimin në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të fshehur pas subjekteve ndërtuese të njohura në aktivitetin e ndërtimit dhe të cilat përfitojnë lehtësisht leje zhvillimi dhe ndërtimi si investitor strategjik, në shitjen dhe rishitjen tek persona fizik/juridik të krijuar prej tyre (apo lidhjeve familjare e shoqërore të tyre) deri në "humbjen" e lidhjeve të origjinës së pasurisë nga pronari i parë për tek pronari real (që janë subjektet nën hetim, të fshehur edhe nën investitorët).

2.3.2 Letërporosia e dërguar nga autoritet spanjolle

Sipas të dhënave të letërporosisë së autoriteteve të drejtësisë spanjolle përftohen këto të dhëna për secilin prej personave nën hetim:

Personi nën hetim **Adrian Rama** është hetuar në kuadër të procedimit penal me nr. 1069/2018 si person që nëpërmjet ndërmjetësimit të Arben Ismailaj, ka komunikim me Alfredo Hamzai *alias* Genc Bedini *alias* Genci Tanasi, me qëllim saktësimin e detajeve të një operacioni të trafikimit të narkotikëve. Ai ka marrë pjesë në takime në Majorka me shtetasin Bashkim Osmanin (shtetas i Kosovës), Toni Lipaj, Artur Shehu, Arben Ismailaj e të tjerë. Personi nën hetim **Adrian Rama është i shoqëruar nga personi nën hetim Elton Memeti, ai ka marrë pjesë në takimin e zhvilluar në Monako me Artur Shehu, Arben Ismailaj dhe Alfredo Hamzai, takim në të cilën është**

⁸ Dërguar nga autoritetet spanjolle në vitin 2023, mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë, nëpërmjet Eurojust-it.

diskutuar në lidhje me trafikim të kokainës nga Surinami në Evropë. Ai merr pjesë në disa takime në Belgjikë me shtetasin Alfredo Hamzai dhe djalin e tij, Arten Hamzai. Edhe në këto takime është i shoqëruar nga personi nën hetim Elton Memeti.

Personi nën hetim Artur Shehu, gjithashtu, është hetuar në kuadër të procedimit penal nr. 1069/2018 si pjesëmarrës në takime të ndryshme të zhvilluara në vende të ndryshme në Evropë dhe Amerikë, me qëllim blerjen, transportimin dhe futjen e sasive të mëdha të drogës në Evropë. Ashtu si Adrian Rama, Artur Shehu merr pjesë në takime në Spanjë, Monako, Gjermani, Aruba, ndër të tjera, në të cilat është planifikuar blerja, transportimi dhe futja e sasive të mëdha të drogës në Evropë. Në këto takime, ndër të tjera dhe në shkallë të ndryshme pjesëmarrje, marrin pjesë shtetasit Adrian Rama, Elton Memeti, Erjon Rama, Leonard Bishaj, Bujar Shehaj, Alfredo Hamzai, Pullumb Petritaj.

Elton Memeti, është hetuar në kuadër të procedimit penal nr. 1069/2018 si pjesëmarrës në takime të ndryshme të zhvilluara në vende të ndryshme në Evropë dhe Amerikë, me qëllim blerjen, transportimin dhe futjen e sasive të mëdha të drogës në Evropë. Person i lidhur direkt me Artur Shehu dhe Adrian Rama, të cilët zakonisht i shoqëron në takimet e tyre. Ashtu si Adrian Rama, Elton Memeti merr pjesë në takime në Spanjë, Monako, Gjermani, Aruba, ndër të tjera, në të cilat është planifikuar blerja, transportimi dhe futja e sasive të mëdha të drogës në Evropë. Në këto takime, ndër të tjera dhe në shkallë të ndryshme pjesëmarrje, marrin pjesë shtetasit Adrian Rama, Artur Shehu, Erjon Rama, Leonard Bishaj, Bujar Shehaj, Alfredo Hamzai, Pullumb⁹ Petritaj.

Erjon Rama - Identifikuar brenda një automjeti, në Monako, së bashku me Artur Shehu dhe Adrian Rama. Ky identifikim është kryer në kuadër të disa takimeve që zhvillohen në Monako lidhur me importimin e paligjshëm të lëndëve narkotike. Automjeti me të cilin ai identifikohet është i njëjti me të cilin Artur Shehu dhe Adrian Rama kanë udhëtuar më pas drejt ishullit të Majorkës.

Leonard Bishaj- Person i hetuar në kuadër të procedimit penal nr. 1069/2018, si pjesëmarrës në takime të ndryshme të zhvilluara në vende të ndryshme në Evropë dhe Amerikë, me qëllim blerjen, transportimin dhe futjen e sasive të mëdha të drogës në Evropë.

Mori pjesë në vitin 2019 në takimet ku ishin edhe shtetasit Bashkim OSMANI, Toni LIPAJ, Artur SHEHU, Klodjan JAHJA, Bujar SHEJAJ, Adrian RAMA, takime të cilat u kryen para operacionit të trafikut të drogës që ndodhi në Barcelonë, në janar 2020, ku u sekuestruan 441 kg kokainë dhe ku u arrestuar kushëriri i Alfredo HAMZAI, Indrit KULAJ. Ky takim është pjesë e një sërë takimesh të zhvilluara gjatë gjithë vitit 2019 me të njëjtin qëllim.

Këto takime janë kryer para operacionit të trafikut të drogës që ndodhi në Barcelonë në janar 2020 ku u sekuestruan 441 kg kokainë dhe ku u arrestua kushëriri i Alfredo Hamzai, shtetasi Indrit Kulaj.

⁹ Alias Pëllumb Petritaj.




Ilustración 1 Bashkim OSMANI junto a Artur SHEHU y Adrian RAMA




Ilustración 2 Reunión en Amberes 12-02-2019




Ilustración 3 LIPAJ, SHEHU, MORINA e ISMAILAJ

Nga autoritetet e Spanjës janë paraqitur të dhëna në lidhje me personat nën hetim Artur Shehu, Adrian Rama, Erjon Rama, Elton Memeti për shkallën e pjesëmarrjes së tyre në takimet e ndryshme të konstatuara gjatë hetimit, me theks të veçantë te takimet e zhvilluara në

ishullin Aruba dhe në Monako, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me operacionin e trafikut të drogës, hetuar si krim paraardhës i krimeve të hetuara në këtë procedim.

Në lidhje me investimet përkatëse rezulton se, nga ekspertimet e aparateve të telefonit janë gjetur të dhëna me interes të cilat lidhin personat nën hetim në kryerjen e investimeve në “Green Coast” si më poshtë vijon:



Brenda aparateve celularë të lidhur me Arben Ismailaj, është gjetur profili “Ervin Kajno” i lidhur me numrin e telefonit “355692022894”. Emri i personit në fjalë përkon me atë të Drejtorit të Projekteve të Koorporatës “BALFIN GROUP”. Në aparatet telefonik të Arben Ismailaj dhe Alfredo Hamzai janë gjetur skedarë të shumtë multimedialë (foto/video) që lidhen me punime në ndërtim apo projekte tokash dhe projekte ndërtimi, ku rezulton se shumë prej tyre janë të njëjta ndër pajisjet e secilit. Në një bisedë midis përdoruesit AIMCSV (Ardian Zykaj) dhe Alfredo Hamzai (7B9F5E) në platformën e komunikimit të koduar SkyEcc, është bërë e mundur të merret një seri imazhesh të dërguara nga AIMCSV (Ardian Zykaj) tek Alfredo Hamzai (7B9F5E), të cilat përkojnë me përdoruesit e gjetur në lista të ndryshme kontaktesh në pajisjet e analizuara dhe të cilat provojnë lidhjen mes tyre jo vetëm në trafikun e lëndëve narkotike, por edhe në atë pastrimit të produkteve të ardhura prej saj.


Në lidhje me foton në fjalë, në pajisjen e përdorur nga HAMZAI 0500_2022_Apple iPhone 11 (A2221), është gjetur numri i kontaktit 355696982158 i lidhur me emrin “Danieli Fari”. I njëjti numër shfaqet i lidhur në listën e kontakteve të Arben Ismailaj me tre pajisje të tij, MB02 IPHONE 11, iPhone 8 plus dhe MB05 iPhone 6s, ku numri në të gjitha është “Vellai Sh Genci”. Në imazhin e mësipërm mund të shihni një mesazh të dërguar nga telefoni +393533349273 në të cilën mund të lexoni frazën e mëposhtme në gjuhën shqipe: “ca ben mir. Ti je adi. Jam diali hamzait. Me kan ardh llafe që po n ai ben borxh. Nuk di sa e vertet esht. Po mir eshte most e na shtosh hallet”.

Biseda në interes të hetimit, në një bisedë në EhatsApp mes Arben Ismailaj dhe Artur Shehut, një bisedë e gjetur në aparatën ME 02 IPHONE 11, ky i fundit i dërgon fotografitë e mëposhtme: (Ilustrim 8 - Numri i telefonit +38649898989 është i regjistruar si kontakt në pajisjet e lidhura me Arben Ismailaj me emrin “Gimi Kosove”) (Ilustrimi 9 Imazhi që Artur SHEHU i dërgon Arben Ismailaj ku mund të shihni atë që duket të jetë një projekt ndërtim paralel me kompleksin Green Coast).

+386 49 898 989
2/26/21, 8:19 AM


All Media





(Ilustrimi 10 - Imazhi i dërguar nga Artur Shehu për Arben Ismailaj që tregon atë që duket të jetë një pamje e një fotografie të një projekti ndërtimi paralel me kompleksin “Green Coast”, i cili quhet “Green Coast II”.


Kjo fotografi tregon atë që duket se është numri i telefonit, si dhe data dhe ora e dërgimit, që është 04.08.2021, ora 07:18. Numri i telefonit në fjalë është **+355092073888 numër që i përket personit nën hetim Adrian Rama**. Gjithashtu, ky numër telefoni figuron në listën e kontakteve të disa prej pajisjeve të përdorura nga Arben Ismailaj.



(Ilustrimi 11 - 4 kapje imazhesh (screenshote) të marra nga dy video të dërguara nga Artur SHEHU për Arben Ismailaj, në të cilat dallohen ndërtesa të ndryshme të kompleksit “Green Coast”).

Pamjet e marra nga dy videot e rishikuara më sipër janë dërguar nëpërmjet një mesazhi nga Artur Shehu për Arben Ismailaj që përmban të dyja videot dhe pyet Arben Ismailaj se si janë vilat e tij. Konfirmimi se këto vila i përkasin të gjithë “Green Coast” Resort, me vendndodhje në Palasë, Shqipëri, bëhet pasi janë verifikuar përmes fotografive të publikuara në Google Maps në janar 2023.

Në të dhënat e marra nga autoritetet belge, konstatohet se në një nga aparatet telefonike të përdorur nga Alfredo Hamzai gjenden fotografitë e mëposhtme me interes:



Në lidhje me rezidencën “Green Coast” të përmendur më lart, janë gjetur referenca të ndryshme në përdoruesit e sistemit SkyEcc të ofruara nga autoritetet belge për analizë.

Gjithashtu, lidhur me investimet e kryera në bregdetin e jugut të Shqipërisë, krahas komunikimeve të përfuara nga hetimet e autoriteteve belge, janë përfuar të dhëna me interes në kuadër të këtyre investimeve të kryera në ndërtim nga ky grup kriminal, përgjatë bisedave të kryera prej tyre në platformën SkyEcc përgjatë periudhës 2019-Mars 2021, dhe më konkretisht:

Gjithashtu, në kuadër të kësaj letërporosie janë përfuar të dhëna në lidhje me përdoruesin e pineve (K4LXOK dhe 60CEA0), identifikuar përgjatë hetimeve si personi nën hetim Artur Koçeku alias Luçiano Koçeku, i njohur në komunikimet mes tyre e pseudonimin “loku”) në komunikimet e tij me përdoruesin e Pin 7B9F5E (me pseudonimin identifikues Vlvl.17..n1bc 716351 dhe ndër të tjera edhe gnc) përdorues i të cilit është identifikuar personi nën hetim Alfredo Hamzai, është mësuar mbi një fotografi në të cilën (K4LXOK – Luçiano Koçeku) i tregon me gisht në një nga pronat të kësaj rezidence, të ndjekur nga dy fotografi të tjera, në të cilat ai mund të shihet duke treguar një tokë ngjitur me kompleksin “Green Coast”.



Ilustración 14 Imagen remitida por Lokuu new el 30/01/2021

(Ilustrimi 14 - Imazhi i dërguar nga Lokuu në më 30/01/2021)




Ilustración 15 Fotografías enviadas por Lokuu new a HAMZAI el 30/01/2021 y el 24/02/2021 respectivamente

(Ilustrim 15 - Fotografi të dërguara nga Lokuu në tek Hamzai më 30.01.2021 dhe 24.02.2021 respektivisht).

Ai tregon zonën në të cilën do të kufizohet projekti “Green Coast II”, siç shihet në pamjet që Artur Shehu i kishte dërguar Arben Ismailaj (*përftuar në aktet e ardhura me Letërporosi*).

Konteksti në të cilin ndodh ky shkëmbim fotografish tregon interesin që shfaq përdoruesi “Loku” në marrjen e një prone ose në pritjen për t’u ndërtuar në tokën e personit nën hetim Alfredo Hamzai, për të cilën ky i fundit i thotë *“merru me lejen (e ndërtimin) dhe pak nga pak do bëhet (ndërtohet) për ta”*, për të cilën në po të njëjtin komunikim “Loku” (Luçiano Koçeku) i komunikon se tashmë e ka marrë lejen dhe se do të ndërtojnë më shumë vila në zone. Lidhur me fotografinë në të cilën tregon tokën me gisht, Alfredo Hamzai pyet nëse e ka marrë lejen për anësoren (*duke iu referuar tokës së treguar*), **“Loku” pohon dhe i thotë se “duhet të paguaj ca lekë për ta hequr nga zona e gjelbër, dhe e vendos për të ndërtuar”**. **HAMZAI i thotë se “lart (në tokë...) jemi të qetë, mund të ndërtojmë vila të mëdha”¹⁰**.

Në vijim me sa më sipër, është zbuluar edhe një bisedë midis user-it të përdorur nga Alfredo Hamzai në sistemin SkyEcc, me përdoruesin AIMCSV (*i përdorur nga Ardian Zykaj*), në të cilin mund të shihen imazhet e mëposhtme me interes, që korrespondon me një parcelë që do të ishte pjesë e zhvillimit të tokës në vazhdimësi me rezidencën “Green Coast”.

¹⁰ Referuar edhe biseda në SKY ECC zhvilluar ndërmjet HAMZAI-t dhe Lokut (Luçiano Koçeku)

Loku: Hej vëlla, kjo është toka jote? E kam vizatuar pak a shumë saktë?

Hamzai: Po vëlla, pak a shumë.

Loku: Aty afër përroit e keni ngjitur me ZAMIR?

Hamzai: Po është në projektin që kanë bërë arkitektët, aty mund të shihen detajet dhe gjithçka.



Ilustración 16 Imagen enviada por AIMCSV a HAMZAI el 13/12/2020, 12:53:52



Ilustración 17 Imágen enviada por AIMCSV a HAMZAI el 13/1/2021, 19:29:19

Imazhi

i dërguar nga AIMCSV tek Alfredo Hamzai në datën 13/01/2021 në orën 19:29.19.




Ilustración 18 Imagen obtenida de Google Maps en la que se aprecia la parcela marcada por el usuario AIMCSV

Imazhi i marrë nga Google Maps në të cilin mund të shihet parcela e shënuar nga përdoruesi AIMCSV (Ardian Zykaj).

Krahas komunikimeve të kryera mes tyre në platformën SkyEcc, në përputhje me mënyrën e kryerjes së këtij aktiviteti të trafikimit të lëndës narkotike, gjenden edhe të dhënat e përfuara nga veprimet hetimore të autoriteteve spanjolle dhe belge, **si më konkretisht në kontrollat e kryera në banesat e të hetuarit Indrit Kula**¹¹, ku raportohet një fletore e gjetur në mobiljen e dhomës së ndenjes së shtëpisë që ndodhet në **“Gallifortlei 9, 2100 Antëerp”**, e cila pasqyron një sërë shënimesh që tregojnë qartë mbi disa llogari që lidhen me tregtinë e lëndëve narkotike, konkretisht kokainës dhe ku shënimi i parë në fletoren e përmendur është bërë më datë 28.01.2018 dhe ku pasqyrohen shitjet ditore, duke treguar se kush furnizon dhe kush blen, si dhe llogaritjet dhe


¹¹ Gjendur në dosjen 013154-2022 lidhur me Kontrollat e kryera në banesat e të hetuarit Indrit KULAJ.

shumat që u detyrohen njerëzve, me pseudonimet e mëposhtme që lidhen me hyrjet në fjalë: Klodi, Nari, Henri, Kico, Flamur, Delfin, End, Albert, Emil, Lani, Lushnja, Dovidan, Llapi, Eri, Niku, Zio, Mark, Nitz, Prada, Dë ni, Tyle, Boli, Andi, Gora, Selam, Dani, Meco, Bek, Marco, Luli, Hari, Xhani, Turi, Tono Marci, Lambo, Meco, Pini, Anto, Kaçi, Lam, Peri, Bora, Janag. Në të njëjtën dosje raportohet edhe zbulimi i një dokumenti tjetër me shënime të ngjashme, ku për herë të parë është shënuar në datën 31.05.2020. Dokumenti në fjalë është gjetur në bodrumin e shtëpisë së lartpërmendur. Në të ka dhe një shënim të datës 25.03.20 në të cilin shfaqet pseudonimi “Loku”.

Ndër objektet e sekuestruara në adresën “Ter Rivierenlaan Street 239, 2100 Antëerp” (adresa e banimit të Indrit Kulaj),¹² tregohet vendndodhja e një fletoreje me faqe të grisura në të cilat shfaqen shënime të shkruara me dorë në gjuhën shqipe që korrespondojnë me mbajtjen e llogarive sa i përket lëndës narkotike ose shumave të konsiderueshme të parave, dhe se vërehet se është mbajtur shënim për veprimet financiare nga data 18.07.2020 deri më 24.08.2020, dhe se gjithashtu shfaqen disa pseudonime (disa prej tyre të njohura në këtë udhëzim), përkatësisht “BOLI¹³BRX” (Boli Bruksel) - BACJA Klodjan / “ACTIONI/ACTION” / “KUSHO” / “VALENTINO” / “LALE” / “DISQUIRI/DISQUIREO/DISQUIA” / “PANDA”: ndoshta Jurgen Kalemaj / “DAJO BRA” (Daja Bruksel)/ “EMIL/EMI/EMILJANO” / “LITUANI/LITUA” / “LOKU/LOKUT” / “QEROZI” (tullaci) / “KAMINA”/ “PANINO” / “NURE” / “TURKU FLAM” / “ZIO”: ndoshta Alfredo Hamzai.

Në këto shënime, janë gjendur edhe vulat e pakove të kokainës, përkatësisht: “TOP2”, “ELEFANT”, “TIM”, “ROLEX” si edhe janë të konstatuara nga këqyrja e komunikimeve të kryera në SkyEcc mes personave nën hetim Luçiano Koçeku dhe Alfredo Hamzai, si edhe personave të tjerë të lidhur me ta, ndër ta edhe shtetasi Indrit Kulaj (NY6N4T), i cili në komunikimet e tij me personin nën hetim Luçiano Koçeku (gjatë kohës të qëndrimit të tij në ambientet e paraburgimit Spanjë) e ka të ditur Nickname (nofkën) “loku” të pineve K4LXOK dhe 60CEA0 të përdorura nga Luçiano Koçeku.¹⁴

¹² Gjendur në dosjen 018214-2022, ku renditen objektet e sekuestruara në adresën “Ter Rivierenlaan Street 239, 2100 Antëerp” (adresa e banimit të Indrit KULAJ), Gjithsej janë 26 fletë, disa të shkruara në të dyja anët.



Gjenden në këtë flete shënimesh edhe llogaria e mbajtur shënim për lokun (e provuar nga prokuroria që i referohet shtetasit Luçiano Koçeku), plaku 800.

2.3.3 Letërporosia e dërguar nga autoritetet belge

Në vijim të sigurimit të provave, gjatë hetimit është marrë me anë të letërporosisë nga autoritetet belge dosja “Black Eagle”, si dhe përmbledhje të informacioneve mbi personin nën hetim Artur Shehu dhe vendimi gjyqësor dërguar në mënyrë të drejtëpërdrejtë, nëpërmjet të cilëve përftohen të dhëna mbi aktivitetin kriminal të trafikimit të lëndëve narkotike nga personi nën hetim Alfredo Hamzai, si drejtues grupi dhe nipit të tij shtetasit Indrit Kulaj, të dënuar nga këto autoritete.

Sipas arsyetimit të këtij vendimi rezulton se: “...Provat sugjerojnë se disa organizata të dallueshme kriminale bashkëpunuan, duke ndarë burime dhe njohuri për të arritur një qëllim të përbashkët.

Që në fillim vërehen sa vijon: Porosi në grup për sasi të mëdha kokaine, të shpërndara midis disa organizatave kriminale bazuar në vulat në pako, • Ndarja e laboratorëve, si ai në Rrugën Gray, ose ai në Zutendaal, të ndarë me zotërinjtë STRANGIO dhe BERLINGERI, të përshkruar si të përfshirë në trafikimin e narkotikëve në Italinë jugore,¹⁵ • Ndarja e personelit me aftësi specifike, përfshirë kolumbianët e dërguar në Belgjikë për shkak të ekspertizës së tyre në këtë fushë, • Ndarja e personave të parë për të regjistruar automjete, veçanërisht Klubin e Jahteve Nieuport. • Bashkëpunimi midis organizatave për të kryer nxjerrje, veçanërisht në Itali dhe Greqi ».

Referuar vendimit gjyqësor rezulton se, hetimi ka filluar me zbulimin, në datat 30.09.2020 dhe 01.10.2020, në disa garazhde të cilat ndodheshin në Belgjikë, të një sasive produktesh kimike dhe mjeteve që kanë të bëjnë me transformimin dhe paketimin e kokainës¹⁶, disa prej këtyre mjeteve janë testuar dhe kanë rezultuar pozitivë ndaj kokainës, të 13 kilogramëve rrëshirë kanabisi dhe 29 litrave vaj kanabisi, të një bombule për zhytje, të një makinerie industriale për paketimin me vakum, të veshjeve me stemën e policisë, etj. ... Kontratat e qerave të këtyre garazhdeve ishin hartuar në bazë të identiteteve të rreme, por ishin shënuar aty numrat belgë të telefonave në emër të Indrit Kulaj dhe në emër të Kiritsis Lazaros. Në njërin nga këta garazhde u gjet edhe një furgon i markës Mercedes-Citan për të cilin u bë i mundur identifikimi i pronarit të fundit që është ndërmarrja Mondovi, menaxheri i së cilës ishte Indrit Kulaj. Në fillim të janarit të vitit 2021, rezulton se një grup personash me origjinë shqiptare të cilët kryejnë nxjerrje të drogës nga porti i Anvers-it, mendohet se banojnë në «2100 Anvers-Deume, Ter Rivierenlaan », vendbanim i Indrit Kulaj. Analiza e kodeve pin Sky të personave të ndryshëm ka mundësuar të gjenden fotografi të qindra bukëve (pakove) kokaine, shuma të mëdha parash, vende ku produktet përpunoheshin dhe/ose stokoheshin, produkte kimike, konteinerë, udhëtime me anije, një avion privat që transportonte kokainë, amenaxhimi i një vendi të fshehtë në apartament etj...

¹⁵ Kutia 117, dosja 19, prova 36

¹⁶2020-07-10 7B9F5E Po tani fillon

11:24:05

2020-07-10 60CEA Stampo top ej

11:25:55 0 thuaj

2020-07-10 60CEA Top2

11:26:03 0

Nga komunikimet e konstatuara nga ana e autoriteteve belge, por dhe të ndodhura nga këqyjjet e aparateve të telefonit rezulton shtetasi Indrit Kulaj me kod Pin NY6N4T ka komunikime të shumta me personin nën hetim Alfredo Hamzai me kod Pin 7B9F5E. Nga data 19/10/20 deri në 08/03/21 rezulton se shtetasi Indrit Kulaj, i cili ishte arrestuar në Spanjë në lidhje me trafikimin e një sasive prej 441 kg kokainë përfitonte nga kontaktet e tij në burg në Spanjë për të krijuar një rrjet të ri importimi të kokainës me nisje nga Paraguai, ku një pjesë e tyre mund të kalonte nëpër rrugë diplomatike që parashikon transporte detare nëpërmjet transportit të sojës, karbonit dhe mishit, që mund të furnizonin në shkëmbim ekstazi, hashash dhe arme, që do përdornin avione private dhe do kishin pilote në dispozicion, që do ishin aktive si në shitje, transformim dhe transport nga porti të substancave narkotike, që do të punonin në shumë porte në Evropë dhe do të kishin bashkëpunëtorë të brendshëm, që shoqëritë e Lazaros Kiritsis do të përdorshin për të pastruar para, që do kishin depo për të transformuar mallin dhe vende të ndryshme për ta ruajtur.

Në një përgjimit të vendosur në qelinë e Indrit Kulaj, pasi ky u transferua në burgun "SaintGilles" në Belgjikë, qe shumë biseda të rëndësishme për hetimin u kapën; që ai ka thënë që për atë puna është e thjeshtë sepse korrierët janë të gatshëm, që ka njerëzit dhe që ka akoma pune jashtë, në këtë mënyrë ai nuk është shkëputur tamam dhe edhe pse nuk është 100% sikur të ishin të dy jashtë, ai është aty 60% ose 50%. Që gjatë kontrollit të kryer në "Padresse Gallifortleri" (selia e shoqërisë Mondovi dhe banesa e të dashurës së Indrit Kulaj) u gjet një vend i fshehur pas një muri në katin përdehe; që ai përmbante 6 armë kryesisht me silenciator, një shume prej 29875 euro, 12 blloqe kokaine me një peshe totale prej 11,995 kile, 3 qese kokaine me peshe 5 kile, tre kuti që përmbanin pengues valësh telefonike, dy kuti që përmbanin një varkë gome Zodiac me motor dhe bateri (që përdorimi i një varke të tilla është konfirmuar nga përgjimet dhe observimet në kuadër të eksportit të lëndëve narkotike); që një shume prej 18650 eurosh është gjendur në një dhomë në kat të tretë dhe një shumë prej 20400 eurosh, dy ora Rolex dhe disa bizhuteri në një vend të fshehtë brenda një tavoline në kat të dytë.

Sipas të dhënave të rezultuara nga vendimi gjyqësor janë dërguar për gjykim shtetasit Alfredo Hamzai¹⁷, Kiritsis Lazaros, Xhesi Islama, Erik Islama, Arten Hamzai, Alfonso Uribe Mejia, Paris Dedej, Ilir Licaj, Dorjon Kalemaj, Jurgen Kalemaj, Mohamed Bouchal, Rosalino Mosquera Caicedo, Reshat Godo, Geron Zenjelaj, Amarildo Hodaj alias Amarildo Mandi, Gazmir Vladi, Miguel Carabali, Donis Hoxha, Klodian Bacja, Diego Velasco Sarria.

Nga tërësia e vendimit gjyqësor janë analizuar faktet për të cilat është dënuar personi nën hetim Alfred Hamzai, në zbatim të parimit mosdënimit dy njëherë për të njëjtën veprë penale, ku rezulton se ai është dënuar për faktet që lidhen me trafikimin e narkotikëve dhe pastrimin e produkteve të veprës penale dhe pushuar akuzat për veprën penale të pastrimit të parave për disa fakte.

Në lidhje me personi nën hetim Alfredo HAMZAI mbante një rol udhëheqës në faza të ndryshme të transportit dhe shpërndarjes së drogës. I pandehuri nuk e kundërshton statusin e tij të udhëheqësit,

¹⁷ Referuar vendimit gjyqësor personi nën hetim Alfredo Hamzai ka këto dënime të mëparshme: - Dënuar me një vendim të Gjykatës së Apelit të Liège më 3 maj 2011, me një dënim prej 4 vjetësh për vepra penale mbi drogërat në rolin e drejtuesit dhe pastrim parash. Ky vendim u bë i formës së prerë në kohën e veprave të reja penale dhe nuk kishin kaluar ende pesë vjet që kur ai kishte vuajtur ose nuk ishte parashkruar. - Dënuar me një vendim të Gjykatës së Apelit të Antëerpit më 2 dhjetor 2020, me katër vjet burg për vepra penale mbi drogërat në tentativë, pjesëmarrje në një organizatë kriminale dhe përsëritje të kriminit. Vendimi kishte marrë formë të prerë në kohën e kryerjes së veprave të reja penale dhe dënimi nuk ishte vuajtur ende ose nuk ishte parashkruar.

por kërkon që periudha e veprave penale që e kanë të bëjnë me të të kufizohet. Alfredo HAMZAI ka pranuar se ka gjetur lëndë narkotike në porte. Megjithatë, ai mohon çdo përfshirje në kapjen, më 3 qershor 2021, të kokainës së fshehur në një kontenier bananeje në portin e Antverpit. Gjykata, duke iu referuar llojeve të pullave të përdorura dhe mesazheve të ndryshme të shkëmbyera para dhe pas këtij sekuestrimi, arriti në përfundimin se nuk kishte dyshim se i pandehuri e kishte porositur atë. Të gjitha komunikimet e tij SKY dhe Signal, të përshkruara më sipër, si dhe mbikëqyrja e shpeshtë e zonave të portit, veçanërisht ato të dedikuara për shkarkimin e fuçive, vërtetojnë mjaftueshëm se ky aktivitet ishte një dukuri e përditshme për të, si në Belgjikë ashtu edhe jashtë vendit. Alfredo Hamzai pranon se ka ripaketuar dhe përpunuar narkotikë të rikuperuar nga anijet. Ai gjithashtu pranoi se ka shitur narkotikë: ai pretendon se ka vepruar si ndërmjetës në importim, duke marrë një komision në narkotikë, të cilat më pas mund t'i shiste në emër të tij. Kjo shpjegon shumën prej afërsisht 200,000 eurosh të gjetura në rezidencën e ish-gruas së tij. Ai kërkon që periudha gjatë së cilës akuzohet të kufizohet në dhjetor 2020. Identifikimi i Alfredo Hamzait në një rol udhëheqës rrjedh nga hetimet fillestare pas kontrollit më 30 shtator 2020. Në veçanti, përgjimet e bisedave midis Xhesi Islamës dhe Indrit Kulajt sugjerojnë se ai mbikëqyrte ekipet e ndryshme të punës. Është e arsyeshme të konsiderohet se ai mbante një pozicion udhëheqës brenda organizatës të paktën që nga momenti kur Indrit Kulaj u ndalua në Spanjë më 19 janar 2020. Prandaj, ndjekja penale do të jetë e kufizuar për aq sa filloi në atë datë. Gjatë kësaj periudhe, i pandehuri ishte i përfshirë në të gjitha fazat e operacionit, duke vepruar si koordinatori qendror: eksport, transport, ryshfet, nxjerrje, ruajtje, përpunim dhe paketim në laborator, dhe rishitje në Belgjikë dhe në të gjithë Evropën. Si të tilla, akuzat kundër tij konsiderohen të bazuara.

Gjithashtu janë vlerësuar edhe akuzat që lidhen me pastrimin e parave në ngarkim të personit nën hetim Alfredo Hamzai, si më poshtë : Nuk ka deklaruar të ardhura në Belgjikë që nga viti tatimor 2014, dhe ka fshehur ose transferuar pasuri të rrjedhura nga vepra penale, konkretisht midis 1 janarit 2020 dhe 15 shkurtit 2022:

- G.1.1. Pasuri dhe sende me vlerë të fshehura në apartamentin e vendosur në Dascottelei 130 në 2100 Angers, dhe konkretisht:
 - G.1.1.1. Shuma parash në total prej 198,450 €, të shpërndara në tufa kartëmonedhash,
 - G.I. 1.1.1. në një kapak të vidhosur mbi xhakuzi në banjo,
 - G.I.1.1.2. në dhomën e gjumit të HAMZAI Arten,
 - G.I. 1.1.3. në një Citroën BERLINGO me targë 2 BGD 023
 - G.I. 1.1.4. në një sirtar në dhomën kryesore të gjumit,
 - G. 1.1.1.5. në garazhin në bodrumin e ndërtesës,
 - G.I. 1.1.6. në një xhakëtë të vendosur në holl.
 - G.I.1.2. disa bizhuteri, duke përfshirë:
 - G. 1.1.2.1. Një gur, një byzylyk i fshehur pas bazamentit të dollapit,
 - G.I. 1.2.2. Tetë kuti orash luksoze bosh në garazh,
 - G.I. 1.2.3. Gjashtë diamante me certifikata të gjetura në një komodinë,
 - G.I.1.2.4. Një orë dore Rolex, me një vlerë të parashikuar prej 50,000 €,
- G.1.2. Investime të luajtshme dhe të paluajtshme të kryera në Shqipëri, duke përfshirë:
 - G.I.2.1. Një jaht Ferretti, me vlerë të papërcaktuar,
 - G. 1.2.2. Një bar-restorant-klub, me një sipërfaqe prej 9944.7 m², i vendosur në Ujin e Ftohtë, operonte sipas një marrëveshjeje qiraje të datës 9 korrik 2019, të nënshkruar në Vlorë para Noteres

Belona SERAJ, midis, nga njëra anë, Artur SHEHU (qiradhënës), i përfaqësuar nga Leonard BISHAJ, dhe kompanisë SUMER DEPO 2019,

G.1.2.3. Një projekt pasurish të patundshme KRISTAL në Vlorë, Shqipëri,

G.1.2.4. Aksione në një kompani shqiptare, ARD1BAKERY.

Gjykata ka dënuar personin nën hetim HAMZAI Alfredo nga akuzat A. 1.1 (e kufizuar), B. 1.1 (e kufizuar), F. (e kufizuar), G.I.1.1.1, G.I.1.1.2, G.I.1.1.3, G.I.1.1.4, G.I.1.1.5, G.I.1.1.6, G.I.1.2.1 dhe G.I.1.2.3 (të rikualifikuara nga Çështja I), si shkelës i përsëritur i veprave penale, vepra këto të lidhura me trafikun dhe pastrimin e parave dhe ka liruar nga akuzat për faktet penale nga akuzat G.1.1.2.2, G.1.1.2.4, G.1.2.1, G.1.2.2., G.1.2.3. dhe G.1.2.4. të rikualifikuara (të çështjes I).

Në lidhje me personin nën hetim **Arben ISMAILAJ** arsyetohet se, procedurat zbuluan se hetimi italian në lidhje me të u mbyll me një dekret pushimi në Itali, i cili është i barabartë me pushimin e çështjes dhe jo me një lirim përfundimtar, për të njëjtat vepra penale, veçanërisht pasi ato u kryen në Belgjikë.

Prandaj, gjykata do të shqyrtojë provat kundër ISMAILAJ Arben në dritën e akuzave kundër tij. Midis 1 janarit 2018 dhe 16 shkurtit 2022, vepra e fundit penale u krye më 15 shkurt 2022 nga Arben Ismailaj. Ky i pandehur dyshohet se është i përfshirë në krim të organizuar, ose të paktën në pastrim parash, siç dëshmohet nga bisedat e tij telefonike me Alfredo Hamzain, veçanërisht nëpërmjet ËhatsApp: Sipas Zyrës së Prokurorit Publik, në thelb: Ai nuk mund të mos ishte në dijeni se Alfredo Hamzai ishte i papunë dhe për këtë arsye nuk mund të zotëronte ligjërisht fonde të mjaftueshme për të investuar në blerjen e ndërtesave dhe hoteleve të shumta. Lidhjet e ngushta të Arben Ismailajt me pushtetin politik shqiptar i lejuan atij të lehtësonte investime të tilla. Provat nga hetimi evropian i vitit 2018 do të hidhnin dritë mbi njohuritë e tij se HAMZAI Alfredo ishte i përfshirë në trafikun e kokainës, pasi ISMAILAJ dyshohet se i kishte thënë se kishte nevojë për kokainë "të bardhë".

- Gjykata vëren: « Se ka vetëm një përmbledhje të një pjese të hetimeve spanjolle dhe italiane, të cilat janë të paqarta, pasi çështja spanjolle që daton që nga viti 2018 është ende nën hetim kundër disa individëve. Lidhur konkretisht me ISMAILAJ Arbenin, gjatë procedurave doli në pah se autoritetet gjyqësore italiane, pas një pjese të hetimit të kryer në Itali, kishin lëshuar një vendim për arkivimin e çështjes në atë vend. Shkëmbimet në ËhatsApp midis HAMZAI Alfredos dhe ISMAILAJ Arbenit bien brenda fushëveprimit si të komunikimeve familjare ashtu edhe të aktivitetit profesional të këtij të fundit si agjent i pasurive të paluajtshme, duke justifikuar diskutimin e tij për investimet në pasuri të paluajtshme me kushëririn e tij, i cili, sipas shpjegimeve të dhëna në seancën dëgjimore, është bashkëpronar i tokës në Vlorë, Shqipëri. Letërporosia ndërkombëtare e ekzekutuar në Shqipëri, megjithatë, nuk e vërtetoi pronësinë e pasurive të paluajtshme të HAMZAI Alfredos. Këto elemente e shtojnë gjykatën të lirojë të pandehurin nga çdo pjesëmarrje në një organizatë kriminale. Midis 1 janarit 2020 dhe 15 shkurtit 2022, Ismailaj Arben bëri investime në pasuri të paluajtshme në Shqipëri, veçanërisht në një kompleks privat vilash të quajtur "Green Coast Resort". Përfshirja e Ismailaj Arben në vepra penale që gjenerojnë pasuri të paligjshme në Belgjikë nuk është vërtetuar mjaftueshëm. Nuk është demonstruar, në veçanti, se investimet e supozuara të këtij të pandehuri, i cili është gjithashtu agjent pasurish të paluajtshme, lidhen me trafikun e drogës që është objekt i akuzave A dhe B. Prandaj, ai do të lirohet nga akuza e rikualifikuar i pandehuri ISMAILAJ Arben lirohet nga

akuzat A.1.3., B.1.3. dhe G.7. (të rikualifikuara) (në Çështjen I) dhe procedurat pushohen pa shpenzime » .

Nga arsyetimi i vendimit gjyqësor, por dhe nga përmbledhja e dërguar nga autoritetet belge mësohen të dhëna të rëndësishme mbi takime¹⁸ dhe njohje ndërmjet personave nën hetim Artur Shehu, Arben Ismailaj, takime këto të zhvilluara në Majorka, Gjermani Aruba, apo Belgjikë; të dhëna mbi takime të kryera nga ana e tyre me përfaqësues funksionarë të lartë shtetërore të shtetit shqiptar në Aruba, përmendim këtu Takimet e vëzhguara në janar-shkurt 2019,¹⁹ të cituara në vendimin e gjykatës: Një hetim evropian i vitit 2019 mbi aktivitetet e një "Klani OSMANI" me seli në Majorka, zbuloi disa vëzhgime të bëra gjatë takimeve, duke përfshirë:

- në ishullin e Arubas (Antilet Holandeze), nga 24 deri më 31 janar 2019, ku morën pjesë ISMAILAJ Arben, MEMETI Elton, RAMA Adrian, SHEHU Artur dhe SHEHAJI Bujar;
- në Antëerp midis 12 dhe 14 shkurtit 2019, midis RAMA Adrian, MEMETI Elton, ISMAILAJ Arben dhe HAMZAI Alfredo, të cilët dyshohet se u transportuan nga Zaventem në Antëerp me Ford Kuga të KULAJ Indrit.

Sipas provave të pjesshme të paraqitura, këto takime duket se kanë të bëjnë me projekte pasurish të paluajtshme në Shqipëri, potencialisht të financuara me fonde të paligjshme, me mbështetjen e autoriteteve politike. Megjithatë, nga ky hetim i vazhdueshëm nuk mund të dalë asnjë siguri në lidhje me lidhjen midis këtyre individëve, shumica e të cilëve nuk janë ndjekur penalisht, dhe importeve të drogës në Belgjikë që janë objekt i ndjekjes penale.

Gjithashtu, parashtrohet kjo përmbledhje e përfshirjes së personit nën hetim Artur Shehu në lidhje me hetimet e zhvilluara nga autoritete belge për personin nën hetim:

- Duket qartë se Artur Shehu mban një pozicion drejtues brenda organizatës. Kjo për shkak se:
- Ai është në kontakt të drejtpërdrejtë me HAMZAI Alfredo dhe duket se e ka takuar atë në Antverp, Belgjikë, më 12 shkurt 2019, gjatë një takimi me Arben ISMAILAJ, Adrian RAMA dhe Elton Memeti;
- Ai udhëton nëpër botë për të marrë pjesë në takime për të organizuar trafikimin;
- Ai duket plotësisht i vetëdijshëm për investimet në pasuri të paluajtshme, por është qartësisht i lidhur me trafikimin e kokainës, me shumë mundësi duke mbikëqyrur rrjetin.

Mbi bazën e këtyre të dhënave, në lidhje me personat nën hetim Alfredo Hamzai dhe Arben Ismailaj kërkohet caktimi i masës së sigurimit për fakte penale të ndryshme nga ato për të cilat ato janë gjykuar, si dhe të dhënat e përfutuara nga aktet hetimore dhe gjyqësore të autoriteteve belge dhe spanjolle, në lidhje me personat nën hetim paraqesin rëndësi për hetimin për shkak të lidhjes së tyre me provat e tjera të marra gjatë këtyre hetimeve.

2.3.4 Letërporositë e dërguara nga autoritetet e drejtësisë Franceze, Angleze, Spanjolle, Belge, Italiane, si dhe letërporosi drejtuar autoriteteve Turke, të Paraguajt e Holandës për të cilat pritet përgjigje e tyre, si më poshtë vijon:

¹⁸ Për më tepër referohu tek akti hetimor të dërguar nga autoritetet belge « Procesverbal vijues nr. 020379/2022-25-07-22 dosje Dosje gjykatësi hetues:2020/138 - Gjykatësi hetues - Bruksel HUGUET « Përmbledhje e elementëve që implikojnë SHEHU Artur ».


¹⁹ Kartoni 90, dosja 1, prova 1.

Në kuadër të hetimeve janë marrë me anë të letërporosisë Pinet: “**30T4KH** - Adrian Rama; **L0S9EF** - Adrian Rama; **VZRTJ2** – Elton Memeti; **7B9F5E** - Alfredo Hamzai; **OR2YRR**-Alfredo Hamzai; **AIMCSV** - Ardian Zykaj; **60CEA0** dhe **K4LX0K** - Luçiano Koçeku; **E80POD** – Orgest Birçaj, si edhe në vijim të leximit dhe analizimi të paketave të komunikimeve të PINEVE të sipërcituar, janë dërguar letërporosi për sasi të lëndëve narkotike të cituara prej tyre mbi vendet ku ju janë sekuestruar, për të cilat pjesëtarët e këtij grupi kriminal kanë pasur komunikime të lidhura me përkatësinë e tyre në to, ku një pjesë e tyre është ekzekutuar, konkretisht letërporosia e dërguar nga autoritetet belge, ajo e dërguar nga autoritetet spanjolle për sekuestrimin e sasisë prej 441 kg (*marrë nga një procedim tjetër*), letërporosia e dërguar nga autoritetet italiane për kapjen e dy sasive të lëndëve narkotike që lidhet me personin nën hetim Orgest Birçaj, ajo e dërguar nga autoritetet angleze që lidhet me sasi të lëndës të sekuestruar që i përket grupit kriminal të drejtuar nga personi nën hetim Luçiano Koçeku; letërporosi dërguar autoriteteve turke lidhur me arrestimin e disa shtetasve turk, për të cilët Alfredo Hamzai shprehet se nga ky arrestim ka humbur shume para, dhe letërporosi dërguar autoriteteve hollandeze lidhur me sekuestrimin e një sasie lënde narkotike, që referuar komunikimeve në SkyEcc, i përket personit nën hetim Alfredo Hamzai.

Pin në SKYECC dhe përdoruesit e identifikuar

PIN NË SKYECC	NICKNAME	IDENTIFIKUAR
	...	
	I'm Back, VIII..17..17, VIII..17..17...	
7B9F5E	VIII..17..17..n1bc 712168.. VIII..17..17..n1bc 712169 VIII..17..17..n1bc 716351 Vlora, gnc vlore, vll..vl..17	Alfredo Hamzai <i>alias</i> Gene Bedini
AIMCSV	...	Ardian Zykaj
AIMCSV	88888888	Ardian Zykaj
NY6N4T	Gamba	Indrit Kulaj
60CEA0	loku	Luçiano alias Artur Koçeku
60CEA0	loku idlehail halfeline	Luçiano alias Artur Koçeku
60CEA0	loku n1bc 712167	Luçiano alias Artur Koçeku
K4LX0K	Lokuu neë	Luçiano alias Artur Koçeku
K4LX0K	Self	Luçiano alias Artur Koçeku
FF789D	Hidrauliku/Hidroliku/hidrualik/hidrualik no1bc 712169	Din alias Abedin Koçeku
D787B0	Sky tt	Astrit Vladi
3E0D4C	Tesla/Tessla	Kastriot Vladi
GGL7ID	Vin/ vin lokut	Ervin Koçeku

BA22CB ONJNHP D5A455	VVVVVV .../Nari/ RS8/ Sq8 12123/...	Elvis Vladi Dritan Aga I pidentifikuar - laborator
BDF588	Bro Pm/Bro+Pm/ Exclu+PM/Pallmall/ Pallmall. No1bc: 711626/ Pallmall. Offline 4 hrz/ Pallmall.+++No1bc:+711626/ Pallmall.+Cipher+:EFB04CCB/ pallmall+No1:711626+Cid:EEF05D9Eetj	I pidentifikuar-shumat monetare
PD599S EI743I	.../morris/morris.n/ maranej Billi/Prada/Rs2	Skender Sufa I pidentifikuar- rasti Birmingham
BE684F BE684F D3YFDU	doraemon neë E80POD Doraemon????????	Orgest Bircaj Orgest Bircaj Orgest Bircaj
D3YFDU	Doraemon 🤩 7 🤩 7 🤩 7 🤩 7 🤩 7 🤩 7 🤩 7	Orgest Bircaj
D3YFDU	Doremon 7777777	Orgest Bircaj
D3YFDU	Ndgd	Orgest Bircaj
D3YFDU	doraemon 🤩 7 🤩 7 🤩 7 🤩 7 🤩 7 🤩 7 🤩 7	Orgest Bircaj
GJ9GKË E80POD A9C3A8	Doraemon???????	Orgest Bircaj Orgest Bircaj Orest Sota
VZRTJ2 30T4KH L0S9EF	.../..../Vlora/vlora/ vlora BC1 : 716688/ vlora BC1 : 716689 Nito	Elton Mehmeti Adrian Rama Adrian Rama
LVR8GA	.../NOTAR/NOTARI	Arsen Gerbi
8KHUUH 8KHUUH 8KHUUH 8KHUUH 8KHUUH 8KHUUH	Eminem Emm No Nickname No+Nickname Paris Paris ëith love ?	
FF8A0F VBG4AF VBG4AF	Arturo Arturo ?? Arturo 🤩 🤩	
O9DË90	D.2	Dionis Hoxha



Nga hetimet e kryera deri në këto momente janë përfutur prova, të cilat mbështesin dyshimin e arsyeshëm të bazuara në prova, për ekzistencën e grupeve kriminale të përbërë nga shtetas shqiptar, të përfshirë në trafikim të lëndëve narkotike dhe pastrim të produkteve penale, si më poshtë vijon:

2.4. Veprimtari kriminale e trafikimit të lëndëve narkotike

Grupi kriminal është i përbërë nga personat nën hetim Alfredo Hamzai *alias* Genc Bedini (*i dënuar në Belgjikë për këtë veprimtari kriminale*), Ardian Zyka, Orgest Birçaj, Orest Sota, Adrian Rama, Elton Mehmeti, Dritan Aga, Luçiano (*alias* Artur Koçeku), Kastriot Vladi, Astrit Vladi, të cilët bashkëveprojnë me njëri-tjetrin në veprimtarinë kriminale të trafikimit të narkotikëve, ku përfshihen si në ngarkesa të përbashkëta, por nga ana tjetër kanë rrjetin e tyre të trafikimit të narkotikëve me karakteristikat e tyre përkatëse.

Veprimtaria kriminale e trafikimit të lëndëve narkotike ka konsistuar në:

1. Trafikimi ndërkombëtar i lëndëve narkotike i kryer nga Amerika Latine (*Kolumbia, Ekuador, Bolivia, Surinam, Paraguai, Uruguai, Porto-Riko e Brazil*) në drejtim të Evropës, kryesisht në portet Antverp (Belgjikë) dhe Rotterdam (Holandë) përmes kompanive të transportit detar në formën e *qymyrit të drurit, pastave të frutave ose në pako të fshehura* në kontenierë, të cilat në shumicën e rasteve janë kompani të krijuara dhe drejtuara prej tyre posaçërisht për këtë aktivitet, në bashkëpunim të mundshëm brenda shërbimeve doganore në porte të Evropës.

2. Trafikimi i lëndëve narkotike nga shtetet e Amerikës Latine drejt Evropës realizohet përmes kompanive tregtare të frutave, mishit, qymyrit dhe sojës. **Përpunimi dhe ekstraktimi kimik** kryhet në magazina apo ambiente të marra me qira në disa shtete europiane, kryesisht në Hollandë dhe Belgjikë. Këto lëndë shpërndahen më pas në disa shtete të BE-së, me një çmim që varion nga 26,000 deri në 30,000 euro për kilogram. Shitja kryhet në territore ku dukshëm furnizimi mbulohet vetëm nga prurjet e tyre, si Belgjika, Holanda, Britania e Madhe, Irlanda, Italia dhe Spanja.

Ky aktivitet është i shtrirë në disa vende, ku përveç aleancave dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me grupe të ndryshme kriminale që operojnë në shtete të ndryshme (*si hollandeze, belge, turke, izraelite, italiane, polake, braziliane, britanike, si dhe kartele të drogës nga Kolumbia, Paraguaji dhe Ekuadori*), grupet kriminale shqiptare bashkëpunojnë mes tyre në këtë veprimtari, ose ndihmojnë njëri-tjetrin në procese të ndryshme, sipas njohjeve dhe lidhjeve që kanë në vendet ku transportohet lënda narkotike.

Personat nën hetim Alfredo Hamzai, Luçiano Koçeku, të cilët janë drejtues të grupeve kriminale që trafikojnë lëndë narkotike, mundësojnë zinxhirë të ndryshëm të veprimtarisë kriminale duke patur kontroll të plotë si të burimit prej nga vjen lënda narkotike, të pikave se ku do të kalojë tranzit dhe më pas në transportimin drejt magazinave (vende të marra më qera nga persona vendas / te huaj që janë të pastër për autoritetet sipas vendeve), tek përpunimi kimik (me gjetje të materialeve përpunuese dhe ekspertet kimist), me paketimin dhe logot identifikuese të tyre në tregun e narkotikëve; në ruajtjen e mjeteve dhe ambienteve ku gjendet lënda narkotike duke u mundësuar

vendosje të pajisjeve të llojit GPS në to, kamera si dhe pajisje të cilat bllokojnë valët nëse në to (lëndën narkotike) ka pajisje gjurmuese të tjera veç atyre të vendosur nga ata; me transportin më pas nëpër Evropë si Belgjikë, Hollandë, Itali, Mbretëri e Bashkuar (përmes makinave në të cilat janë krijuar me vende të fshehta dhe në disa raste edhe përmes linjave ajrore me anë të avionëve të vegjël në përmasa të përdorur nga ta).

Personat nën hetim Alfredo Hamzai, Luçiano Koçeku kanë bashkëveprim të vazhdueshëm, të cilët investojnë dhe shpenzojnë në lidhje me një laborator të ndodhur në Kolumbi e Ekuador, me përgjegjës shtetas shqiptar²⁰, i cili siguron furnizim, përpunim, rrugë transporti për shumë grupe kriminale shqiptare; përfshihen në trafikim të lëndëve narkotike nga këto shtete, e dokumentuar kjo me kapjen e sasisë prej 441 kg në Barcelonë Spanjë; përfshihen në përpunimin e lëndës narkotike në Belgjikë, me qëllim trafikimin më pas në vende të tjera; si dhe përfshihen në transportim të lëndëve narkotike nga këto shtete në drejtim të Evropës, duke ndarë fitimet dhe shpenzimet; ata ndihmojnë njëri-tjetrin në dërgimin e forcës punëtorë në laboratorin në Ekuador, siç është rasti i personit nën hetim Dritan Aga, Arsen Gerbi dhe Muhamet Mersini; udhëtimi i cili organizohet nëpërmjet prerjes së biletave pranë agjensisë nëpërmjet personit nën hetim Orgest Birçaj, nëpërmjet shoqërisë "Top Seven" sh.p.k., me aktivitet ndër të tjera agjensi udhëtimi.

Personat nën hetim Alfredo Hamzai dhe Luçiano Koçeku për shkak të lidhjeve direkte me laboratorin e ndodhur në Ekuador e Kolumbi, konsiderohen si furnizues të lëndës narkotike, sipas kërkesave që kanë personat nën hetim Orest Sota, Orgest Birçaj, Adrian Rama e Elton Memeti; personi nën hetim Alfredo Hamzai, siguron informacione në lidhje me ngarkesat që kontrollohen dhe problematikat që ata kanë në trafikimin që vetë personat nën hetim kryejnë në kuadër të trafikimit të lëndës narkotike; ndërsa personi nën hetim Orest Sota për shkak të lidhjeve që ai ka në Shqipëri ofron informacione nëse në Shqipëri ka të dhëna për personat nën hetim.

Nga ana tjetër sigurohet treg për shitje masive si dhe transport në vende të ndryshme të Evropës si në Itali nëpërmjet personave nën hetim Orgest Birçaj dhe Orest Sota, të cilët kanë rrjetin e tyre të trafikimit, në Angli nëpërmjet personit nën hetim Luçiano Koçeku dhe në Zvicër nga personat nën hetim Elton Memeti dhe Adrian Rama; ata sigurojnë lëndë narkotikë dhe transport për njëri-tjetrin sipas kërkesave të shpejta që ata, duke bashkëvepruar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme në drejtim të veprimtarisë kriminale të trafikimit të lëndë narkotike.

Personi nën hetim Luçiano Koçeku nga ana tjetër ka rrjetin e tij të trafikimit të lëndëve narkotikëve të drejtuar, pjesë e të cilit janë vëllëzerët e tij Luçiano Koçeku të cilët veprojnë në drejtimin e këtij të fundit kryesisht në Angli dhe Belgjikë si dhe personat nën hetim Astrit Vladi e Kastriot Vladi, si dhe persona të tjerë të paidentifikuar për të cilët po vijojnë hetimet.

Personat e përfshirë në këtë veprimtari kriminale e njohin njëri-tjetrin; ndihmojnë njëri-tjetrin në veprimtarinë e trafikimit të lëndëve narkotike, si dhe ato organizohen në pastrimin e parave, si dhe ndihmojnë njëri-tjetrin me veprime aktive konkrete në këtë veprimtari të pastrimit të parave, duke gjeneruar dhe pastruar miliona euro nga kjo veprimtari kriminale.

Edhe pse personat nën hetim janë të kujdesshëm në komunikimet që ata kryejnë për shkak të dënisë së tyre mbi hapjen e komunikimeve të Encrochat, si dhe mundësisë për të ndërhyrë edhe në komunikimet SkyEcc, nga analizimi i komunikimeve të tyre, por edhe shënimeve të mbajtura, rezulton e provuar:

²⁰ Përdorues i Pin D5A495 i paidentifikuar.

-Personat nën hetim Alfredo Hamzai, Orgest Birçaj dhe Luçiano Koçeku në bashkëpunim të veçantë me njëri-tjetrin, me persona të tjerë një pjesë e të cilëve të arrestuar apo të paidentifikuar kanë trafikuar lëndën narkotike “Kokainë” prej 441 kg në Spanjë, Barcelonë ku janë arrestuar shtetasit Indrit Kulaj, Dashamir Shera, Enton Ahmataj e Gian Luca Ciprian.

-Ata në bashkëpunim me njëri-tjetrin e me persona të tjerë një pjesë e të cilëve të arrestuar apo të paidentifikuar kanë përpunuar në mënyrë masive lëndë narkotike, në magazinat e ndodhura në Belgjikë dhe Holandë, ku gjatë kontrolleve të kryera në këto magazina janë konstatuar, ndër tjera, përbërës kimik, lëndë narkotike, pajisje e shënime për shpenzime të kryera nga personat nën hetim.

-Në kuadër të kësaj veprimtarie kriminale janë përftuar të dhëna në lidhje me rënie të sasive të konsiderueshme, gjatë trafikimit me të njëjtën mënyrë të vepruari të grupit kriminal të personit nën hetim Luçiano Koçeku të dërguara nga Paraguaji nëpërmjet shoqërisë “Maxi Grans” në pronësi të shtetasit Luis Sebrano, i arrestuar për trafikim të lëndëve narkotike.

-Në datat 17 dhjetor 2020 janë sekuestruar 600 kg; në datën 25 dhjetor janë sekuestruar 1.2 ton; në datën 24 dhjetor janë sekuestruar 1 ton lëndë narkotike kokainë dhe në datën 24.04.2020 një ton *(sasi për të cilat Luçiano Koçeku është shprehur se i janë sekuestruar nga autoritetet ligjzbatuese).*



-Më datë 29.05.2020, në Angli u sekuestrua një sasi prej 162 kg kokainë e trafikuar nga grupi kriminal. Besohet se gjatë periudhës 2 maj – 29 maj 2020 është trafikuar një sasi totale prej 882.5 kg, e cila i atribuohet grupit kriminal të personit nën hetim Luçiano Koçeku.

-Në datën 28.10.2020 është sekuestruar sasia prej 1.435 kg lëndë narkotike kokaine në Portin e Roterdamit, që i përket personit nën hetim Alfredo Hamzai.

-Në datat 21.06.2020 është sekuestruar në Itali lëndë narkotike “*cannabis sativa*” dhe në datën 01.07.2020 është sekuestruar një sasi lënde narkotike prej 22.026 kg kokainë që i përket personit nën hetim Orgest Birçaj.

Gjithashtu, janë përftuar të dhëna në lidhje me rënie të sasive të tjera të mëdha, për një pjesë janë dërguar letërporositë dhe për të tjerat po përgatiten letërporositë përkatëse.


2.4.1 Nga tërësia e bisedave të kryera mes tyre në platformën SKY ECC ndërmjet personat nën hetim Luçiano Koçeku (përdorues i PIN K4LXOK dhe 60CEA0, i njohur në komunikimet mes tyre e pseudonimin “loku”), të cilit i jemi referuar në pikën 5.5.2, konstatohet se ai ka komunikime të vijueshme në kohë me personin nën hetim, Alfredo HAMZAI përdorues i PIN 789F5E (me pseudonimin identifikues Vlvl..17..n1bc 716351 dhe ndër te tjera Vlora edhe gnc) të cilat provojnë lidhjen e ngushtë mes tyre dhe pjesëtarëve të tjerë të grupeve të cilët ata drejtojnë, në krijimin e laboratorëve në Ekuador/Kolumbi/ Paraguaj të mbledhjes dhe përpunimit të parë të lëndës narkotike dhe fshehjes së saj në mallrat-produktet që do të importohen nga Amerika Latine, për në Evropë, në nxjerrjen e saj nga Portet e Antëerp dhe Rotterdam gjatë mbërritjes me konteniere të kamufluar në produkte të ndryshme (*qymyr, soje, sheqer dru etj*), në magazinimin dhe përpunimin e saj në Evropë, nëpërmjet kimistëve, në paketimin dhe transportimin e saj në shtetet e ndryshëm Evropiane nëpërmjet zinxhirit të tyre ku gjenden edhe shperndaresit fundor *(të kontrolluar po prej tyre)* apo bashkëpunimit të vazhdueshëm me personat e tjerë nën hetim si, Orgest Birçaj, Orest Sota e Adrian Rama e Elton Memeti, të cilët bashkëveprojnë në këtë aktivitet kriminal.



2020-12-14 10:43:12	D3YFDU		IMG-1607942591590	7B9F5E, D3YFDU
2020-12-14 10:44:36	7B9F5E		Me von te them po pres njeriun andej te zgjuhet	7B9F5E, D3YFDU
2020-12-14 11:01:40	D3YFDU		IMG-1607943700179	7B9F5E, D3YFDU
2020-12-15 14:27:45	D3YFDU		ca po ben vlla si kalon	7B9F5E, D3YFDU
2020-12-15 14:28:37	7B9F5E		Mire vlla si te kam	7B9F5E, D3YFDU
2020-12-15 14:29:22	D3YFDU		mire o vlla te njejtat e un	7B9F5E, D3YFDU
2020-12-15 14:29:45	D3YFDU		sja ben dot ate daljen nga brazil me 100 atyre cunave	7B9F5E, D3YFDU
2020-12-15 14:29:49	7B9F5E		Biletën per datën 21 do bejm	7B9F5E, D3YFDU
2020-12-15 14:29:49	D3YFDU		nga dursi	7B9F5E, D3YFDU

2.4.2 Gjithashtu, edhe personi nën hetim Orgest Birçaj ka komunikime të shumta me personin nën hetim Alfredo Hamzai, në drejtim të trafikimit të lëndëve narkotike, ku ata bashkëpunojnë edhe me personi nën hetim Orest Sota, si në trafikim ashtu edhe në atë pastrimit të produkteve të veprës penale.

Personi nën hetim Orgest Birçaj në kuadër të bashkëpunimit me personat nën hetim dhe furnizimit prej personit nën hetim Alfredo Hamzai ka patur dy sekuestrime në Itali, në një nga rastet i është sekuestruar kokainë, të provuara këto nga aktet hetimore të dërguara me letërporosi nga autoritetet italiane, si më poshtë vijon:

Lidhur me përfshirjen e **Orgest Birçaj** në trafikun e lëndëve narkotike dhe bashkëpunimin me personin nën hetim Alfredo Hamzai dhe anëtarë të tjerë të grupit kriminal, nga analiza e komunikimeve në SkyEcc, dokumentohet fakti se në datën 16.07.2020, personi nën hetim Orgest Birçaj i dërgon Alfredo Hamzait disa foto të disa pakove të kokainës dhe i kërkon 5 pako kokaine për një shokun e tij nga Suedia.

2020-07-16 13:49:24	E80POD		IMG-1594907363293	7B9F5E, E80POD
2020-07-16 13:49:42	E80POD		IMG-1594907381430	7B9F5E, E80POD

2020-12-24 09:14:59	A9C3A8	jo jo	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-24 09:15:06	7B9F5E	Po te thash , pak vones u be po bem gje te mire shum	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-24 09:15:09	A9C3A8	me 31 do i them	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-24 09:15:18	A9C3A8	Vella	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-24 09:15:29	A9C3A8	30 e marr un nga ti	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-24 09:15:33	A9C3A8	dhe do te bej leket ai	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-24 09:15:45	7B9F5E	Ca cemimi do akoma	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-24 09:15:47	A9C3A8	do dhe 15 cop te tjera	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-24 09:15:54	7B9F5E	Fol vet	7B9F5E, A9C3A8

2020-12-24	A9C3A8	ok vella	7B9F5E, A9C3A8
09:15:58			
2020-12-24	A9C3A8	po se me pyeti dhe te jemi nje mendje	7B9F5E, A9C3A8
09:16:09			
2020-12-24	7B9F5E	Cilesin e kemi ber top top	7B9F5E, A9C3A8
09:16:53			
2020-12-24	A9C3A8	Super	7B9F5E, A9C3A8
09:19:54			
2020-12-24	A9C3A8	nise 2 tonshen	7B9F5E, A9C3A8
09:20:01			
2020-12-24	A9C3A8	Haha	7B9F5E, A9C3A8
09:20:03			
2020-12-24	A9C3A8	tani per nje jav ben leket tp	7B9F5E, A9C3A8
09:20:13			
2020-12-24	A9C3A8	do dhe 15 cop	7B9F5E, A9C3A8
09:20:16			
2020-12-24	7B9F5E	Gati po behen	7B9F5E, A9C3A8
09:20:22			
2020-12-24	A9C3A8	Ok	7B9F5E, A9C3A8
09:20:47			
2020-12-24	7B9F5E	20 do i coj	7B9F5E, A9C3A8
09:20:48			
2020-12-24	A9C3A8	Super	7B9F5E, A9C3A8
09:20:49			
2020-12-24	A9C3A8	Ok	7B9F5E, A9C3A8
09:20:53			
2020-12-24	7B9F5E	Po ja coj edhe 15	7B9F5E, A9C3A8
09:21:02			




2020-12-24
09:21:19
2020-12-24
09:21:20

A9C3A8
A9C3A8


ok ja te flas dhe te them
Vella

7B9F5E,
A9C3A8
7B9F5E,
A9C3A8



Nga analiza e komunikimeve në SkyEcc mes personave nën hetim Alfredo Hamzai dhe Orest Sota, është evidentuar dhe fakti se Orest Sota është përfshirë gjithashtu dhe në transportin e parave cash. Në datën 16.04.2020 Alfredo Hamzai (7B9F5E) i shkruan Orest Sotës (A9C3A8) “Po gati ne vl 150 eur ke; Dergo njeri te bari te unversiteti; Per pak te dergoj nr; Po thuaj te unversitet pavarasia te conadi ne vl; Ok vlla e pret ai njeriu im; Tani shkon; 5 min thuaj; Asllan e ka emrin qe deegove; Ja dha vllla; Per leket ?; Te them vllla; Mire vllla; E takove njeriun ti solli leket; 500 mbaj menjan mos i harxho”
Në datën 21.04.2020 Alfredo Hamzai (7B9F5E) i shkruan Orest Sotës (A9C3A8) “Tia le porosin 100 franka; Nuk pres dote; Kesaj sekretares qe esht ketu; Fol shpiegoja; Duhet te kethehem ne vl vllla

Në datën 22.04.2020, Alfredo Hamzai i shkruan Orest Sotës “Vllla 100 po te bej gati sot; Po vllla rruges esht; 240 do i coj, do i vinte me vones nje qi ti plotsonte 300, po pamerek do bej te tjera shpejt; Thuaj shokut pa merak, u vonua nje mik”.

<p>2020-04-22 13:09:07</p>	<p>7B9F5E</p>	<p>Villa 100 po te bej</p> <p>2020-04-21 08:16:37 7B9F5E 2020-04-21 08:16:54 7B9F5E 2020-04-21 08:17:24 7B9F5E 2020-04-21 08:18:22 7B9F5E 2020-04-21 08:18:51 7B9F5E 2020-04-21 08:19:17 7B9F5E</p> <p>Tia le porosin 100 franka Nuk pres dote Kesaj sekretares qe esht ketu Fol shpiegoja Duhet te kethehem ne vl vllla IMG-1587457156000</p>  <p>2020-04-21 08:21:38 7B9F5E 2020-04-21 08:21:54 7B9F5E 2020-04-21 08:22:21 7B9F5E 2020-04-21 08:22:28 7B9F5E 2020-04-21 08:25:18 7B9F5E 2020-04-21 08:25:22 7B9F5E</p> <p>Villa fole me sekretaren Tia jap kesaj frankat Po fol Edhe ti shpiegoja Po i numeron Ja dhash</p> <p>ti sot</p>
--------------------------------	---------------	--

<p>2020-04-22 13:09:35</p>	<p>7B9F5E</p>	<p>Pak me von te them</p>
<p>2020-04-22 15:30:33</p>	<p>7B9F5E</p>	<p>Po vllla rruges esht</p>
<p>2020-04-22 15:31:59</p>	<p>7B9F5E</p>	<p>240 do i coj, do i vinte me vones nje qi ti plotsonte 300, po pamerek do bej te tjera shpejt</p>
<p>2020-04-22 15:32:31</p>	<p>7B9F5E</p>	<p>100 te them vllla po i ben gati ne tr ky kambisti</p>
<p>2020-04-22 15:33:39</p>	<p>7B9F5E</p>	<p>Sonte o neser ne mngjes</p>

2020-04-22 15:35:00	7B9F5E	Thuaj shokut pa merak, u vonua nje mik
2020-04-22 15:35:39	7B9F5E	Po nesor duhet te vij ai qe prisia
2020-04-22 15:36:37	7B9F5E	240 i ka me vet diali qe po ja con
2020-04-22 15:36:46	7B9F5E	18.00 esht aty



Në datën 27.04.2020, Afredo Hamzai i shkruan Orest Sotës "150 ti plotesoj nesor, edhe 50 te tjera premten; I plotesoj pa merak; Nuk ka vonesa; Me prishi pak terezin keto qe me kethyen vllla; Nuk esht problem nesor 150 te premten 100 do i bej". Komunikimi lidhur me këtë vonë vazhdon dhe në datën 28.04.2020 dhe 29.04.2020, ku Afredo Hamzai fillimisht i dërgon Orest Sotës foto të lëndës narkotike që i është kthyer dhe më pas i thotë "Vllla jam ne siklet qe nuk ja plotesova dote ket jav si lam per leket, po te betohem nuk e prisia te mi kethenin; Mngjesi vllla per pak i mare 150 , me von po ke mundesi dergo njeri ti mari; Ne 16.00 vllla te jet te conadi; Jam me Orgestin vllla , i ke leket te adi , ik me adin per te ngren", duke iu referuar përdoruesit të PIN AIMCSV, përdorur nga Ardian Zykaj. Në datën 28.04.2020 evidentohet një komunikim mes Orest Sotës dhe Ardian Zykaj, ku ky i fundit i shkruan "me prit so di vi aty; ham bashke; dhe te sjell dhe porosine; fola porosita pee te ngrene, ajde te pres atje".

2020-04-27 19:54:56	7B9F5E	150 ti plotesoj nesor , edhe 50 te tjera premten
2020-04-27 19:56:14	7B9F5E	I plotesoj pa merak
2020-04-27 19:56:26	7B9F5E	Nuk ka vonesa
2020-04-27 19:57:02	7B9F5E	Me prishi pak terezin keto qe me kethyen vllla
2020-04-27 19:59:06	7B9F5E	Nuk esht problem nesor 150 te premten 100 do i bej

2020-04-27 20:09:52	7B9F5E	Vllla une punoj me njerzit ne besim nuk i hap njeri pakot ecin me fialen time , puna esht mire me disa teste , kure fillojn njerzit e pin me bidon u dieg fytin plastik del
2020-04-27 20:18:32	7B9F5E	Po nuk erdha do ti dergoj lekt me njeri tjeter
2020-04-27 20:29:48	7B9F5E	Po nuk erdha dote nesor vij pasneser
2020-04-27	7B9F5E	Pa merak per cdo gje si kemi folur


27
20:30:08

per investimin

2020-04-
27
20:31:33

7B9F5E

IMG-1588019492608



2020-04-
27

7B9F5E

Keto jan qe jan kethyer jan ne anvers

20:31:56

2020-04-
27

7B9F5E

Nje pies tjeter esht ne brux, po kam
trasport do i nis vet, te pyesim shokun
po i priset pune ja kethej ja coj ne
denheg ?

20:35:17

2020-04-
27

7B9F5E

Vlla jam ne iklet qe nuk ja plotesova
dote ket jav si lam per leket , po te
betohem nuk e prisia te mi kethenin
Mngjesi vlla per pak i mare 150 , me
von po ke mundesi dergo njeri ti mari

21:18:22

2020-04-
28

7B9F5E

09:58:31

2020-04-
28

7B9F5E

Ne 16.00 vlla te jet te conadi

10:41:28

2020-04-
28

7B9F5E

50 jan

12:18:42

2020-04-
28

7B9F5E

Ec vetem avash

12:19:03

2020-04-
28

7B9F5E

Jo si e ke zakon shum shpejt

12:19:16

2020-04-
28

7B9F5E

Haha

12:19:20
2020-04- 7B9F5E
28
13:21:29

Jam me Orgestin vllla , i ke leket te
adi , ik me adin per te ngren



Komunikimi mes Ardian Zykaj (AIMCSV) dhe Orest Sota (A9C3A8), kryer në vijim të komunikimit mes këtij të fundit dhe Alfredo Hamzai.

2020-04-28	AIMCSV	me prit so di vi aty	A9C3A8, AIMCSV
13:32:44			
2020-04-28	AIMCSV	ham bashke	A9C3A8, AIMCSV
13:32:49			
2020-04-28	AIMCSV	dhe te sjell dhe porosine	A9C3A8, AIMCSV
13:32:56			
2020-04-28	AIMCSV	fola porosita pee te ngrene	A9C3A8, AIMCSV
13:34:43			
2020-04-28	AIMCSV	ajde te pres atje	A9C3A8, AIMCSV
13:34:47			
2020-04-28	AIMCSV	ok	A9C3A8, AIMCSV
13:36:43			


Në datën 06.05.2020 Alfredo Hamzai i shkruan Orest Sotës "I cova shokut ne denhag die 160 eu; Mbrem von naten ja coj njeriu im".

Në datën 27.06.2020, Orest Sota i kërkon Alfredo Hamzait t'i dërgojë para pasi i ka kërkuar, duke u shprehur "ky i pallatit".

2020-06-27	A9C3A8	te marr vesh vella shum mire	7B9F5E, A9C3A8
09:35:07			
2020-06-27	A9C3A8	shiko dergo ndonje lek se me vdiq ky i pallatit	7B9F5E, A9C3A8
09:35:21			
2020-06-27	A9C3A8	vella dhe nuk ka faj	7B9F5E, A9C3A8
09:35:26			
2020-06-27	A9C3A8	plus i mora dhe ketyre te shpise vk	7B9F5E, A9C3A8
09:35:51			
2020-06-27	A9C3A8	dhe me vjen zorr tani nuk po di cfare te bej	7B9F5E, A9C3A8
09:36:03			
2020-06-27	A9C3A8	shiko te bejme dicka vella se nuk po i mbaj me	7B9F5E, A9C3A8
09:36:36			
2020-06-27	A9C3A8	he te keqen ca te them me dhe un	7B9F5E, A9C3A8
09:36:44			

Në datën 30.06.2020, Orest Sota i shkruan Alfredo Hamzait se dikush që është në Itali kërkon 300, duke iu referuar vlerës 300.000 (treqind mijë) euro dhe se këtë shumë parash mund ta kthejë në

Shqipëri. Lidhur me këtë, Alfredo Hamzai i përgjigjet se do flasë me një mik Italian, edhe pse ka patur probleme në veri të Italisë me mbledhjes e parave.



2020-06-30 10:24:39	A9C3A8	kam njerin do ne itali 300	7B9F5E, A9C3A8
2020-06-30 10:25:16	A9C3A8	ok vella	7B9F5E, A9C3A8
2020-06-30 10:25:19	A9C3A8	dhe i jep ketu	7B9F5E, A9C3A8
2020-06-30 10:25:40	7B9F5E	Ja te flas me nje mik italian	7B9F5E, A9C3A8
2020-06-30 10:26:04	A9C3A8	ore meqe nuk i sjellim dot shpejt	7B9F5E, A9C3A8
2020-06-30 10:26:09	A9C3A8	po na ben pune po nuk na ben	7B9F5E, A9C3A8
2020-06-30 10:26:13	A9C3A8	nuk ka problem	7B9F5E, A9C3A8
2020-06-30 10:27:29	7B9F5E	Sa te me pergjigjet italia , ka patur veshtiresi ti mbledhi leket ne nord te italis	7B9F5E, A9C3A8

Në datën 15.09.2020, Orest Sota shkruan se është në Milano. Ai shprehet se është një djalë në Londër që mund të sjellë 141.000 (njëqind e dyzetë e një mijë) euro me 3% interesa, ndryshe nga të tjerët, që janë me 15%.

2020-09-15 12:39:06	A9C3A8	un jam me milano tani po kam kete djalin qe eshte ne	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-15 12:39:21	A9C3A8	londer dhe i sjell 141 eurot qe te thash	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-15 12:39:26	A9C3A8	me 3%	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-15 12:39:31	A9C3A8	ja ngec atje	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-15 12:39:50	A9C3A8	se ndryshe ka vajt me 15 % londra vk	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-15 12:39:59	A9C3A8	dhe mezi po e mbaj qe te mi marri atje	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-15 12:40:01	A9C3A8	lekete	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-15 12:40:09	7B9F5E	Pak stres dergova 2 cuna ne equa mi kethyen	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-15 12:40:11	A9C3A8	dhe shpetojmë ter ato leke	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-15	7B9F5E	Duheshin sezben atje	7B9F5E,

12:40:19

A9C3A8

2020-09-15

A9C3A8 te kuptoj vella

7B9F5E,


12:40:23

A9C3A8


Në datën 17.09.2020, Orest Sota i shkruan Alfredo Hamzait se duhen dërguar 133.000 paund në një pikë këmbimi valutor që të konvertohen në 141.000 euro dhe i shkruan dhe adresën, e cila është “ë2 1ET; 187; Edgëare Road”. Alfredo Hamzai i thotë se “Exchange kjo adres vllla ne qender te londres, aty i kan kapur te gjith cunat shqipetar, nga kamerat te ndalojn sa te shikojn me cant me lek; Kudo qe te jete dajo; Exchanget jane te gjitha tabele qitje; ☹☹; Dajo kjo eshte vendi ku nderroja leket une para 15 vjetesh”

2020-09-17 15:12:23	A9C3A8	duhen cuar 133 pound	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:12:25	A9C3A8	atje	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:12:34	A9C3A8	ja te jap nje adrese	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:13:10	A9C3A8	per ti bere 141 euro	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:14:21	A9C3A8	post code	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:14:26	7B9F5E	Mer adresen ta shikojm sa larg esht	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:14:32	A9C3A8	ë2 1ET	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:14:39	A9C3A8	187	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:14:56	A9C3A8	Edgëare Road	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:15:34	A9C3A8	ne qender fare eshte	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:16:07	7B9F5E	Tani i them	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:16:27	A9C3A8	fol pak per sa vete qe ti them ti bej gati ky	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:16:27	A9C3A8	ok vella	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:29:34	7B9F5E	Exchange kjo adres vllla ne qender te londres, aty i kan kapur te gjith cunat shqipetar , nga kamerat te ndalojn sa te shikojn me cant me lek	7B9F5E, A9C3A8

2020-09-17 15:30:28	7B9F5E	Kudo qe te jete dajo Exchanget jane te gjitha tabele qitje	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:30:57	7B9F5E	☺☺ Dajo kjo eshte vendi ku nderroja leket une para 15 vjetesh	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:31:45	A9C3A8	po mir ore un e gjeta ca te bej tani	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:31:45	A9C3A8	keta jan super korrekt se nderron gjithnje ai shoku	7B9F5E, A9C3A8
2020-09-17 15:31:45	A9C3A8	Tp	7B9F5E, A9C3A8



Në datën 27.11.2020, Orest Sota shkruan se ka marrë 300.000 mijë euro, nga të cilat 200.000 euro ia ka marrë “*djalit nga Roma*” dhe 100.000 euro ia ka marrë “*atij në denhag*” dhe dërgon në bisedë një foto të disa kartmonedhave euro të lidhura në tufa. Në vijim, Orest Sota shkruan se ka bërë “800 për tenderin”, që bazuar në mënyrën e tij të komunikimit, nënkuptohet se ka bërë 800.000 mijë euro për një tender, të cilin nuk e përmend në asnjë moment gjatë komunikimit.

2020-11-27 12:52:31	A9C3A8	djalit nga roma ja mora 200	7B9F5E, A9C3A8
2020-11-27 12:52:31	A9C3A8	dhe atij ne den hag 100	7B9F5E, A9C3A8
2020-11-27 12:52:31	A9C3A8	eshte dhe nje tj aty qe mi ben me nderrim	7B9F5E, A9C3A8
2020-11-27 12:52:31	A9C3A8	kemi mundesi me ?	7B9F5E, A9C3A8
2020-11-27 12:52:33	A9C3A8		IMG-1606480814970 7B9F5E, A9C3A8

2020-11-27 12:52:33	A9C3A8	bera leket e tenderit 800 euro	7B9F5E, A9C3A8
2020-11-27 12:55:24	7B9F5E	Ja sa te filloj neser gjerat pata vones pak dite nga produktet e marr vesh	7B9F5E, A9C3A8
2020-11-27 12:56:43	A9C3A8	kur dalin gjerat ?	7B9F5E, A9C3A8
2020-11-27 13:3:12	A9C3A8	si mendon ti	7B9F5E, A9C3A8
2020-11-27 13:40:17	A9C3A8	Vlla	7B9F5E, A9C3A8
2020-11-27 13:40:21	7B9F5E	Povlllla ok ne regull	7B9F5E, A9C3A8
2020-11-27 13:43:50	7B9F5E	Vonesa esht per produktet qe vin nga larg	7B9F5E, A9C3A8
2020-11-27 13:44:15			

Në datën 02.12.2020, Orest Sota i shkruar Alfredo Hamzait "dhe bej 1 mil qe 500 ti mbaj vet dhe 500 tja jap qorrit; tja japim qorrit dhe te paguaj nga dy gjera te tj tek kafet".

2020-12-02 23:40:01	A9C3A8	dhe bej 1 mil qe 500 ti mbaj vet dhe 500 tja jap qorrit	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-02 23:40:24	7B9F5E	Po po sa te behen pakot e para	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-02 23:40:27	A9C3A8	qia robt harrova fare ne 11:30 eshte aty ai k***	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-02 23:40:51	A9C3A8	qe tja japim ketij	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-02 23:41:26	A9C3A8	tja japim qorrit dhe te paguaj nga dy gjera te tj tek kafet	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-02 23:41:40	A9C3A8	e njerezve per punet aty	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-02 23:41:47	A9C3A8	nderkohe do shkepus me metin	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-02	A9C3A8	sa si	7B9F5E,

23:41:51
 2020-12-02 7B9F5E Ne 08.30 me the
 23:42:07

A9C3A8
 7B9F5E,
 A9C3A8

Në datën 10.12.2020, Alfredo Hamzai i shkruan Orest Sotës që lekët i ka në Vlorë dhe se duhet të flasë me "Adin", që i referohen Ardian Zykës.

2020-12-10 11:35:39	7B9F5E	Leket i ke ne vl	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-10 11:35:56	7B9F5E	Fole me adin	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-10 12:58:33	A9C3A8	folat vlla	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-10 12:58:33	A9C3A8	jam duke vajt ta takoj ate	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-10 12:58:38	A9C3A8	folat vlla	7B9F5E, A9C3A8

Lidhur me komunikimin mes shtetasce Alfredo Hamzai dhe Orest Sota, është evidentuar se në të njëjtën datë, më 10.12.2020, sipas porosisë së Alfredo Hamzai, Orest Sota komunikon me Ardian Zykaj dhe takohen në Vlorë, kjo me qëllim marrjen e një shume parash të papërcaktuar.

2020-12-10 08:48:41	AIMCSV	ne oren 5 mbasdite te jesh ne vlore	A9C3A8, AIMCSV
2020-12-10 09:00:54	A9C3A8	mirmengjes vella ok	A9C3A8, AIMCSV
2020-12-10 14:11:53	A9C3A8	ketu jam	A9C3A8, AIMCSV
2020-12-10 14:11:55	A9C3A8	ku je ti	A9C3A8, AIMCSV
2020-12-10 14:13:07	A9C3A8	po erdha	A9C3A8, AIMCSV
2020-12-10 14:13:14	A9C3A8	10'min	A9C3A8, AIMCSV
2020-12-10 14:13:17	A9C3A8	10 min	A9C3A8, AIMCSV
2020-12-10 14:26:06	A9C3A8	ketu para jam	A9C3A8, AIMCSV


Në datën 20.12.2020 komunikimi mes shtetasve Orest Sota dhe Alfredo Hamzai fillimisht nis lidhur me disa llogaritje që Orest Sota bën lidhur me disa pagesa që duhet të bëjë dhe shprehet "kam vetem hall punen e qorr dhe te tender; dhe te pallatit qe kam marr lek ketyre tr shpis qe te kam then kam 3 muaj".

G-Class


Në datën 17.04.2020 Alfredo Hamzai (7B9F5E) i shkruan Orest Sotës (A9C3A8) “Vihet puna para vllla aty jan makinat, G cfar te duash ti ta gjen vlllai; Me cemimi me inters te mire; Edhe mbas nje viti ta shesesh prap ti maresh leket e tua”. Në vijim, Alfredo Hamzai shkruan “Kjo me nderimin qe bej une shkon 190 eu: Ne dyqan kushton 225 eu”. Ky është një fakt që na bën të dyshojmë lidhur me pronësinë e këtij mjete, në emër të këtij të fundit.

2020-04-17 20:45:31	7B9F5E	I the do blej guroren vetem, a a ka then i hodho lekt aty ky	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 20:45:52	7B9F5E	Pa merak gati i kam ber dy g	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 20:47:12	7B9F5E	Po po vlla nuk diskutohet	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 20:47:22	7B9F5E	Leket te guroria	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 20:54:30	7B9F5E	Vihet puna para vllla aty jan makinat , G cfar te duash ti ta gjen vlllai	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 20:54:45	7B9F5E	Me cemimi me inters te mire	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 20:55:17	7B9F5E	Edhe mbas nje viti ta shesesh prap ti maresh leket e tua	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 20:56:38	7B9F5E	IMC	7B9F5E, A9C3A8



2020-04-17 20:58:00	7B9F5E		7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 21:03:55	7B9F5E	Neser i them atij njeriut tim te dergoj foto me mire	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 21:05:52	7B9F5E	Luxemburg afer me belgijken	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 1:08:07	7B9F5E	Kam folur po thuajse kam ren dakort	7B9F5E, A9C3A8
2020-4-17 21:08:23	7B9F5E	Disa detaie duhet te ndaj	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 21:09:25	7B9F5E	G 63 e di qe jan	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 21:09:46	7B9F5E	Detaiet do shkoj nje njeriu im ti shikoj	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 21:10:40	7B9F5E	Po po kam te shitur direkt	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 21:11:33	7B9F5E	Duhet te shkoj nga afer ky njeriu im	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 21:12:14	7B9F5E	Kjo me nderimin qe bej une shkon 190 eu	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 21:12:40	7B9F5E	Ne dyqan kushton 225 eu	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 21:13:42	7B9F5E	Villa g 63 me opsione full duhet te jen	7B9F5E, A9C3A8
2020-04-17 21:14:16	7B9F5E	Nuk mendoj g amg 63 mos te ket opsione	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:03:36	7B9F5E	Shiko mos bie dakort te mare nje amg g 63 2020	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:03:48	7B9F5E	Te them neser te shkosh ta maresh	7B9F5E, A9C3A8

2020-12-12 22:04:28	A9C3A8	ku do ta marresh ore	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:04:31	A9C3A8	haha me cfare do e nderrosh	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:04:48	7B9F5E	Esht me targa zvicere	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:05:03	7B9F5E	Me mall me ca do e nderoj	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:06:07	A9C3A8	dhe sa km eshte	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:06:08	A9C3A8	ku eshte	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:07:23	7B9F5E	15 mij me duket	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:07:25	7B9F5E	Po pak ka	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:07:26	7B9F5E	Po pak ka	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:07:31	7B9F5E	Ngjyr e zez	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:07:53	A9C3A8	me cfare vlere vete	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:08:05	A9C3A8	ok	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:08:06	A9C3A8	ku eshte	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:08:22	7B9F5E	140 eu na shkojn kostot neve	7B9F5E, A9C3A8

2020-12-12 22:08:30	7B9F5E	Po esht ok	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:09:07	7B9F5E	210 franga esht bler para 7,,8 muajve	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:09:35	A9C3A8	ok ne rregull	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:09:37	A9C3A8	ku eshte	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:09:39	7B9F5E		7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:09:50	A9C3A8	ok ne rregull	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:09:57	A9C3A8	me ke do flas	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:10:08	A9C3A8	ok vella	7B9F5E, A9C3A8

2020-12-12
22:10:09

7B9F5E

IMG-1607811007781



7B9F5E,
A9C3A8

2020-12-12
22:10:28

79F5E



7B9F5E,
A9C3A8

2020-12-12
22:10:38

7B9F5E

Neser me jep kontatin

7B9F5E,
A9C3A8

2020-12-12

A9C3A8

ok vella

7B9F5E,
A9C3A8

22:10:54

2020-12-12

7B9F5E

Besoj kam ren dakord
neser ma konermon

7B9F5E,
A9C3A8

22:10:58

2020-12-12

A9C3A8

ok vella

7B9F5E,
A9C3A8

22:11:28

2020-12-12

A9C3A8

e tak vet

7B9F5E,
A9C3A8

22:11:41

2020-12-12

A9C3A8

me thuaj qe ta shoh ate

7B9F5E,
A9C3A8

22:11:48

2020-12-12

7B9F5E

Si duket ja vlen ??

7B9F5E,
A9C3A8

22:12:15			
2020-12-12	A9C3A8	po model zvicre duhet te jet e miren	7B9F5E, A9C3A8
22:12:24			
2020-12-12	A9C3A8	vell	7B9F5E, A9C3A8
22:12:30			
2020-12-12	7B9F5E	Esht fulllllll fulllll	7B9F5E, A9C3A8
22:12:39			
2020-12-12	A9C3A8	me keto te dhena qe me jep eshte mire	7B9F5E, A9C3A8
22:12:44			
2020-12-12	A9C3A8	por duhet pare	7B9F5E, A9C3A8
22:12:44			
2020-12-12	A9C3A8	eshte shum e mire	7B9F5E, A9C3A8
22:12:58			
2020-12-12	A9C3A8	duhet ta shikojm neser	7B9F5E, A9C3A8
22:14:51			
2020-12-12	A9C3A8	ke foto tjeter	7B9F5E, A9C3A8
22:14:54			
2020-12-12	A9C3A8	?	7B9F5E, A9C3A8
22:14:59			
2020-12-12	7B9F5E	E kam pare nga afer	7B9F5E, A9C3A8
22:15:27			
2020-12-12	A9C3A8	ok po e ke pare vet nga afer	7B9F5E, A9C3A8
22:15:43			
2020-12-12	A9C3A8	ka kohe ne tirane kjo	7B9F5E, A9C3A8
22:15:46			
2020-12-12	7B9F5E	Jo	7B9F5E, A9C3A8
22:17:05			
2020-12-12	7B9F5E	Tani ka ardhur	7B9F5E, A9C3A8

22:17:14

Në datën 12.12.2020, Alfredo Hamzai i shkruar Orest Sotës “Shiko mos bie dakort te marë nje amg g 63 2020; Te them neser te shkosh ta maresh”, dhe më vonë i thotë “G amg 63 do e maresh neser”

2020-12-12 22:40:13	7B9F5E	G amg 63 do e maresh neser	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:40:19	7B9F5E	Ca do me na nje gje tjeter	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:40:40	A9C3A8	hahaha	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:40:51	A9C3A8	cme q*** nenen	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:41:02	A9C3A8	un dua €	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:41:05	A9C3A8	hahahaha	7B9F5E, A9C3A8
2020-12-12 22:41:15	A9C3A8	per te lare ate gjerat	7B9F5E, A9C3A8

Lidhur me këtë mjet, janë kryer verifikime mbi pronësin e tij dhe ka rezultuar se në pronësi të “Fortis Beton CO”, me Nipt L71912018R, është një mjet Mercedes Benz, model G-Class, vit prodhimi 2020, ngjyrë e zezë, me shasië E1N4632761X361365.

Të dhënat e mjetit përputhen me ato që Alfredo Hamzai i shpjegon personit nën hetim Orest Sota. Lidhur me këtë mjet janë kryer verifikime lidhur me historikun e pronësisë dhe ka rezultuar se fillimisht mjeti ka qenë i regjistruar në pronësi të Top Seven, me Nipt L72428010U, në datën 09.12.2020. Mjeti G-Class ka kaluar në pronësi të shoqërisë Met Invest, me Nipt L81310039M në datën 23.11.2021 dhe në datën 24.11.2021 ka kaluar në pronësi të shoqërisë “Fortis Beton Co”. Aktualisht, mjeti ka targën AB063GG dhe nga verifikimet në sistemi E-Gjoba, ka rezultuar se kanë marrë gjoba gjatë përdorimit të mjetit shtetasit: Kevin Llupa (K50427059Q), Arbëresha Kaimi (H35629043F), Amer Lloshi (I30926061K), Redon Kulheku (J31216055O), Kejdi Kaimi (J90102044Ë), Erenik Shehu (J20102076G) dhe Julinana Qylafku (H65330076D), nga dhjetori i vitit 2021 deri në 06.02.2026.

Ky fakt na provon lidhjen e drejtëpërdrejtë mes personave nën hetim Alfredo Hamzai, Orest Sota dhe Orgest Birçaj, të cilët përpos aktivitetit kriminal të trafikut të lëndës narkotike, të ardhurat e gjeneruar nga ky aktivitet i kanë shitur në mënyrë fiktive me njëri-tjetrin.

shkallë të lartë rrezikshmërie shoqërore dhe intensitet të veçantë të dashjes kriminale, pasojave që kanë ardhë nga kjo veprimtari kriminale, kohëzgjatja në kryerjen e veprës penale janë të dhëna të mjaftueshme për të provuar se ekzistencën e rrezikut të ikjes. Përfshirja në vite në këtë veprimtari tregon mundësinë reale të vijimit të aktivitetit kriminal, duke marrë në konsideratë natyrën e organizuar dhe vazhduese të veprimtarisë kriminale të evidentuar gjatë hetimeve dhe rrezik real për kryerje përsëri të të njëjtave veprave penale.

Masat alternative, si “detyrimi për paraqitje”, “garancia pasurore” apo “arresti në shtëpi”, dhe nuk janë të proporcionale dhe të përshtatshme në vlerësimin të rëndësisë së faktit, rrethaneve konkrete të çështjes; dhe personalitetit të personit nën hetim dhe nuk garantojnë nevojat e sigurimit në drejtim të hetimit për sigurimin dhe vërtetësinë e provave.

15. Për sa i përket personit nën hetim Orest Sota vlerësohet përfshirja e tij në grupe kriminale që trafikojnë lëndë narkotike mënyra e kryerjes së veprës, përdorimi i strukturave organizative, koordinimi ndërmjet pjesëmarrësve dhe qëllimi i përfitimit material evidentojnë një shkallë të lartë rrezikshmërie shoqërore dhe intensitet të veçantë të dashjes kriminale. Përfshirja në pastrim të produkteve të veprës penale duke investuar në shoqëri tregtare mënyrës së kryerjes së tyre nëpërmjet skemave të sofistikuar, të planifikuara dhe mirëmenduara, pasojave që kanë ardhë nga kjo veprimtari kriminale, kohëzgjatja në kryerjen e veprës penale, përfshirja intensive e tij në veprimet e trafikimit të lëndësve narkotike në sasi të mëdha, pastrimit të parave e cila është e vazhdueshme dhe aktuale. Masat alternative, si “detyrimi për paraqitje”, “garancia pasurore” apo “arresti në shtëpi”, dhe nuk janë të proporcionale dhe të përshtatshme në vlerësimin të rëndësisë së faktit, rrethaneve konkrete të çështjes; dhe personalitetit të personit nën hetim dhe nuk garantojnë nevojat e sigurimit në drejtim të hetimit për sigurimin dhe vërtetësinë e provave.

16. Për sa i përket personit nën hetim Dritan Aga ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se ai është i përfshirë prej disa vitesh në veprimtari të trafikimit të lëndëve narkotike të Hojit « kokainë » në nivel transnacional, ai pjesë e grupeve kriminale që mundësojnë trafikimi nga vendet e Amerikës Latinë në drejtim të Evropës, veprimtari e cila gjeneron të ardhura. Këto ardhura nëpërmjet skemave të mirëmendura, të planifikuara, investohen nëpërmjet mekanizmave të ndryshme në tre format e pastrimit të parave, në bashkëpunim të vecantë në pasuri të paluajtshme, biznese dhe aktivitete.

Në vlerësim të veprave penale për të cilat ai dyshohet, rrezikshmërisë për shkak të dënimit, por rrezikshmërisë që rezulton nga rrethanat konkrete të çështjes, si përfshirja në një veprimtari kriminale transnacionale të trafikimit të narkotike duke udhëtuar dhe duke punuar në laboratore në Ekuador, tregon mbi rrezikshmëri të lartë shoqërore. Udhëtimi i tij nuk ka qenë i shkëputur, por ka ardhë si rezultat i njohjeve të hershme me pjesëtarët e grupit e provuar kjo edhe nga investimi që ai ka kryer në formën e dhurimit në emër të bashkëjetueses së tij të quajtur Erida tek « toka tek juvenilja », duke patur kështu një përfshirje intensive brenda grupit kriminal. Ekzistenca e rrezikut real të ikjes dhe mundësisë reale për ta mundësuar këtë si pjesë e një rrjeti kriminal vlerësohet që masat e sigurimit « Detyrim për t'u paraqitur » apo « arrest në shtëpi » nuk përmbushin nevojat e sigurimit dhe nuk janë proporcionale. Kjo në vlerësim edhe të rrezikshmërisë së autoritet rezultuar nga rrethanat konkrete të çështjes, mbi përfshirjen aktive të personit nën hetim në veprimtarinë kriminale të trafikimit të lëndëve narkotike, e ushtruar në mënyrë të organizuar dhe të vazhdueshme. Mënyra e kryerjes së veprës, përdorimi i strukturave organizative, koordinimi ndërmjet pjesëmarrësve dhe

pastrimit të parave; d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale; dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Kur kjo veprë kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.....Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur: a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet; b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar; c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet; ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë; d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë. Dijenia dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.”.

Neni 333/a i Kodit Penal parashikon se: “Krijimi, organizimi ose drejtimi i një grupi të strukturuar kriminal për kryerjen e veprave penale dënohen me burgim nga tre deri në tetë vjet. Pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet”.

Neni 334 i Kodit Penal parashikon se: “1. Kryerja e veprave penale nga pjesëtarë të organizatës kriminale dhe të grupit të strukturuar kriminal dënohet sipas dispozitave penale përkatëse, duke i shtuar dënimin për veprën penale të kryer edhe pesë vjet burgim, si dhe gjobën në masën një të tretën, por pa kaluar kufirin maksimal të dënimin me burgim.

2: Kur dispozita përkatëse referuese përmban dënim me burgim apo me burgim të përjetshëm, dënohet me njëzet e pesë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm...”.

IV. Vlerësimi i gjykatës

Në lidhje me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj personave nën hetim Ardian Zyka (alias Blerim Miftari), Alfredo Hamzai (alias Genc Bedini, alias Genci Tanasi), Adrian Rama, Orgest Birçaj, Orest Sota, Elton Memeti, Artur Shehu, Arben Ismailaj, Dritan Aga, Luçiano Koçeku (alias Artur Mersin Koçeku), Dino Koçeku (alias Abedin Koçeku), Ervin Koçeku, Astrit Vladi, Kastriot Vladi, Ilir Shtufi, Gëzim Islami, Leonard Bishaj, Edmond Jaupi, Besnik Myftari, Erjon Rama.

Një nga të drejtat themelore kushtetuese është liria e personit. Garantimi i kësaj të drejte është parakusht për ushtrimin e shumë të drejtave të tjera, siç janë psh: liria e tubimit dhe e shoqërizimit, jeta familjare, e drejta e lirisë së lëvizjes etj. Megjithë rëndësinë e padiskutueshme që ka, kjo e drejtë nuk është absolute, pasi si në aktet ndërkombëtare edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë parashikohen në mënyre taksative rastet se kur kjo liri kufizohet. Nga ana tjetër duke parashikuar rastet e kufizimeve në mënyrë shteruese kjo në vetvete përbën një garanci në nivel kushtetues në

lidhje me këtë të drejtë. Pasur parasysh edhe paragrafin e parë të nenit 5 të KEDNJ-së, që përmban prezumimin që çdokush duhet të gëzojë lirinë e tij, duhet të kemi parasysh se kjo e drejtë është një e drejtë e kufizueshme në rrethana që e justifikojnë atë, prandaj si rrjedhojë, një personi mund t'i privohet kjo liri në rrethana përjashtuese të cilat domosdoshmërisht duhet të jenë shteruese.

Masat e sigurimit²⁰³ janë veprime procedurale që heqin ose kufizojnë lirinë dhe të drejtat e personit ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal. Ato kanë si qëllim të parandalojnë veprimtarinë e mëtejshme kriminale të atij që ka kryer një veprë penale, të pengojnë shmangien e tij nga procedimi, përpjekjet që ai mund të bëjë për të vënë në rrezik marrjen e provës ose vërtetësinë e saj, si dhe të garantojë shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale. Masa e sigurimit nuk është dënim penal që të përdoret si masë ndëshkimore për personin që dyshohet se ka kryer një veprë penale dhe nga ana tjetër, nuk jepet për të lehtësuar punën e organit të prokurorisë në hetimin e një çështjeje penale²⁰⁴. Masat e sigurimit aplikohen për shkaqe dhe kritere të përcaktuara në mënyrë të qartë në nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale.

Caktimi i masave së sigurimit duhet të bëhet në rastet e parashikuara nga K.Pr.Penale. Konkretisht në paragrafin e parë dhe të dytë të nenit 228 janë parashikuar kushtet e përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit, e më konkretisht: Dyshimi i arsyeshëm²⁰⁵ i mbështetur në prova, ose elementi provues (*fumus commisi delicti*); Ekzistenca e veprës penale; Ekzistenca e kushteve të dënueshmërisë sipas së drejtës penale.

Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova është kushti më i rëndësishëm, pasi askush nuk mund t'i nënshtrohet masave të sigurimit personal nëqoftëse në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova. GjEDNJ-ja ka theksuar se dyshimi i arsyeshëm përbën standardin kryesor për heqjen e lirisë së personit¹. Gjithashtu, GjEDNJ-ja në vendimin "*Stogmuller kundër Austrisë*" ka theksuar se kriteri i "*dyshimit të arsyeshëm*" duhet të ekzistojë në gjithë kohëzgjatjen e hetimeve, pasi nëse ky kriter pushon së ekzistuari, vazhdimësia e ndalimit bëhet e paligjshme. Është e vërtetë se dyshimi i arsyeshëm duhet detyrimisht të bazohet në prova, por se ai nuk kërkon detyrimisht që të tregojë sigurinë e plotë mbi autorin e veprës penale, por mundësinë se personi është autor i veprës penale.

Përveç dyshimit të arsyeshëm gjykata duhet të konstatojë nëse ekzistojnë dhe dy kushtet e tjera të përgjithshme. Kushti i dytë është **ekzistenca e veprës penale** ku kërkohet që fakti të jetë parashikuar nga ligji si veprë penale, apo vepra penale të mos jetë shuar për shkak parashkrimi të ndjekjes penale, ose për shkak të shfuqizimit të dispozitave penale, apo të mos jetë amnistuar.

²⁰³ Masat e sigurimit personal drejtohen ndaj personit të dyshuar për kryerjen e një vepre penale, duke privuar nga disa të drejta ose duke e ngarkuar me detyrime të veçanta. Ato ndahen në masa shtrënguese dhe masa ndaluese. Masat shtrënguese janë parashikuar në nenin 232 të K.Pr.Penale dhe janë: a) ndalimi i daljes jashtë shtetit; b) ndalimi dhe detyrimi për qëndrim në një vend të caktuar; c) garancia pasurore; ç) arresti në shtëpi; d) arresti në burg; dh) shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik. Masat ndaluese parashikohen në nenin 240 të K.Pr.Penale dhe janë: a) pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik dhe ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste.

²⁰⁴ Vendimi nr.489, datë 12.12.2000 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²⁰⁵ Vendimi i GjEDNJ-së, Murray k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. kërkese 14310/88, datë vendimi 28 tetor 1994.

Kushti i tretë i përgjithshëm është **ekzistenca e shkaqeve të dënueshmërisë së personit ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit**. Nuk mund të caktohet masë sigurimi ndaj një personi që nuk mund të merret si i pandehur, ose nuk mund të dënohet si p.sh. personi që nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, apo personi që është i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore, kur jemi para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprës penale, apo kur veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit, Gjykata duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë më konkretisht:

- i. ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;
- ii. largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;
- iii. rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Për caktimin e masave të sigurimit, Gjykata përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Këto kriteret përcaktojnë llojin e masës së sigurimit që duhet të marrë gjykata për rastet konkrete që ka në shqyrtim. **Kriteri i parë**, është përshtatshmëria e masës së sigurimit me shkallën e nevojave të sigurimit që kërkohen në rastin konkret, pra sa më e madhe të jetë nevoja e sigurimit aq më e rëndë duhet të jetë masa e sigurimit që caktohet. **Kriteri i dytë**, është ruajtja e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së sigurimit, duke mbajtur parasysh dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga K.Penal. **Kriteri i tretë**, kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete.

Për rëndësinë që kanë, vetëm gjykata ose një organ që është veshur me pushtet gjyqësor mund t'i kufizojë liritë e personit, në bazë të parimit të vjetër *habeas corpus act*. Prandaj, gjyqtarët e shteteve anëtare në ushtrimin e funksioneve të tyre duhet të kenë parasysh që, **çdo privim i lirisë duhet të vendoset në rrethana të caktuara, të jetë i justifikuar në mënyrë objektive dhe të mos zgjasë më shumë se sa është e nevojshme.**

Masat e sigurimit për vetë qëllimin që kanë, parë në raport edhe me kufizimin e lirisë së personit, do të duhet që të justifikohen edhe në vijim, e jo vetëm në momentin që caktohen, me qëllim që ato të mos zgjasin më shumë sesa është e nevojshme, pasi ato absolutisht nuk duhet dhe as nënkuptojnë ndëshkim të personit ndaj të cilit vendosen, për shkak se çdo person prezumohet i pafajshëm derisa ndaj tij të ketë një vendim përfundimtar dënimi. Dhe ky prezumim duhet të perceptohet më së pari nga vetë i pandehuri.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në vendimin e saj në Dhomë të Madhe, nr. kërkesë 23755/07, datë vendimi 5 korrik 2016, **Buzadji k. Republikës së Moldavisë**, ka arsyetuar, ndër të tjera se: “ 84. Neni 5 i Konventës, së bashku me nenet 2, 3 dhe 4, është në frontin e parë të të drejtave

themelore që mbrojnë sigurinë fizike të individit (shih, për shembull, lidhjen e tij me nenet 2 dhe 3 në çështjet e zhdukjes si Kurt kundër Turqisë, 25 maj 1998, § 123, Raportet e Vendimeve dhe Aktgjyqimeve 1998-III), dhe si i tillë rëndësia e tij është parësore. Qëllimi i tij kryesor është të parandalojë privimet arbitrare ose të pajustificuara të lirisë (shih, për shembull, Lukanov kundër Bullgarisë, 20 mars 1997, § 41, Raportet 1997 II; Assanidze kundër Gjeorgjisë [GC], nr. 71503/01, § 171, GJEDNJ 2004 II; dhe Ilaşcu dhe të tjerë kundër Moldavisë dhe Ruisë [GC], nr. 48787/99, § 461, GJEDNJ 2004 VII). Tri linja arsyetimi në veçanti mund të identifikohen si të tilla që përbëjnë jurisprudencën e Gjykatës: natyra shteruese e përjashtimeve, të cilat duhet të interpretohen në mënyrë strikte (shih Ciulla kundër Italisë, 22 shkurt 1989, § 41, Seria A nr. 148) dhe të cilat nuk lejojnë gamën e gjerë të justifikimeve sipas dispozitave të tjera (nenet 8 deri në 11 të Konventës në veçanti); theksimi i përsëritur mbi ligjshmërinë e ndalimit, si procedural ashtu edhe material, që kërkon respektim të rreptë të sundimit të ligjit (shih Einterëerp kundër Holandës, 24 tetor 1979, § 39, Seria A nr. 33); dhe rëndësia e shpejtësisë ose shpejtësisë së kontrolleve të nevojshme gjyqësore (sipas Nenit 5 §§ 3 dhe 4) (shih McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], nr. 543/03, § 34, ECHR 2006 X).

85. Një nga llojet më të zakonshme të heqjes së lirisë në lidhje me procedurat penale është paraburgimi në pritje të gjyqit. Një paraburgim i tillë përbën një nga përjashtimet nga rregulli i përgjithshëm i përcaktuar në nenin 5 § 1 se, kushdo ka të drejtën e lirisë dhe parashikohet në nënparagrafin (c) të nenit 5 § 1 të Konventës. Periudha që duhet të merret në konsideratë fillon kur personi arrestohet (shih Tomasi kundër Francës, 27 gusht 1992, § 83, Seria A nr. 241 A) ose mbahet në paraburgim (shih Letellier kundër Francës, 26 qershor 1991, § 34, Seria A nr. 207), dhe përfundon kur ai ose ajo lirohet dhe/ose akuza përcaktohet, edhe nëse vetëm nga një gjykatë e shkallës së parë (shih, ndër të tjera, Eemhoff kundër Gjermanisë, 27 qershor 1968, f. 23, § 9, Seria A nr. 7; Labita kundër Italisë [GC], nr. 26772/95, § 147, GJEDNJ 2000 IV; Kalashnikov kundër Ruisë, nr. 47095/99, § 110, GJEDNJ 2002 VI; dhe Solmaz kundër Turqisë, nr. 27561/02, §§ 23-24, 16 janar 2007).

86. Ndërsa paragrafi 1 (c) i Nenit 5 përcakton arsyet mbi të cilat paraburgimi mund të jetë i lejueshëm në radhë të parë (shih De Jong, Baljet dhe Van den Brink kundër Holandës, 22 maj 1984, § 44, Seria A nr. 77), paragrafi 3, i cili formon një tërësi me dispozitën e mëparshme, përcakton disa garanci procedurale, duke përfshirë rregullin që paraburgimi në pritje të gjyqit nuk duhet të kalojë një kohë të arsyeshme, duke rregulluar kështu kohëzgjatjen e tij.

87. Sipas jurisprudencës së vendosur të Gjykatës sipas nenit 5 § 3, vazhdimësia e një dyshimi të arsyeshëm është një kusht sine qua non për vlefshmërinë e vazhdimet të paraburgimit, por, pas një kohe të caktuar, ai nuk mjafton më: Gjykata duhet të përcaktojë (1) nëse bazat e tjera të cituara nga autoritetet gjyqësore vazhdojnë të justifikojnë privimin nga liria dhe (2), kur baza të tilla ishin "relevante" dhe "të mjaftueshme", nëse autoritetet kombëtare treguan "kujdes të veçantë" në zhvillimin e procedurave (shih, ndër shumë autoritete të tjera, Letellier, i cituar më sipër, § 35, dhe Idalov kundër Ruisë [GC], nr. 5826/03, § 140, 22 maj 2012). Gjykata ka vendosur gjithashtu se justifikimi për çdo periudhë paraburgimi, pavarësisht se sa e shkurtër, duhet të demonstronhet autoritetet janë të detyruara të marrin në konsideratë mjete alternative për të siguruar paraqitjen e tij ose të saj në gjyq (ibid.).

88. Shkaqet që janë konsideruar arsye "relevante" dhe "të mjaftueshme" (përveç ekzistencës së dyshimit të arsyeshem) në jurisprudencën e Gjykatës, kanë përfshirë baza të tilla si rreziku i arratisjes, rreziku i presionit ndaj dëshmitarëve ose i manipulimit të provave, rreziku i bashkëpunimit, rreziku i përsëritjes së veprës penale, rreziku i shkaktimit të çrregullimit publik dhe nevoja për të mbrojtur të ndaluarin (shih, për shembull, Stögmüller kundër Austrisë, 10 nëntor 1969, § 15, Seria A nr. 9; Eemhoff, i cituar më sipër, § 14; Tomasi, i cituar më sipër, § 95; Toth kundër Austrisë, 12 dhjetor 1991, § 70, Seria A nr. 224; Letellier, i cituar më sipër, § 51; dhe I.A. kundër Francës, 23 shtator 1998, § 108, Raportet e Vendimeve dhe Aktgjykimeve 1998 VII).

89. Prezumimi është gjithmonë në favor të lirimimit. Siç është përcaktuar në Neumeister kundër Austrisë (vendimi i 27 qershorit 1968, Seria A nr. 8, f. 37, § 4), pjesa e dytë e Nenit 5 § 3 – që është lirimi në pritje të gjyqit – nuk u jep autoriteteve gjyqësore një zgjedhje midis sjelljes së një të akuzuari në gjyq brenda një kohe të arsyeshme ose dhënies së lirimimit të përkohshëm në pritje të gjyqit. Ndalimi i përkohshëm i të akuzuarit nuk duhet të zgjatet përtej një kohe të arsyeshme (shih Eemhoff, cituar më sipër, § 5); edhe nëse kohëzgjatja e hetimit paraprak nuk është e hapur ndaj kritikave, ajo e ndalimit nuk duhet të tejkalojë një kohë të arsyeshme (shih Stögmüller, cituar më sipër, § 5). Deri në dënimin, ai ose ajo duhet të prezumohet i pafajshëm, dhe qëllimi i dispozitës në shqyrtim është në thelb të kërkojë lirimimin e tij ose të saj të përkohshëm sapo ndalimi i tij ose i saj i vazhdueshëm të pushojë së qeni i arsyeshem (shih McKay, cituar më sipër, § 41).

90. Çështja nëse një periudhë kohore e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte. Nëse është e arsyeshme që një i akuzuar të qëndrojë në paraburgim duhet të vlerësohet mbi faktet e secilit rast dhe sipas karakteristikave të tij specifike. Vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ka tregues aktualë të një kërkesë të vërtetë të interesit publik i cili, pavarësisht prezumimit të pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale të përcaktuar në Nenin 5 të Konventës (shih, ndër autoritetet e tjera, Labita, cituar më sipër, § 152, dhe Kudła kundër Polonisë [GC], nr. 30210/96, §§ 110 et seq., ECHR 2000 XI). Duke pasur parasysh veçanërisht rrezikun e arratisjes, duhet t'i kushtohet vëmendje karakterit të personit të përfshirë, moralit të tij ose të saj, pasurive, lidhjeve me shtetin në të cilin ai ose ajo po ndiqet penalisht dhe kontakteve ndërkombëtare të personit (shih, Neumeister cituar më sipër, § 10).

91. Kryesisht, u takon autoriteteve gjyqësore kombëtare të sigurojnë që, në një rast të caktuar, paraburgimi i një personi të akuzuar të mos kalojë një kohë të arsyeshme. Prandaj, ato duhet, duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë, të shqyrtojnë të gjitha faktet që mbështesin ose kundërshtojnë ekzistencën e kërkesës së lartpërmendur të interesit publik ose që justifikojnë një shmangie nga rregulli në Nenin 5, dhe duhet t'i paraqesin ato në vendimet e tyre mbi kërkesat për lirim. Në thelb, në bazë të arsyeve të dhëna në këto vendime dhe të fakteve të dokumentuara mirë të deklaruara nga kërkuesi në apelet e tij, Gjykata thirret të vendosë nëse ka pasur apo jo shkelje të Nenit 5 § 3 (shih, ndër autoritetet e tjera, Kudła, cituar më sipër, § 110, dhe Idalov, cituar më sipër, § 141).

Në vendimin *Letellier k. Francës*, nr. kërkesë 12369/86, datë vendimi 26 qershor 1991, GJEDNJ, arsyeton se: "33. Kërkuessa pretendoi se kohëzgjatja e paraburgimit të saj kishte shkelur Nenin 5 § 3 (neni 5-3), i cili është formuluar si më poshtë:

"Çdo person i arrestuar ose i ndaluar në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 (c) të këtij Neni (neni

5-1-c), ... ka të drejtë të gjykohe brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjykimit. Lirimi mund të kushtëzohet nga garancitë për t'u paraqitur në gjyq".

Qeveria e kundërshtoi këtë pikëpamje. Komisioni konsideroi se pas 22 janarit 1986 (shih paragrafin 13 më sipër) arsyet për paraburgimin e znj. Letellier nuk kishin qenë më të arsyeshme.

A. Periudha që duhet të merret në konsideratë

34. Periudha që duhet të merret në konsideratë filloi më 8 korrik 1985, datën në të cilën kërkuesja u la në paraburgim, dhe përfundoi më 10 maj 1988, me vendimin e Gjykatës së Krimeve të Rënda, minus periudhën nga 24 dhjetori 1985 deri më 22 janar 1986, gjatë së cilës ajo u lirua nën mbikëqyrjen e gjykatës (shih paragrafin 12 më sipër). Prandaj, zgjati dy vjet e nëntë muaj.

B. Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së paraburgimit

35. Në radhë të parë, autoriteteve gjyqësore kombëtare u takon të sigurojnë që, në një rast të caktuar, paraburgimi i një personi të akuzuar të mos kalojë një kohë të arsyeshme. Për këtë qëllim, ato duhet të shqyrtojnë të gjitha faktet që argumentojnë pro ose kundër ekzistencës së një kërkesë të vërtetë të interesit publik që justifikon, duke marrë parasysh parimin e prezumimit të pafajësisë, një shmangie nga rregulli i respektimit të lirisë individuale dhe t'i përcaktojnë ato në vendimet e tyre mbi kërkesat për lirim. Në thelb, në bazë të arsyeve të dhëna në këto vendime dhe të fakteve të vërteta të përmendura nga kërkuesi në apelet e tij, Gjykata thirret të vendosë nëse ka pasur apo jo shkelje të Nenit 5 § 3 (neni 5-3) të Konventës (shih, ndër të tjera, vendimin Neumeister të 27 qershorit 1968, Seria A nr. 8, f. 37, §§ 4-5). Vazhdimësia e dyshimit të arsyeshëm se personi i arrestuar ka kryer një vepër penale është një kusht sine qua non për vlefshmërinë e vazhdimit të paraburgimit (shih vendimin Stögmüller të 10 nëntorit 1969, Seria A nr. 9, f. 40, § 4), por, pas një kohe të caktuar, nuk mjafton më; Gjykata duhet të përcaktojë nëse arsyet e tjera të cituara nga autoritetet gjyqësore vazhdojnë të justifikojnë privimin nga liria (po aty, dhe shih vendimin Eemhoff të 27 qershorit 1968, Seria A nr. 7, f. 24-25, § 12, dhe vendimin Ringeisen të 16 korrikut 1971, Seria A nr. 13, f. 42, § 104). Kur këto arsye janë "relevante" dhe "të mjaftueshme", Gjykata duhet gjithashtu të përcaktojë nëse autoritetet kombëtare kompetente kanë treguar "kujdes të veçantë" në zhvillimin e procedurave (shih vendimin Matznetter të 10 nëntorit 1969, Seria A nr. 10, f. 34, § 12, dhe vendimin B. kundër Austrisë të 28 marsit 1990, Seria A nr. 175, f. 16, § 42).

36. Për të justifikuar refuzimin e tyre për të liruuar znj. Letellier, departamentet e akuzave të Gjykatave të Apelit të Parisit dhe Amiens theksuan në veçanti se ishte e nevojshme të parandalohesh që kërkuesja të ushtronte presion mbi dëshmitarët, se ekzistonte rreziku i arratisjes së saj i cili duhej kundërshtuar, se mbikëqyrja gjyqësore nuk ishte e mjaftueshme për të arritur këto objektiva dhe se lirimi i saj do të cenonte rëndë rendin publik.

1. Rreziku i presionit që mund të ushtrohet mbi dëshmitarët

37. Qeveria theksoi se akuzat kundër znj. Letellier bazoheshin në thelb në deklaratat e z. Moysan dhe z. Bredon (shih paragrafin 9 më sipër). Ky i fundit, i cili u mor në pyetje nga gjyqtari hetues më 25 nëntor 1985, nuk mundi, për shkak të mosparaqitjes së tij, të përballej me të akuzuarin më 17 dhjetor 1985. Nevoja për të shmangur presionin që mund të çonte në ndryshime në deklaratat e dëshmitarëve në përballjet e parashikuara, ishte një nga arsyet e dhëna në vendimin e 22 janarit 1986 të departamentit të akuzave të Parisit (shih paragrafin 13 më sipër).

38. Sipas Komisionit, megjithëse një frikë e tillë ishte e imagjinueshme në fillim të hetimit, ajo nuk ishte më vendimtare pas marrjes në pyetje të shumta të dëshmitarëve. Për më tepër, asgjë nuk tregoi se kërkuesja ishte përfshirë në veprime kërcënuese gjatë liritit të saj nën mbikëqyrjen e gjykatës

(shih paragrafët 12-13 më sipër).

39. Gjykata pranon se fillimisht mund të ketë ekzistuar një rrezik i vërtetë i presionit ndaj dëshmitarëve, por mban qëndrimin se ai u zvogëluar dhe në fakt u zhduk me kalimin e kohës. Në fakt, pas 5 dhjetorit 1986, gjykatat nuk iu referuan më një rreziku të tillë: vetëm vendimet e departamentit të akuzave të Parisit të 22 janarit, 5 marsit, 10 prillit dhe 5 dhjetorit 1986 (shih paragrafët 13 dhe 23 më sipër) e konsideruan paraburgimin si mjetin e vetëm për ta kundërshtuar atë.

Në çdo rast, pas 23 dhjetorit 1986 (shih paragrafin 23 më sipër), vazhdimi i paraburgimit nuk ishte më i justifikuar sipas këtij shkaku.

2. Rreziku i arratisjes

40. Vendimet e ndryshme të divizionit të akuzave të Parisit (shih paragrafët 13, 16, 18 dhe 23 më sipër) bazoheshin në frikën e shmangies së gjyqit nga ana e kërkueses për shkak të "ashpërsisë së dënimit për të cilin ajo ishte përgjegjëse sipas ligjit" dhe në nevojën për të siguruar që ajo të mbetej në dispozicion të autoriteteve gjyqësore.

41. Komisioni vërejti se gjatë katër javëve për të cilat ajo ishte liruar - nga 24 dhjetori 1985 deri më 22 janar 1986 - kërkuesja kishte përmbushur detyrimet e mbikëqyrjes gjyqësore dhe nuk kishte kërkuar të arratisëj. Për më tepër, kjo do të kishte qenë e vështirë për të, si nënë e fëmijëve të mitur dhe menaxhere e një biznesi që përfaqësonte burimin e saj të vetëm të të ardhurave. Megjithatë rreziku i arratisjes nuk kishte qenë i dukshëm që nga fillimi, vendimet e dhëna kishin përmbajtur deklarata të pamjaftueshme arsyetimi për aq sa ato nuk kishin përmendur asnjë rrethanë të aftë për ta vërtetuar atë.

42. Qeveria konsideroi se me të vërtetë ekzistonte rreziku i arratisjes së të akuzuarit. Ata iu referuan ashpërsisë së dënimit që znj. Letellier rrezikonte dhe provave kundër saj. Ata gjithashtu paraqitën konsiderata shtesë të cilat megjithatë nuk u përmendën në vendimet gjyqësore në fjalë.

43. Gjykata thekson se një rrezik i tillë nuk mund të vlerësohet vetëm në bazë të ashpërsisë së dënimit të rrezikuar. Ai duhet të vlerësohet duke iu referuar një numri faktorësh të tjerë relevantë të cilët mund të konfirmojnë ekzistencën e një rreziku arratisjeje ose ta bëjnë atë të duket aq i vogël sa nuk mund të justifikojë paraburgimin në pritje të gjyqit (shih, mutatis mutandis, vendimin Neumeister të cituar më sipër, Seria A nr. 8, f. 39, § 10). Në këtë rast, vendimet e divizioneve të aktakuzave nuk japin arsye pse, pavarësisht argumenteve të paraqitura nga kërkuesja në mbështetje të kërkesave të saj për lirim, ata e konsideruan rrezikun e arratisjes së saj si vendimtar (shih paragrafët 14, 19 dhe 24 më sipër).

3. Pamjaftueshmëria e mbikëqyrjes gjyqësore

4. Sipas kërkueses, me anë të mbikëqyrjes gjyqësore mund të arriheshin objektivat e kërkuara. Për më tepër, ajo kishte qenë nën një mbikëqyrje të tillë pa asnjë problem për gati një muaj, nga 24 dhjetor 1985 deri më 22 janar 1986 (shih paragrafët 12-13 më sipër), dhe kishte deklaruar gatishmërinë e saj për të pranuar atë në çdo rast që kërkonte lirimin e saj (shih paragrafët 14, 19 më sipër).

45. Qeveria, nga ana tjetër, konsideroi se gjyqi nuk do të kishte qenë i sigurt për të gjitha dënimet dhe veprat penale të pretenduara.

46. Kur arsyeja e vetme për vazhdimësinë e paraburgimit është frika që i akuzuari mund të arratiset dhe për rrjedhojë, të shmangë paraqitjen në gjykim, ai duhet liruar nëse është në atë pozitë që ofron mjaftueshëm garanci që ai do të paraqitet në gjyq, për shembull duke depozituar një garanci.

Gjykata vëren, në pajtim me Komisionin, se divizionet e aktakuzave nuk kanë vërtetuar se ky nuk ishte

rasti në këtë çështje.

4. Ruajtja e rendit publik

47. Vendimet e divizionit të hetimeve të Parisit të 22 janarit, 5 marsit dhe 23 dhjetorit 1986 dhe të 10 prillit dhe 24 gushtit 1987 (shih paragrafët 13 dhe 23 më sipër), ashtu si ai i divizionit të hetimeve të Amiens të 17 marsit 1987 (shih paragrafin 21 më sipër), theksuan nevojën për të mbrojtur rendin publik nga reagimi i shkaktuar nga vrasja e Z. Merdy.

48. Kërkuesja argumentoi se reagimi i rendit publik nuk mund të rezultojë nga kryerja thjesht e një veprë penale.

49. Sipas Komisionit, rreziku i një shqetësimi të tillë, të cilin ai e kuptonte si shqetësim të opinionit publik, pas lirimit të një të dyshuari, nuk mund të vijë vetëm për shkak të rëndësisë së një krimi ose akuzat në pritje kundër personit në fjalë. **Për të përcaktuar nëse ekzistonte një rrezik i kësaj natyre, sipas tij ishte e nevojshme të merreshin parasysh faktorë të tjerë, siç janë qëndrimi dhe sjellja e mundshme e të akuzuarit pasi të lirohej; gjykatat franceze nuk e kishin bërë këtë në rastin aktual.**

50. Nga ana tjetër, për Qeverinë, prishja e rendit publik vjen për shkak të vetë veprës penale të kryer dhe rrethanat në të cilat është kryer. Duke përfaqësuar një sulm të pariparueshëm ndaj një qenie njerëzore, çdo vrasje prish shumë rendin publik të një shoqërie të interesuar për të garantuar të drejtat e njeriut, nga të cilat respekti për jetën njerëzore përfaqëson një vlerë thelbësore, siç tregohet nga Neni 2 (neni 2) i Konventës. Prishja që rezulton është edhe më e thellë dhe e qëndrueshme në rastin e vrasjes së paramenduar dhe të organizuar. Kishte tregues të rëndë dhe vërtetues që sugjeronin se znj. Letellier kishte organizuar skemën e vrasjes së burrit të saj dhe kishte udhëzuar palë të treta ta zbatonin atë në këmbim të pagesës.

51. **Gjykata pranon se, për shkak të rëndësisë së tyre të veçantë dhe reagimit publik ndaj tyre, vepra të caktuara penale mund të shkaktojnë një shqetësim shoqëror të aftë për të justifikuar paraburgimin, të paktën për një kohë.** Në rrethana të jashtëzakonshme, ky faktor mund të merret parasysh për qëllimet e Konventës, në çdo rast për aq sa ligji vendas njeh - si në Nenin 144 të Kodit të Procedurës Penale - nocionin e shqetësimit të rendit publik të shkaktuar nga një veprë penale. **Megjithatë, kjo bazë mund të konsiderohet si e rëndësishme dhe e mjaftueshme vetëm me kusht që të bazohet në fakte të afta për të treguar se lirimi i të pandehurit do të shqetësonte realisht rendin publik.** Përveç kësaj, **paraburgimi do të vazhdojë të jetë legjitim vetëm nëse rendi publik mbetet realisht i kërcënuar; vazhdimi i tij nuk mund të përdoret për të parashikuar një dënim me burgim.**

Në këtë rast, këto kushte nuk u plotësuan. **Divizionet e aktakuzave vlerësuan nevojën për të vazhduar privimin nga liria nga një këndvështrim thjesht abstrakt, duke marrë në konsideratë vetëm rëndësinë e veprës penale.** Kjo ndodhi pavarësisht faktit që kërkuesja kishte theksuar në memorandumet e saj të 16 janarit 1986 dhe të 3 marsit dhe 10 prillit 1987 se nëna dhe motra e viktimës nuk kishin paraqitur asnjë vërejtje kur ajo paraqiti kërkesat e saj për lirim, ndërsa ato i kishin kundërshtuar me forcë ato të paraqitura nga Z. Moysan (shih paragrafët 14 dhe 24 në fund më sipër); gjykatat franceze nuk e kundërshtuan këtë.

5. Përfundim

52. Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se, të paktën që nga 23 dhjetori 1986 (shih paragrafin 39 më sipër), paraburgimi i kontestuar pushoi së bazuari në baza relevante dhe të mjaftueshme. Vendimi i 24 dhjetorit 1985 për lirimin e të akuzuarit u mor nga oficeri gjyqësor në pozicionin më të mirë për të njohur provat dhe për të vlerësuar rrethanat dhe personalitetin e znj. Letellier; në përputhje me rrethanat, departamentet e akuzave duhet të kishin deklaruar në vendimet e tyre të

mëvonshme në një mënyrë më të qartë dhe specifike, për të mos thënë më pak stereotipike, pse e konsideruan të nevojshme të vazhdonin paraburgimin.

53. Si pasojë, ka pasur një shkelje të Nenit 5 § 3 (neni 5-3)”.

Në një tjetër vendim të saj in kundër vendit tonë, *Hysa kundër Shqipërisë* (nr. kërkesë 52048/16), datë vendimi 21.02.2023), GJEDNJ, duke parashtuar të gjithë praktikën e saj të konsoliduar që lidhet me paraburgimin, konkretisht lidhur me kohëzgjatjen e tij dhe nevojat për të, ka arsyetuar se:

“...61. Parimet e përgjithshme të zbatueshme në lidhje me justifikimin dhe kohëzgjatjen e paraburgimit përcaktohen në vendimin Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DHM], nr. 23755/07, §§ 87–91, 5 korrik 2016.

62. Gjykata përsërit veçanërisht se, teksa paragrafi 1 (c) i nenit 5 parashikon arsyet mbi të cilat paraburgimi mund të jetë i lejueshëm në radhë të parë (shih De Jong, Baljet dhe Van den Brink kundër Holandës, 22 maj 1984, § 44, seria A nr. 77); paragrafi 3, që krijon të tërën së bashku me përcaktimin e mëparshëm, parashikon garanci të caktuara procedurale, duke përfshirë rregullin se gjykimi pezull për burgimin nuk duhet të tejkalojë afatin e arsyeshëm, duke rregulluar në këtë mënyrë kohëzgjatjen e tij (shih Buzadji, cituar më sipër, §§ 86).

63. Sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës mbështetur në nenin 5 § 3, vijimi i një dyshimi të arsyeshëm është kusht sinë qua non për vlefshmërinë e paraburgimit, por pasi ka kaluar një kohë e caktuar – që do të thotë që prej vendimit të parë gjyqësor që urdhëron arrestin me burg (shih Buzadji, cituar më sipër, § 102) – ai nuk është më i mjaftueshëm. Atëherë, Gjykata duhet të vendosë: 1. nëse arsye të tjera cituar nga autoritetet gjyqësore vijnë të justifikojnë privimin e lirisë; dhe 2. në rastet kur këto arsye ishin “të duhurat” dhe “të mjaftueshme”, nëse autoritetet vendëse kanë shfaqur “kujdes të veçantë” në realizimin e procesit. Justifikimi për çfarëdo periudhe burgimi, pavarësisht se sa e shkurtër ka qenë kjo periudhë burgimi, duhet të demonstrohet në mënyrë bindëse nga autoritetet (shih, midis shumë autoritetesh të tjerë, Idalov kundër Rusisë [DHM], nr. 5826/03, § 140, 22 maj 2012; dhe Buzadji, cituar më sipër, § 87).

64. Justifikimet që janë vlerësuar arsye “të duhura” dhe “të mjaftueshme” – përveç ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm – në praktikën gjyqësore të Gjykatës kanë përfshirë arsye të tilla si rreziku për t’u arratisur, rreziku i presionit ndaj dëshmitarëve ose rreziku i ndërhyrjes në prova, rreziku për marrëveshje të fshehta, rreziku për të kryer përsëri vepra penale, rreziku për të prishur rendin publik dhe nevoja për të mbrojtur personin e burgosur (ibid., § 88, me referenca të tjera).

65. Deri në dhënien e dënimit, një i pandehur duhet të konsiderohet i pafajshëm dhe qëllimi i përcaktimit konkret, kryesisht, është të kërkojë lirinë e tij ose të saj paraprak menjëherë pasi burgimi i tij ose saj nuk është më i arsyeshëm (shih, McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 543/03, § 41, GJEDNJ 2006-X, dhe Buzadji, cituar më sipër, § 89).

66. Çështja nëse një periudhë e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte. Aspekti nëse është e arsyeshme që një i pandehur të qëndrojë në burg duhet të vlerësohet mbi faktet e secilës çështje dhe sipas tipareve të saj specifike. Vijimësia e burgimit mund të justifikohet në një çështje të caktuar vetëm nëse ka tregues specifik për një kërkesë të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht prezumimit të pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale parashikuar në nenin 5 të Konventës (shih për shembull, Labita kundër Italisë [DHM], nr. 26772/95, § 152, GJEDNJ 2000-IV, dhe Kudła kundër Polonisë [DHM], nr. 30210/96, §§ 110 et seq., GJEDNJ 2000 XI; shih edhe Buzadji, cituar më sipër, § 90).

67. Në radhë të parë u takon autoriteteve gjyqësore vendëse të garantojnë, se në çdo çështje, paraburgimi i një të pandehuri nuk tejkalon afatin e arsyeshëm. Sipas rastit, duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë, ata duhet të shqyrtojnë të gjitha faktet pro ose kundër ekzistencës së kërkesës përmendur më sipër të interesit publik ose që justifikojnë shmangien e nenit 5, dhe më pas duhet t'i përfshijnë ato në vendimet e tyre për kërkesat për lirim (shih Buzadji, cituar më sipër, § 91). Me konsideratë të veçantë ndaj rrezikut, se nëse lirohet, i dyshuari do të kryej përsëri një vepër penale, duhet t'i kushtohet vëmendje, inter alia, natyrës dhe rëndësisë së akuzave ndaj të pandehurit, të dhënat e tij ose të saj penale dhe karakteri ose sjellja e tij apo e saj, që do të tregojnë se ai ose ajo e paraqiste një rrezik të tillë (shih, për shembull, Merčep kundër Kroacisë, nr. 12301/12, § 96, 26 prill 2016; Šoš kundër Kroacisë, nr. 26211/13, § 95, 1 dhjetor 2015; dhe Magnitskiy dhe të Tjerët kundër Rusisë, nr. 32631/09 dhe 53799/12, § 221, 27 gusht 2019).

68. Në ushtrimin e funksionit të saj në këtë pikë, Gjykata duhet të garantojë se argumentet e gjykatave vendase në favor të dhe kundër liritimit nuk duhet të jenë "të përgjithshme dhe abstrakte" (shih, për shembull, Smirnova kundër Rusisë, nr. 46133/99 dhe 48183/99, § 63, GJEDNJ 2003-LX (ekstrakte)), por përmbajnë referenca për fakte specifike dhe rrethana personale duke justifikuar paraburgimin e një kërkuesi (shih, mutatis mutandis, Panchenko kundër Rusisë, nr. 45100/98, § 107, 8 shkurt 2005).

69. Në rastin kur rrethanat që mund të çonin në arrestimin me burg të një personi mund të ekzistojnë, por nuk përmendeshin në vendimin e gjykatave vendëse, nuk është detyrë e Gjykatës t'i përcaktojë ato dhe të marrë vendin e autoriteteve vendëse, të cilat kanë vendosur për paraburgimin e kërkuesit (shih Bykov kundër Rusisë [DHM], nr. 4378/02, §§ 66, 10 mars 2009, dhe Giorgi Nikolaishvili kundër Gjeorgjisë, nr. 37048/04, § 77, 13 janar 2009)....".

Përveç sa sipër, Gjykata mban në konsideratë edhe përfundimet e arritura në Vendimin Njësues (Unifikues) të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (ende i paarsyetuar dhe i pabotuar në Fletoren Zyrtare), por për aq sa është bërë e ditur në njoftimin publik të datës 04.05.2026 në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, ku është unifikuar praktika në drejtim të shqyrtimit të masave alternative përpara caktimit të masës së sigurimit masës "arrest në burg", si më poshtë: Në zbatim të neneve 228, 229, 230 dhe 245/1, shkronja "ç", të Kodit të Procedurës Penale, gjykata ka detyrimin të shqyrtojë realisht masat e tjera më pak kufizuese të lirisë personale dhe të arsyetojë shprehimisht përse ato nuk janë të mjaftueshme në rastin konkret. Ky arsyetim duhet të jetë i shprehur, i individualizuar dhe i mbështetur në fakte e rrethana të posaçme të çështjes, duke pasqyruar qartë rrezikun konkret, sipas nenit 228, pika 3, të Kodit të Procedurës Penale, si dhe domosdoshmërinë, përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e kufizimit të lirisë, në përputhje me standardet kushtetuese dhe konventore. Në lidhje me mënyrën e vlerësimit të rrezikshmërisë së veprës dhe të autorit në raport me masën "arrest në burg", Kolegjet e Bashkuara përcaktojnë këtë rregull të së drejtës: Në caktimin e masës arrest në burg, prokurori fillimisht dhe gjykatat në vijim, kanë detyrimin të japin një arsyetim të individualizuar, të mbështetur në fakte e rrethana të posaçme të çështjes, që lidh nevojën e kësaj mase me rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit në rastin konkret. Ky vlerësim duhet të mbështetet në rrethanat specifike të faktit, në mënyrën e kryerjes së veprës dhe në të dhënat që lidhen me personin ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit, përfshirë personalitetin, sjelljen, rrethanat individuale e familjare, si dhe çdo tregues tjetër të rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut real procedural ose shoqëror që ai paraqet në çështjen konkrete.

Kur verifikohet rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe e autorit, në kuptim të nenit 230, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, masa e sigurimit “arrest në burg” përliqjet si masa më e përshtatshme, që garanton nevojat e sigurimit. Rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe e autorit nuk nxirret vetëm ose kryesisht nga natyra e krimit ose nga marzhi i dënimit, por nga vlerësimi i ndërthurur i rrezikshmërisë së veçantë të faktit penal, i mënyrës së kryerjes, pasojave të ardhura, i personalitetit të të pandehurit, i sjelljes së tij, si dhe i rrethanave të tjera të rëndësishme dhe të lidhura ndërmjet tyre për rastin konkret.”. Në lidhje me barrën e justifikimit të nevojës për caktimin masës “arrest në burg”, Kolegjet e Bashkuara përcaktojnë këtë rregull të së drejtës: “Në interpretim të neneve 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me nenin 5 § 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, barra e justifikimit të nevojës për caktimin dhe vijimin e masës së sigurimit “arrest në burg” i takon prokurorisë, ndërsa gjykata ka detyrimin ta verifikojë dhe ta arsyetojë atë në çdo fazë të procedimit. Prokuroria ka detyrimin të paraqesë dhe të argumentojë në mënyrë konkrete faktet dhe rrethanat që mbështesin nevojën e kësaj mase, përfshirë rrezikun konkret dhe papërshtatshmërinë e masave më pak kufizuese. Në vendimmarrjen e saj gjykata nuk mund të kushtëzohet nga paraqitja ose jo e “provave pozitive” nga i pandehuri. I pandehuri mban vetëm barrën e paraqitjes së rrethanave faktike personale, familjare, shëndetësore ose rrethanave të tjera, kur i ngre ato si argumente në favor të masave më pak kufizuese.”.

Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi ndaj personit. Në rastin konkret Gjykata thekson se, duke vlerësuar në tërësi pretendimet e parashtruara nga ana e organit të akuzës, duke i parë në raport me provat e administruara, tashmë pjesë e dosjes gjyqësore, nga ku përftohen të dhëna të rëndësishme dhe të qenësishme që provojnë fakte kriminale, Gjykata e mon se krijohet dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se personat nën hetim, së bashku me shtetas të tjerë të paidentifikuar (ose të individualizuar por e nevojshme ti nënshtrohen verifikimeve të mëtejshme), nën formacione të posaçme kriminale, në kuadër të grupeve të strukturuar kriminale, kanë kryer vepra penale të rënda, të “Trafikimit të lëndëve narkotike”, kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a e 28/4 të K.Penal (për shtetasit/personat nën që janë të dyshuar për këtë vepër penale) dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”, kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 287 e 28/4 të K.Penal (për shtetasit/personat nën që janë të dyshuar për këtë vepër penale) dhe vepra e “Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”, e kryer në bashkëpunim të thjeshtë (pra, jo në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, për personat nën hetim Gëzim Myftari dhe Edmond Jaupi).

Gjykata konstaton se ka një tërësi dhe llojshmëri provash të ndryshme, përfshirë komunikime në platformën e enkriptuar SkyEcc, përgjime telefonike të kryera në vendin tonë, prova të marra nëpërmjet letërporosisë nga autoritetet e huaja, përfshirë ato spanjolle, belge, britanike, italiane etj., prova shkresore, vëzhgime etj., të cilat konfirmojnë deri më tani, ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm për secilin nga personat nën hetim, për veprat penale respektive që i ngarkohen secilit prej tyre.

Nga analizimi i të dhënave të përftuara (nga autoritetet gjyqësore të Drejtësisë së Mbretërisë së Spanjës të procedimit penal që ata kanë pasur në ndjekje; në komunikimet e kryera prej tyre në platformën e enkriptuar SkyEcc, nga përgjimet e komunikimeve elektronike, si edhe në analizim të akteve noteriale të lidhura mes tyre dhe personave të tretë të autorizuar prej tyre) përftohen të dhëna të rëndësishme lidhur me personat nën hetim, të cilët konsistojnë:

- në takime të zhvilluara në Majorka, Belgjikë e Aruba, takime të cilat konsistuar në vitet 2018-2021 kryesisht në kuadër të veprimtarisë kriminale të trafikimit të narkotikëve, por edhe për investime në Shqipëri;
- në përfshirje me veprime konkrete në kuadër të trafikimit të lëndëve narkotike me një shtrirje ndërkombëtare dhe në tonelata të konsiderueshme, si edhe qarkullimin e shumave monetare në vlera disa miliona euro të gjeneruara këto prej ketij aktiviteti të paligjshëm;
- në kryerjen e veprimeve noteriale mbi blerje të pasurive të paluajtshme, investimin në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të fshehur pas subjekteve ndërtuese të njohura në aktivitetin e ndërtimit dhe të cilat përfitojnë lehtësisht leje zhvillimi dhe ndërtimi si investitor strategjik, në shitjen dhe rishitjen tek persona fizik/juridik të krijuar prej tyre (apo lidhjeve familjare e shoqërore të tyre) deri në "humbjen" e lidhjeve të origjinës së pasurisë nga pronari i parë për tek pronari real (që janë subjektet nën hetim, të fshehur edhe nën investitorët).

Po ashtu, lidhur me investimet e kryera në bregdetin e jugut të Shqipërisë, krahas komunikimeve të përftuara nga hetimet e autoriteteve belge, janë përftuar të dhëna me interes në kuadër të këtyre investimeve të kryera në ndërtim nga ky grup kriminal, përgjatë bisedave të kryera prej tyre në platformën SkyEcc përgjatë periudhës 2019-Mars 2021.

Grupi kriminal është i përbërë nga personat nën hetim Alfredo Hamzai *alias* Genc Bedini (i dënuar në Belgjikë për këtë veprimtari kriminale), Ardian Zykaj, Orgest Birçaj, Orest Sota, Adrian Rama, Elton Mehmeti, Dritan Aga, Luçiano (alias Artur Koçeku), Kastriot Vladi, Astrit Vladi, të cilët bashkëveprojnë me njëri-tjetrin në veprimtarinë kriminale të trafikimit të narkotikëve, ku përfshihen si në ngarkesa të përbashkëta, por nga ana tjetër kanë rrjetin e tyre të trafikimit të narkotikëve me karakteristikat e tyre përkatëse.

Veprimtaria kriminale e trafikimit të lëndëve narkotike ka konsistuar në:

1. Trafikimi ndërkombëtar i lëndëve narkotike i kryer nga Amerika Latine (Kolumbia, Ekuador, Bolivia, Surinam, Paraguai, Uruguai, Porto-Riko e Brazil) në drejtim të Evropës, kryesisht në portet Antverp (Belgjikë) dhe Roterdam (Holandë) përmes kompanive të transportit detar në formën e qymyrit të drurit, pastave të frutave ose në pako të fshehura në kontenierë, të cilat në shumicën e rasteve janë kompani të krijuara dhe drejtuara prej tyre posaçërisht për këtë aktivitet, në bashkëpunim të mundshëm brenda shërbimeve doganore në porte të Evropës.

2. Trafikimi i lëndëve narkotike nga shtetet e Amerikës Latine drejt Evropës realizohet përmes kompanive tregtare të frutave, mishit, qymyrit dhe sojës. **Përpunimi dhe ekstraktimi kimik** kryhet në magazina apo ambiente të marra me qira në disa shtete europiane, kryesisht në Hollandë dhe Belgjikë. Këto lëndë shpërndahen më pas në disa shtete të BE-së, me një çmim që varion nga 26,000 deri në 30,000 euro për kilogram. Shitja kryhet në territore ku dukshëm furnizimi mbulohet vetëm nga prurjet e tyre, si Belgjika, Hollanda, Britania e Madhe, Irlanda, Italia dhe Spanja.

Ky aktivitet është i shtrirë në disa vende, ku përveç aleancave dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me grupe të ndryshme kriminale që operojnë në shtete të ndryshme (si hollandeze, belge, turke, izraelite, italiane, polake, braziliane, britanike, si dhe kartele të drogës nga Kolumbia, Paraguaji dhe Ekuadori), grupet kriminale shqiptare bashkëpunojnë mes tyre në këtë veprimtari, ose ndihmojnë njëri-tjetrin në procese të ndryshme, sipas njohjeve dhe lidhjeve që kanë në vendet ku transportohet lëndë narkotike.

Personat nën hetim Alfredo Hamzai, Luçiano Koçeku, të cilët janë drejtues të grupeve kriminale që trafikojnë lëndë narkotike, mundësojnë zinxhirë të ndryshëm të veprimtarisë kriminale duke patur kontroll të plotë si të burimit prej nga vjen lëndë narkotike, të pikave se ku do të kalojë tranzit dhe më pas në transportimin drejt magazinave (vende të marra më qera nga persona vendas / të huaja që janë të pastër për autoritetet sipas vendeve), tek përpunimi kimik (me gjetje të materialeve përpunuese dhe ekspertet kimist), me paketimin dhe logot identifikuese të tyre në tregun e narkotikëve; në ruajtjen e mjeteve dhe ambienteve ku gjendet lëndë narkotike duke u mundësuar vendosje të pajisjeve të llojit GPS në to, kamera si dhe pajisje të cilat bllokojnë valët nëse në to (lëndën narkotike) ka pajisje gjurmuese të tjera veç atyre të vendosur nga ata; me transportin më pas nëpër Evropë si Belgjikë, Hollandë, Itali, Mbretëri e Bashkuar (përmes makinave në të cilat janë krijuar me vende të fshehta dhe në disa raste edhe përmes linjave ajrore me anë të avionëve të vegjël në përmasa të përdorur nga ta).

Personat nën hetim Alfredo Hamzai, Luçiano Koçeku kanë bashkëveprim të vazhdueshëm, të cilët investojnë dhe shpenzojnë në lidhje me një laborator të ndodhur në Kolumbi e Ekuador, me përgjegjës shtetas shqiptar²⁰⁶, i cili siguron furnizim, përpunim, rrugë transporti për shumë grupe kriminale shqiptare; përfshihen në trafikim të lëndëve narkotike nga këto shtete, e dokumentuar kjo me kapjen e sasisë prej 441 kg në Barcelonë Spanjë; përfshihen në përpunimin e lëndës narkotike në Belgjikë, me qëllim trafikimin më pas në vende të tjera; si dhe përfshihen në transportim të lëndëve narkotike nga këto shtete në drejtim të Evropës, duke ndarë fitimet dhe shpenzimet; ata ndihmojnë njëri-tjetrin në dërgimin e forcës punëtorë në laboratorin në Ekuador, siç është rasti i personit nën hetim Dritan Aga, Arsen Gerbi dhe Muhamet Mersini; udhëtimi i cili organizohet nëpërmjet prerjes së biletave pranë agjensisë nëpërmjet personit nën hetim Orgest Birçaj, nëpërmjet shoqërisë "Top Seven" sh.p.k., me aktivitet ndër të tjera agjensi udhëtimi.

Personat nën hetim Alfredo Hamzai dhe Luçiano Koçeku për shkak të lidhjeve direkte me laboratorin e ndodhur në Ekuador e Kolumbi, konsiderohen si furnizues të lëndës narkotike, sipas kërkesave që kanë personat nën hetim Orest Sota, Orgest Birçaj, Adrian Rama e Elton Memeti; personi nën hetim Alfredo Hamzai, siguron informacione në lidhje me ngarkesat që kontrollohen dhe problematikat që ata kanë në trafikimin që vetë personat nën hetim kryejnë në kuadër të trafikimit të lëndës narkotike; ndërsa personi nën hetim Orest Sota për shkak të lidhjeve që ai ka në Shqipëri ofron informacione nëse në Shqipëri ka të dhëna për personat nën hetim.

Nga ana tjetër sigurohet treg për shitje masive si dhe transport në vende të ndryshme të Evropës si në Itali nëpërmjet personave nën hetim Orgest Birçaj dhe Orest Sota, të cilët kanë rrjetin e tyre të trafikimit, në Angli nëpërmjet personit nën hetim Luçiano Koçeku dhe në Zvicër nga personat nën hetim Elton Memeti dhe Adrian Rama; ata sigurojnë lëndë narkotike dhe transport për njëri-tjetrin

²⁰⁶ Përdorues i Pin D5A495 i paidentifikuar.

sipas kërkesave të shpejta që ata, duke bashkëvepruar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme në drejtim të veprimitarisë kriminale të trafikimit të lëndë narkotike.

Personi nën hetim Luçiano Koçeku nga ana tjetër ka rrjetin e tij të trafikimit të lëndëve narkotikeve të drejtuar, pjesë e të cilit janë vëllëzerët e tij Luçiano Koçeku të cilët veprojnë nën drejtimin e këtij të fundit kryesisht në Angli dhe Belgjikë si dhe personat nën hetim Astrit Vladi e Kastriot Vladi, si dhe persona të tjerë të pidentifikuar për të cilët po vijojnë hetimet.

Personat e përfshirë në këtë veprimtari kriminale e njohin njëri-tjetrin; ndihmojnë njëri-tjetrin në veprimtarinë e trafikimit të lëndëve narkotike, si dhe ato organizohen në pastrimin e parave, si dhe ndihmojnë njëri-tjetrin me veprime aktive konkrete në këtë veprimtari të pastrimit të parave, duke gjeneruar dhe pastruar miliona euro nga kjo veprimtari kriminale.

Edhe pse personat nën hetim janë të kujdesshëm në komunikimet që ata kryejnë për shkak të dijenisë së tyre mbi hapjen e komunikimeve të Encrochat, si dhe mundësisë për të ndërhyrë edhe në komunikimet SkyEcc, nga analizimi i komunikimeve të tyre, por edhe shënimeve të mbajtura, rezultojnë e provuar:

-Personat nën hetim Alfredo Hamzai, Orgest Birçaj dhe Luçiano Koçeku në bashkëpunim të veçantë me njëri-tjetrin, me persona të tjerë një pjesë e të cilëve të arrestuar apo të pidentifikuar kanë trafikuar lëndën narkotike “Kokainë” prej 441 kg në Spanjë, Barcelonë ku janë arrestuar shtetasit Indrit Kulaj, Dashamir Shera, Enton Ahmataj e Gian Luca Ciprian.

-Ata në bashkëpunim me njëri-tjetrin e me persona të tjerë një pjesë e të cilëve të arrestuar apo të pidentifikuar kanë përpunuar në mënyrë masive lëndë narkotike, në magazinat e ndodhura në Belgjikë dhe Holandë, ku gjatë kontrolleve të kryera në këto magazina janë konstatuar, ndër tjera, përbërës kimik, lëndë narkotike, pajisje e shënime për shpenzime të kryera nga personat nën hetim.

-Në kuadër të kësaj veprimtarie kriminale janë përfutur të dhëna në lidhje me rënie të sasive të konsiderueshme, gjatë trafikimit me të njëjtën mënyrë të vepruarit të grupit kriminal të personit nën hetim Luçiano Koçeku të dërguara nga Paraguaji nëpërmjet shoqërisë “Maxi Grans” në pronësi të shtetasit Luis Sebrano, i arrestuar për trafikim të lëndëve narkotike.

-Në datat 17 dhjetor 2020 janë sekuestruar 600 kg; në datën 25 dhjetor janë sekuestruar 1.2 ton; në datën 24 dhjetor janë sekuestruar 1 ton lëndë narkotike kokainë dhe në datën 24.04.2020 një ton (sasi për të cilat Luçiano Koçeku është shprehur se i janë sekuestruar nga autoritetet ligjzbatuese).

-Më datë 29.05.2020, në Angli u sekuestrua një sasi prej 162 kg kokainë e trafikuar nga grupi kriminal. Besohet se gjatë periudhës 2 maj – 29 maj 2020 është trafikuar një sasi totale prej 882.5 kg, e cila i atribuohet grupit kriminal të personit nën hetim Luçiano Koçeku.

-Në datën 28.10.2020 është sekuestruar sasia prej 1.435 kg lëndë narkotike kokaine në Portin e Roterdamit, që i përket personit nën hetim Alfredo Hamzai.

-Në datat 21.06.2020 është sekuestruar në Itali lëndë narkotike “cannabis sativa” dhe në datën 01.07.2020 është sekuestruar një sasi lëndë narkotike prej 22.026 kg kokainë që i përket personit nën hetim Orgest Birçaj.

Gjithashtu, janë përfutur të dhëna në lidhje me rënie të sasive të tjera të mëdha, për një pjesë janë dërguar letërporositë dhe për të tjerat po përgatiten letërporositë përkatëse.

Nga tërësia e bisedave të kryera mes tyre në platformën SKY ECC ndërmjet personat nën hetim Luçiano Koçeku (përdorues i PIN K4LXOK dhe 60CEA0, i njohur në komunikimet mes tyre e pseudonimin "loku"), konstatohet se ai ka komunikime të vijueshme në kohë me personin nën hetim, Alfredo Hamzai përdorues i PIN 789F5E (me pseudonimin identifikues Vlvl..17..n1bc 716351 dhe ndër te tjera Vlora edhe gnc) të cilat provojnë lidhjen e ngushtë mes tyre dhe pjesëtarëve të tjerë të grupeve të cilët ata drejtojnë, në krijimin e laboratorëve në Ekuador/Kolumbi/Paraguaj të mbledhjes dhe përpunimit të parë të lëndës narkotike dhe fshehjes së saj në mallrat-produktet që do të importohen nga Amerika Latine, për në Evropë, në nxjerrjen e saj nga Portet e Antëerp dhe Rotterdam gjatë mbërritjes me konteniere të kamufluar në produkte të ndryshme (qymyr, soje, sheqer dru etj), në magazinimin dhe përpunimin e saj në Evropë, nëpërmjet kimistëve, në paketimin dhe transportimin e saj në shtetet e ndryshëm Evropiane nëpërmjet zinxhirit të tyre ku gjenden edhe shperndaresit fundor (të kontrolluar po prej tyre) apo bashkëpunimit të vazhdueshëm me personat e tjerë nën hetim si, Orgest Birçaj, Orest Sota e Adrian Rama e Elton Memeti, të cilët bashkëveprojnë në këtë aktivitet kriminal.

Nga këto komunikime, provohet lidhja e tyre në trafikimin transnacional të lëndës narkotike, si edhe roli i tyre si personat në rolin e organizatorëve/ kontrolluesve/menaxhuesve të trafikimit ndërkombëtar të lëndëve narkotike në sasira të konsiderueshme kryesisht nga Amerika Latine, posedues realë të këtyre sasive të lëndëve narkotike të mbërritura dhe investitor në pjesë të caktuara të saj duke pasur lidhje mes tyre, marrëveshje në këtë aktivitet për në pjesët investuese në të/koherence në delegim të detyrave konkrete (si komunikimi i firmave importuese-eksportuese me autoriteve shtetërore, nxjerrjen e saj nga Portet, kryerjen e pagesave në formë transferte ose të dhëna nga të tjerë persona lidhje e tyre në mënyrë për të shmangur përqindjet që humbasin në rast të transfertave ndërkombëtare të këtyre shumave të konsiderueshme monetare, në mbajtjen e shënimeve në kohë për çdo blerje investim- huamarrje a huadhenie mes tyre- "bukeve" të shitura dhe atyre të mbetura etj.), në kontrollin e personave që ju janë deleguar detyrat përkatëse, në mbajtjen e kontakteve të drejtpërdrejta me personat shtetas të huaj (të paidentifikuar, por të referuar prej tyre me nofkat "plaku", "hollandezi" etj.) investues me madhor në këtë aktivitet të paligjshëm, në përfshirjen e tyre të drejtpërdrejtë tyre në çdo rast sekuestrimi të lëndëve narkotike nga autoritetet policore të shteteve ku janë kryer sekuestrimet dhe arrestimet përkatëse (të kërkuara nga ana e prokurorisë me anë të letërporosive).²⁰⁷

Sa më sipër, provohet dukshëm përfshirja e personit nën hetim **Luçiano Koçeku** si pjesë e grupit kriminal të hetuar nga autoritete Belge dhe se në këtë aktivitet është në rolin e katalizatorit të një procesi të shtrirë në shumë vende, edhe në shumë procese, dhe me një tërësi kontaktesh (shtetas të huaj dhe shqiptarë të hetuar nga autoritete Belge) të cilat i orienton në tërësinë e veprimeve të tyre dhe uke mbajtur në kontakt personin nën hetim Alfredo Hamzai (ortak në këtë aktivitetet të narkotikëve), si edhe ky i fundit Luçiano Koçeku. Nga komunikimet e përbashkëta që Alfredo Hamzai dhe Luçiano Koçeku kanë me njëri-tjetrin në drejtim të financimit të laboratorëve dhe trafikimin e lëndëve narkotike apo përbërësve që shërbejnë për përpunimin e saj, ata kanë biseda të drejtpërdrejta dhe me personin përdorues të Pinit D5A455 i cili është përgjegjës i laboratorëve në

²⁰⁷ Për të gjetur rolin e shtetasve Luçiano Koçeku dhe Alfredo Hamzai në trafikimin e lëndës narkotike dhe lidhjen e tyre në këtë aktivitet të përbashkët, referojuni kqyrjeve të komunikimeve të kryera mes tyre dhe personave të lidhur me to, të kryera në platformën SkyEcc.

Ekuador dhe Kolumbi dhe përgatit dhe nis ngarkesat për grupet kriminale të ndryshme, përfshi grupeve kriminale të drejtuar nga personat nën hetim Alfredo Hamzai dhe Luçiano Koçeku.

Gjatë kryerjes së aktivitetit kriminal të trafikimit të lëndëve narkotike është sekuestruar lënda narkotike prej 441 kg nga Amerika Latine në Spanjë e destinuar më pas për në Evropë. Rezulton e provuar se në kuadër të aktivitetit kriminal të trafikimit të lëndëve narkotike personi nën hetim Alfredo Hamzai ka organizuar trafikimin e lëndësve narkotike nga Amerika Latine në Evropë, për të cilën ka indicie se takimet e vëzhguara nga pjesëtarë të tjerë të grupit kriminal, kishin lidhje pikërisht me organizimin e këtij trafikimi, ku pjesë të lëndëve narkotike që po trafikohesh kanë patur edhe personat nën hetim Orgest Birçaj dhe Luçiano Koçeku, e provuar kjo nga komunikimet e kryera prej tyre dhe prej akteve hetimore që lidhen me sekuestrimin e lëndës narkotike.

Për sa i përket personit nën hetim Alfredo Hamzai alias Genci Bedini nga këqyrja e komunikimeve të kryera në platformën SKYECC mësohet se krahas “investimeve” të kryera më vete (ju referohen blerjeve në Amerikën Latine të sasive të konsiderueshme lënde narkotike e dyshuar e llojit “kokainë”) ka të tilla edhe në bashkëpunim me personin nën hetim Luçiano Koçeku, dhe Orgest Birçaj, si më poshtë vijon:

Në komunikimet që kryhen me personi nën hetim Luçiano Koçeku ata kanë biseda që lidhen me “investime” (blerje) të lëndës narkotike në:

- vi. **Peru** (referoju komunikimeve të datës 19.01.2020, ora 22:09 ndërmjet Alfred Hamzai përdorues i PIN 7B9F5E dhe Luçiano (Koçeku) përdorues i PIN 60CEA0), e cila do të vij në Evropë (porti Antëerp) për të cilën personi nën hetim Alfredo Hamzai ka gjetur kontaktet (ju referohet italianët) kryen takimet me ta, e njofton Luçiano Koçekun mbi çmimin dhe më tej e drejton (Luçiano Koçeku) të ndjek udhëtimin e ngarkesës që duhet të vijë;
- vii. **Kolumbi**²⁰⁸ ku Alfredo Hamzai i komunikon “se do të shkoj edhe lali të rrijë atje”;
- viii. **Argjentinë**²⁰⁹ ku i komunikon se “eshte kushua i baloteës qe ka nje firmë në Argjentinë, e merr punen jashtë firmës ...”;
- ix. në importimin nga Amerika Latine të lëndës së parë “qymyr” dhe se në të gjendet e fshehur lënda narkotike, e cila më pas i nënshtrohet përpunimit për nxjerrjen e saj dhe përpunimin deri në formë përfundimtare, ku ndër bisedat Alfredo Hamzai (7B9F5E) me Luçiano Koçeku, Alfredo Hamzai (7B9F5E) më datë 31.01.2020, ora 18:21, i komunikon personit nën hetim Luçiano Koçeku (60CEA0) se “Po thot njeriu i qymyrit, te kontrat polaku min 6 mujore 50 kuti per 6 muaj, te zbllokoj pagesen ne bank ne date 04-02 ta nisin kutin bosh e kan ber gati cdo gje. Thuaj ta nxitoj, gjynaf i kemi njerz te mire jan gati per pune” dhe se më datë 04.02.2020 ora 10:01 i nis një fotografi të qymyrit dhe i komunikon se “**Keshtu po behet malli esht past i kan ber vetem ngjyren si qymyr**” dhe se përfshirja në importimin e lëndës narkotike nëpërmjet qymyrit nga Amerika Latine është një formë e cila është përdorur

²⁰⁸ (referoju komunikimeve të datës 04.02.2020 ora 16:39 ndërmjet Alfred Hamzai përdorues i PIN 7B9F5E dhe Luçiano (Koçeku) përdorues i PIN 60CEA0).

²⁰⁹ (referoju komunikimeve të datës 10.02.2020 ora 22:41 ndërmjet Alfred Hamzai përdorues i PIN 7B9F5E dhe Luçiano (Koçeku) përdorues i PIN 60CEA0).

përgjatë vitit 2020 si edhe evidentohet në bisedën e datë 17.12.2020 ora 18:46 ku personi nën hetim Luçiano Koçeku i komunikon Alfredo Hamzai se *“T pergatisim dhe nje pun me kte hollandezin e amsterdamit meqe e lidha. Te pergatise 1.5 ton”* dhe se Alfredo Hamzai i përgjigjet *“po po do iki vet andej”*.

x. Nga komunikimet e tyre mësohet në përfshirjen e tyre në aktivitetin e trafikimit të lëndës narkotike **nga Ekuador për në Europë**, dhe referuar bisedës si më konkretisht:

- në shtetin e Ekuadorit ku personi nën hetim Alfredo Hamzai paraqitet në bashëkomunikime me personin nën hetim Luçiano Koçeku duke treguar se aktiviteti i tyre shtrihet edhe në këtë shtet dhe se bashkëpunojnë në gjentjen e kontakteve nga Alfredo Hamzai dhe në ndjekjen e ecuresë së intinerarit dhe deri në mbërritje në Evropë nga personi nën hetim Luçiano Koçeku.

- **në shtetin e Brazilit** ku personi nën hetim Alfredo Hamzai nëpërmjet kontakteve të tij i komunikon më datë 07.02.2020, ora 17:09, se *“për javën tjetër po pregatiten. Zukero. 100 ne, 100 ata, 100 braziliani, 300 ne total. Bllok eshte malli. Kutin e kane futur në port ata , po munde thuaju atyre që ta dergojnë atë sëifin po kanë berë pagesën..”*, dhe se po nga komunikimet e kqyrura mes tyre është mësuar se kjo linjë ka vijuar përgjatë vitit 2020 *(me datë 08.07.2020, ora 12:58 personi nën hetim Luçiano Koçeku e njofton” te futa ne grup me hollandezin fute dhe belgun ke 188²¹⁰ qe te sqarohet vet. Letrat vin me 15, kutia vjen me 13. 3 dite ka mundesi të rri në port. Kusho brazil kte jav fut 60 buk pasqyr 30 un e ti 30 ato. Costa Rika niset me 12 i pagova leket 325 per 50 buk 25 un 25 ti)* dhe se lidhur me sigurimin e daljes së sigurt të kësaj lende narkotike është provuar se ajo është siguruar nga personi nën hetim Luçiano Koçeku *(nëpërmjet kontakteve të tij, dhe konkretisht nëpërmjet të hetuarit Franc Çopja (referoju kqyrjes së bisedave në SKY ECC midis Luçiano Koçeku – Alfredo Hamzai dhe Luçiano Koçeku- Franc Çopja) ku po më datë 08.07.2020 ora 20;53 i shkruan “ja dhashë frnc. Hye thotë e nxjerrim sigurt ndac m punetor ndac me pin” (i referohet fotografisë së booking të kontenierëve që do të mbërrijnë të dërguar nga Alfredo Hamzai).*

- në kryerjen e këtyre “investimeve”/ blerje të lëndës narkotike së bashku, ku personat nën hetim si edhe kanë llogaritë fitimprurëse të ndara, ata kanë edhe investimet/ blerjet në to,

- në shtetin e Britanisë së Madhe mësohet se personat nën hetim Alfredo Hamzai dhe Luçiano Koçeku kryejnë aktivitetin e furnizimit të tregut të shitjes së lëndës narkotike në këtë vend, si edhe kontrollojnë personat përgjegjës të caktuar prej tyre në shitjen e saj në këtë zonë, si edhe mësohet së aktiviteti i tyre në këtë territor është i lidhur ngushtë edhe me të tjerë persona, të cilët përfaqësojnë grupe kriminale më vete që operojnë në trafikun ndërkombëtar të narkotikëve, ndër to edhe me vëllezërit **Kastriot dhe Astrit Vladi**.

✓ Lidhur me përfshirjen e **personave nën hetim Alfredo Hamzai dhe Luçiano Koçeku**, në trafikimin e lëndës narkotike në shtetin e Anglisë, provohen nga biseda të drejtëpërdrejta mes tyre ku për kohën që është kryer ky aktivitet nga ata ka pasur përpjekje për të siguruar transportimin e saj përmes linjave ajrore *(për të cilat përpigjen t'i sigurojnë më vete)* për shkak të pamundësisë nga izolimi i lëvizjeve për shkak të Pandemisë Covid 19, për të kryer këtë aktivitet me linjat e mëparshme.

²¹⁰ Nga tërësia e bisedave të kryera në SkyEcc, i referohen Pikes me nr. 188 në portin e Antëerp, Belgjikë, ku dhe pjesa më e madhe e sasive të lëndëve narkotike të ardhura prej Amerikës Latine janë nxjerrë prej aty.

Gjithashtu, edhe personi nën hetim Orgest Birçaj ka komunikime të shumta me personin nën hetim Alfredo Hamzai, në drejtim të trafikimit të lëndëve narkotike, ku ata bashkëpunojnë edhe me personi nën hetim Orest Sota, si në trafikim ashtu edhe në atë pastrimit të produkteve të veprës penale.

Personi nën hetim Orgest Birçaj në kuadër të bashkëpunimit me personat nën hetim dhe furnizimit prej personit nën hetim Alfredo Hamzai ka patur dy sekuestrime në Itali, në një nga rastet i është sekuestruar kokainë, të provuara këto nga aktet hetimore të dërguara me letërporosi nga autoritetet italiane, si më poshtë vijon:

Gjithashtu, nga analiza e komunikimeve në SkyEcc është evidentuar dhe një Pin tjetër i personit nën hetim Orgest Birçaj, që është BE684F. Nga analiza e komunikimit mes Orgest Birçaj (BE684F) dhe Alfredo Hamzai (7B9F5E) evidentohet fakti se, dy personat nën hetim kanë udhëtuar së bashku me Stamboll, me qëllim diskutimin lidhur me ndarjen e fitimit të "Summer Depo". Ky fakt dokumentohet nga komunikimi i Alfredo Hamzai (7B9F5E) me 3F9C8C, të cilit i thotë se "*Dalim jemi per pune; Po mbyllim llogarit bilancin e sumer depos*".

Personi nën hetim Ardian Zykaj është person i besuar i personit nën hetim Alfredo Hamzai, i cili qëndron kryesisht në Shqipëri, mban shënimet përkatëse, bën shpërndarjen e parave sipas porosive, ku kanë pjesë personat nën hetim Luçiano Koçeku, Orgest Birçaj apo Orest Sota, si dhe merret me investimet e të ardhurave të rrjedhura nga aktiviteti kriminal, këshillon, si dhe ndihmon aktivitetin kriminal të narkotikëve. Personi nën hetim Alfredo Hamzai mban edhe kontaktet dhe llogaritë edhe me personat nën hetim Adrian Rama dhe Elton Memeti.

Bashkëpunimi mes anëtarëve të grupit kriminal, nuk evidentohet vetëm në rastet e trafikut të kokainës, por edhe në dhënien ndihmë dhe gjetjen e kontakteve për falsifikimin e mjeteve të udhëtimit. Konkretisht, personi nën hetim Elton Memeti (VZRTJ2) dyshohet se ka mbajtur komunikime me një shtetas maqedonas, i cili në periudhën 06.12.2020 ka patur në përdorim numrin e telefonint +389707855582. Ky shtetas dyshohet se ka mundësuar krijimin e një dokumenti identifikues për Ardian Zykaj dhe/ose për Alfredo Hamzain.

Në lidhje me personin nën hetim **Orest Sota**, komunikimet në SkyEcc mes përdoruesve Alfredo Hamzai (7B9F5E) dhe Orest Sota (A9C3A8), evidentojnë qartë faktin se, shtetasi Alfredo Hamzai është i përfshirë trafikun masiv të kokainës, duke përdorur skema të avancuara dhe të mirëorganizuara me qëllim prodhimin e saj dhe më pas trafikimin e saj në vende të ndryshme të Evropës. Orest Sota nga ana tjetër, jo vetëm që është në dijeni të aktivitetit kriminal të Alfredo Hamzait, por është bashkëpunëtor i tij, dhe është aktivisht i përfshirë në veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike. Nga analizimi i komunikimeve përftohen të dhëna në drejtim të fakteve që, personi nën hetim Alfredo Hamzai e furnizon personi nën hetim Orest Sota me lëndë narkotike, në vende të ndryshme, si Greqi, Angli dhe Itali; fakte të cilat tregojnë për përfshirje në trafik kokaine të personit nën hetim në këto shtete. Biseda të ngjashme ai kryen edhe me personin nën hetim Orgest Birçaj, ku i kërkojnë lëndë narkotike njëri-tjetrit. Orest Sota i ka marrë pagesa të ndryshme nga grupi kriminal dhe iu siguron informacione policore në lidhje me faktin nëse ndaj tyre ka të dhëna. Në komunikimin mes personave nën hetim Orest Sota dhe Alfredo Hamzai flitet gjithashtu për ardhjen e prokurorëve

belg në Shqipëri lidhur me hetimet e “Toyota Yaris”. Ai gjithashtu, ka komunikime dhe me personin nën hetim Orgest Birçaj në lidhje me këtë veprimtari.

Në komunikimin e datës 11.05.2020 evidentohet me interes fakti se, shtetasi Alfredo Hamzai zotëron vlera të mëdha parash dhe sasi të mëdha lëndësh narkotike, të cilat i ndan dhe në bisedën me Orest Sotën. Konkretisht ai dërgon një bisedë një foto me 900 blloqë kokaine dhe dy foto ku, sipas asaj që thotë vetë Alfredo Hamzai, por edhe janë dukshëm të evidentueshme, kartmonedha euro në prerje 500 euro dhe 50 euro të lidhura në tufa. Nga analiza e komunikimeve në SkyEcc mes personave nën hetim Alfredo Hamzai dhe Orest Sota, është evidentuar dhe fakti se Orest Sota është përfshirë gjithashtu dhe në transportin e parave cash, si dhe është identifikuar rasti i blerjes/përfutimit mjet Mercedes Benz, model G-Class, vit prodhimi 2020, ngjyrë e zezë, me shasië E1N4632761X361365.

Në këtë aktivitet të kundërligjshëm kriminal, përftohen të dhëna dhe dyshime të arsyeshme, se shtetasit Adrian Rama dhe **Elton Memeti** kanë bashkëpunim me personin nën hetim Alfredo Hamzain dhe të tjerë, dhe kanë marrë pjesë në aktivitetin kriminal të trafikimit të lëndës narkotike. Evidentohen komunikime me rëndësi lidhur me mundësinë e trafikimit të kokainës nëpërmjet portit. Në Portugali dhe ka biseda midis Memetit dhe Hamzait, lidhur me kompaninë që përdorin për transport nga Ekuadori. Këta shtetas kanë komunikime edhe lidhur me personin tjetër nën hetim Dritan Aga, i cili po ashtu rezultoi i përfshirë në trafikimin e lëndëve narkotike dhe është dërguar nga grupi në Ekuadër, por për shkak se konflikteve që ka pasur me “çunat e kapriços” (që i referohet vëllezërve Rama), grupi është i angazhuar ta kthejë në Shqipëri. Në komunikime në këtë rast përfshihet edhe Orgest Birçaj dhe biletat e udhëtimit priten nga kompania e tij. Nga këto të dhëna përftohet fakti i përfshirjes së personit nën hetim Orgest Birçaj në dërgimin e personit nën hetim **Dritan Aga në Ekuador. Komunikimet mes personave nën hetim Alfredo Hamzai dhe Elton Memeti bëjnë fjalë gjithashtu për trafik kokaine në Angli dhe Belgjikë. Në datën 15.10.2020 Elton Memeti i dërgon Alfredo Hamzait gjithashtu një foto ku shkruhet me shkrim dore disa llogaritje për 12 “copë” dhe çmimi përkatës, shtuar transporti.**

Personi nën hetim **Adrian Rama**, siç është evidentuar dhe më sipër, ka përdorur dy pine për të komunikuar në SkyEcc dhe konkretisht 30T4KH dhe LOS9EF. Në komunikimin e mëposhtëm, të datës 08.08.2020, Adrian Rama (30T4KH) i shkruan personit nën hetim Alfredo Hamzai (7B9F5E) *“Te henen vjen ai cd ti mari 5 per ne zvicër vlla sic folem te vij ti mari si thua?”*. Nga analiza e këtij komunikimi, nisur nga fakti se personi nën hetim Adrian Rama i shkruan *“se do vijë ai me cd”*, krijohet dyshimi se personi nën hetim mund të bashkëpunojë me shtetas që lëvizin me targa diplomatike. Në vijim në datën 10.08.2020, Adrian Rama e kujton sërish Alfredo Hamzain lidhur me personin që do marrë lëndën narkotike për në Zvicër dhe i thotë se në orën 12 do jetë në Anvers. Në datën 09.07.2020, Adrian Rama shkruan *“Cpb vlla ato leket e zvicres jan te gjitha gati po mthot nurja po puna esht qe ai shoferi cd nuk shkon dot deri ne fund jav ke njeri ti atje me ti derzu ?; Leje leje ate po i them atij k.t.; Fol mos ke njeri ti per shpejtesi se po flas dhe un.; Esht me i delegacjon ai mthot nurja prandaj nuk leviz dot”*. Ky komunikim, na provon faktin se shtetasi që ka marrë lëndën narkotike në datën 10.08.2020 në Anvers, më qëllim transportin në Zvicër, është në fakt i punësuar pranë ndonjë trupe diplomatike. Gjithashtu, në datën 10.08.2020, Adrian Rama i shkruan sërish

Alfredo Hamzai dhe e pyet për çmimin e lëndës narkotike në ishull. Dysohet se mund të bëhet fjalë për trafik lëndësh narkotike në vendet e Mbretërisë së Bashkuar.

Sikurse u evidentua edhe më sipër, personat nën hetim Adrian Rama, Elton Memeti, Alfredo Hamzai dhe Orgest Birçaj kanë bashkëpunuar me njëri-tjerin me qëllim dërgimin në Ekuador të shtetasit Dritan Aga, me qëllim përfshirjen e këtij të fundit në prodhimin e lëndës narkotike, në laborator të ngritur nga personat nën hetim Alfredo Hamzai dhe Luçiano Koçeku. Kjo lëndë narkotike më pas do të tregtohej në vendet e Evropës. Personat nën hetim Adrian Rama, Elton Memeti, Alfredo Hamzai dhe Orgest Birçaj kanë bashkëpunuar me njëri-tjetrin me qëllim dërgimin në Ekuador të shtetasit Dritan Aga, me qëllim përfshirjen e këtij të fundit në prodhimin e lëndës narkotike në laborator të ngritur nga personat nën hetim Alfredo Hamzai dhe Luçiano Koçeku. Kjo lëndë narkotike më pas do të tregtohej në vendet e Evropës. Lidhur me nisjen e shtetasit Dritan Aga në Ekuador, personi nën hetim Adrian Rama ka patur komunikim të vazhdueshëm me Agën. Nga analiza e bisedës, evidentohet fakti se personi nën hetim Dritan Aga është nisur së bashku me një person tjetër. Po ashtu është arritur të identifikohet kodi pin që ka përdorur vetë z. Aga dhe konfirmohet fakti se ai është i përfshirë në aktivitetin e trafikimit të lëndëve narkotike.

Po ashtu, nga vlerësimi në tërësi i provave të administruara, përftohen të dhëna për përfshirjen në trafikimin e lëndëve narkotike, transnacionale dhe transkontinentale edhe të vëllezërve Koçeku, ku Luçiano Koçeku ka rol drejtues dhe shumë të rëndësishëm. Me të drejtë sikurse parashtrihen edhe organi i akuzës, përftohen të dhëna të bazuara në prova se **personi nën hetim Luçiano Koçeku** është i përfshirë në trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike, kryesisht e llojit “kokainë”, aktivitet në të cilin paraqitet në rolin e organizatorit dhe të menaxhuesit të çdo hallke të kryerjes së këtij trafiku ndërkombëtar të shtrirë në kohë dhe në hapësirë.

Aktiviteti i tij, ka të dhëna se i ka zanafillat më herët, rreth viteve 2008-2009, kryesisht në shtetin e Anglisë dhe se më tej, ka vijuar të zhvillohet në përmasa kryesisht përgjatë viteve 2015 (*kryesisht në Hollandë dhe Angli*) dhe më tej në vitet 2018-e në vijim duke arritur të jetë një nga personat me influencë në fushën e trafikut ndërkombëtar të lëndës narkotike, duke pasur kështu pika kontakti të drejtëpërdrejta me kryesuesit (*shtetas të huaj*) të tregut të narkotrafikut, si edhe me krerë të grupeve të tjera kriminale vendase të trafikut të lëndëve narkotike (si Franc Çopja, Astrit Vladi, Alfredo Hamzai alias Genc Bedini, Indrit Kulaj, Artur Hoxhosmani, etj.), me të cilët siguron të ketë akses në çdo pikë portuale /aerportuale në disa shtete si në: *Belgjikë, Hollandë, Britani e Madhe, Irlandë, Paraguaj, Kosta Rika, Uruguaj, Spanjë, Ekuador, Venezuelë, Barbados, Italia, Brazil, Paraguaj, Bolivi, Kosta Rika, Kolumbi, Gjermani, Guaiakil, Argjentinë, etj.*, si edhe kryen investime me to në pjesë të caktuara ku çdo grup kryen detyrat sipas marrëveshjeve të lëna mes tyre dhe se lidhur mes tyre.

Në vijim, i analizuar në rolin e organizatorit, personi nën hetim Luçiano Koçeku, ka nën kontroll të gjithë aktivitetin e paligjshëm të narkotikeve, që nga gjetja/krijimi i subjekteve tregtare fiktive në dy shtetet (*dërguese të lëndës narkotike dhe pritëse të lëndës narkotike*), lidhjen e marrëveshjeve me personat përgjegjës në vendet e Amerikës Latine, ndjekjen e itinerarit të udhëtimit të lëndës narkotike deri në destinacion përfundimtar, mbërritjen, daljen e sigurt nga pikat portuale, magazinimin, përpunimin, paketimin, shpërndarjen, kontrollin e tregut në çmime të saj deri edhe tek

organizimi se si do të qarkullojnë shuma të konsiderueshme monetare ndërmjet grupit të përsirë dhe deri në "pastrim" të tyre për t'u ligjëruar në territorin e Shqipërisë.

Madje roli i tij është edhe ai i të mbajturit kontakt me krerë të grupeve të tjera kriminale me përfshirje të gjerë në këtë aktivitet kriminal, si mund të evidentojmë grupin e Vlorës (gnc), grupin e Fierit, personin e rëndësishëm që i referohet "Tropoja", "Fieri"²¹¹, "Shtufi/ Lir", "Pashk" personat e afërm të tij (dy vëllezërit Ervin dhe Dini Koçeku, personin me emrin **Bardh të cilin ka dyshime se është i afërm i tij në linjë gjaku, Astr**²¹²), si edhe shtetas të huaj me rol të rëndësishëm në këtë aktivitet të paligjshëm, të cilëve ju referohet me nofkat "hollandezi" dhe "plaku".

Në periudhën për të cilën kryhen këto komunikime (2019-Mars 2021) personi nën hetim Luçiano Koçeku jeton kryesisht në Shqipëri dhe **drejton dhe kontrollon aktivitetin kriminal të trafikimit të lëndëve narkotike në tonelata të konsiderueshme dhe me vlera monetare të konsiderueshme të gjeneruara prej saj**, si edhe me një shtrirje të gjerë transnacionale në shumë shtete si: Kosta Rika, Peru, Paraguaj, Guaiakil, Brazil, Bolivi, Britani e Madhe, Hollandë, Belgjikë, Gjermani, Itali dhe Spanjë etj. Ai drejton dhe kontrollon në tërësi këtë aktivitet të paligjshëm që nga vendi i origjinës (Amerika Latine).

-transporti (për në portet e Hollandës, Belgjikës dhe në disa raste Gjermani);

-mbërritjen e sigurt në porte/aerporte destinacion përfundimtar (duke ndjekur tërësinë e **infinerarit të rrugëve tranzit** që kjo lëndë narkotike kryen nga Amerika Latine për në Europë, duke e ndjekur rrugëtimin e saj jo vetëm përmes pajisjeve gjurmuese GPS, përmes kontakteve të tij pjestarë të këtij grupi kriminal të drejtuar prej shtetasit Luçiano Koçeku, të cilët merren me çështjen e sigurisë së saj jo vetëm nga autoritetet policore portuale sipas porteve tranzit por edhe nga vjedhje të saj nga grupe të tjera kriminale/ si edhe mes tyre, por edhe në ndjekjen e lëndës narkotike edhe nga vet personi nën hetim Luçiano Koçeku dhe lidhjet e tij të besuara përmes emaile-eve (pasi ky aktivitet kryhet në formën e import-eksport Amerikë Latine- Europë nëpërmjet subjekteve ekonomike të çelura nga vet këta shtetas);

-dhe në disa raste **nxjerrjen e lëndës narkotike prej kontenierëve të mbërritur në destinacionin final në portet e Evropës** (e kryer kjo prej pjestarëve të grupit të orientuar prej tij, të cilët kanë vetëm këtë funksion, ose në disa raste prej grupeve të tjera kriminale të drejtuar nga të tjerë persona si, **Franc Çopja** i cili siguron dalje të sigurt në portin Antëerp Belgjikë, nga një shtetas i huaj që i referohen "**marokieni**" i cili dukshëm mësohet se është dominues në kontrollin që ai dhe pjestarët e grupit të tij kanë në portet final të Evropës, etj);

-**përpunimi i saj në ambiente të marra me qera** nga të tjerë pjesëtarë të këtij grupi kriminal dhe për të cilat personi nën hetim Luçiano Koçeku dhe Alfredo Hamzai kanë dijeni të plotë lidhur me to, ku në disa raste iu krijon mundësira për sjelljen e objekteve që cilat absorbojnë zhurmat e shkaktuara dhe erërat e përzierjeve të cilat përdoren në tonelata të konsiderueshme, duke krijuar bindjen se kemi të bëjnë me sasira të konsiderueshme të lëndës narkotikë të ardhur në formë qymyri, soje, sheqeri, dru, në paleta, pulp (fruta të lëngëzuar), fruta (banane, ananas etj.);

- **përzierja, paketimi sipas logove identifikuese të tyre dhe përgatitja për treg** e lëndës narkotike (sipas tyre referuar në termin "**bukë**") e cila kryhet nga të tjerë persona të besuar

²¹¹ Personi me nofken Fieri paraqitet person kyc, i lidhur dhe dijeni të aktivitetit të trafikimit të lëndëve narkotike të Luçiano Koçekut me Genci Bedinaj.

²¹² Nga të dhënat e komunikimeve mësohet se bëhet fjalë për shtetasin Astrit Vladi i datëlindjes 17.05.1976.

të tij të cilët janë të përcaktuar në këtë detyrë, ku kanë kontakt me "kimistët" (kryesisht shtetas të huaj nga Amerika Latine të cilët kanë njohuri të posaçme mbi llojin e lëndëve kimike dhe sasi të nevojshme për përzierje të tyre për të nxjerrë lëndën narkotike nga produkti (soje, qymyr, sheqer etj.) dhe më pas në përpunimin e mëtejshëm të saj për ta nxjerrë në formën përfundimtare), por edhe në kontrollin e cilësisë së larjes së saj (forma përfundimtare e saj) dhe paketimit;

-transportimin e lëndës narkotike (nëpërmjet mjeteve të cilat janë të përshkatura me hapësirë që të mos identifikohet nga kontrollet policore, nëpërmjet avionëve të vegjël të blerë prej tyre, nëpërmjet autobuzëve, kryesisht në linja autobuzësh të cilat drejtohen dhe menaxhohen prej personave të tyre të besuar të tyre etj.) nga vendet ku është e magazinuar për në shtetet ku do të shitet (Angli etj.);

-kontrolli i çmimeve të tregut sipas zonave ku operohet në shitje të lëndës narkotike në përkatësi të tyre duke pasur në monopol qytete të caktuara, i cili kryhet me mirëorganizim me Astrit dhe Kastriot Vladi dhe të tjerë persona të pidentifikuar në këtë fazë;

-si edhe, në dërgim të pagesave në formatin cash por edhe në ato të kaluara përmes bitcoin dhe sistemeve haçala, shuma monetare për të cilat personi nën hetim Luçiano Koçeku ka dijeni të plotë, ju kërkon informacion personave të caktuar prej tij sipas zonave ku kryhet ky aktivitet i shitjes së lëndës narkotike (si shtetasi Kastriot Vladi, edhe të tjerë persona sipas kqyrjeve të paraqitura), në mbajtjen shënim të "bukëve" të ardhura/ të shitura/ të dhëna hua apo të marra nga lidhje të tij kriminale /në shpenzime mjetes/ shpenzime lëndësh kimike të përdorura në përzierje/ shpenzime magazinimi/ shpenzime të personave të paguar (kimistët etj.) për shërbime të caktuara etj., shënime për të cilat personi nën hetim Luçiano Koçeku kërkon përditësim të vijueshem, llogaridhënie dhe kryen herë pas here kontroll për to duke pasur kështu në kontroll të plotë në kohë reale dhe të kudondodhur edhe pse fizikisht qëndron në Shqipëri dhe tërësia e aktivitetit të tij është e shtrirë në shumë shtete dhe me një numër të madh personash (si edhe provohet prej numrit të lartë (jo më pak se 304) të bashkëkomunikuesve në platformën SKY ECC), dhe në përfundim të gjithë këtij aktiviteti kriminal janë shumtë monetare të përfituara për të cilat mësohet se janë në vlera të konsiderueshme dhe që **hyrja e tyre në Shqipëri** është prej linjave të autobuzit të ardhura përmes PKK-ve Mal i Zi, Porti Vlorë (më së shumti), Porti Durrës, dhe në disa raste nga PKK me shtetin e Kosovës; cryptomonedhave dhe sistemeve haçala;

-Gjithashtu, personi nën hetim Luçiano Koçeku paraqitet në rol të tij koordinues edhe drejtues, lidhur edhe me pagesa në shuma të konsiderueshme për të cilat drejton dhe orienton të kryhen për llogari të tij nga një shtetas i huaj i pidentifikuar (përdorues i PIN BDF588). Këto pagesa janë kryer nga personi nën hetim Luçiano Koçeku (sipas pjesës së investuar prej tij) në shtete të ndryshme të Amerikës Latine dhe të Europës lidhur me sasi të lëndës narkotike që porositet prej tij nga Kolumbia, Paraguaj, Venezuela, Ekuador etj., sipas kostove që duhet të mbulohen në "gazhinën" (I referohen laboratorëve të krijuar prej tyre në vendet e Amerikës Latine, si edhe pasqyruar në kqyrjet e komunikimeve të tij), në shumtë monetare të cilat janë detyrime ndaj personave të tjerë me të cilët bashkëpunon në Evropë, si edhe të shumave monetare të përfituara nga ky aktivitet i paligjshëm. Ajo që është konstatuar në komunikimet e kryera në platformën SkyEcc të shtetasit Luçiano Koçeku, është se në këtë aktivitet kriminal të trafikimit të lëndës narkotike prej vendeve të Amerikës Latine dhe

sjelljes së saj në Europë, në vijim në përpunim etj., ka vepruar në këto “investime/blerje” (referuar sipas terminologjisë së përdorur prej tyre) sa i vetëm, (duke qenë investim totalisht i tij),

-por edhe me të tjerë persona (drejtues më vete të grupeve të tyre kriminale në fushën e narkotikëve), si shtetasi Genci Bedinaj (me tërësinë e pjestarëve të grupit të tij kriminal si Indrit Kulaj, Donis Hoxha, Arten Hamzaraj, Dritan Aga, një shtetas i paidentifikuar që i referohet “kusho” dhe për të cilin ka të dhëna se është menaxhuesi kryesor i laboratorit të krijuar në Kolumbi dhe Ekuador etj.), shtetasi **Franc Çopja** (grup kriminal më vete dhe me potencial në këtë aktivitet, kryesisht në sigurimin e daljes së sasive të lëndëve narkotike të mbërritura në Evropë dhe kryesisht Belgjikë), personat nën hetim **Astrit Vladi dhe Kastriot Vladi** (të cilët operojnë si një grup më vete, kryesisht në Evropë dhe në Angli, e lidhur me shtetasin **Bes Lala, Skënder Sufaj** (përdorues të PINEVE PD599S dhe EE2GNE, SJA8XD etj.), shtetasi shqiptar përdorues i **Pin JHQQK8** (i paidentifikuar) i cili paraqitet lidhje e tij në blerje të sasive të konsiderueshme të lëndës narkotike nga Amerika Latine dhe shpërndarjes së saj kryesisht në Britani të Madhe; shtetasin shqiptar përdorues të Pineve **VRHDIV, OL3IUK, D6S6DG** (i paidentifikuar) i cili paraqitet lidhje e tij në blerje të sasive të konsiderueshme të lëndës narkotike nga Amerika Latine dhe shpërndarjes së saj kryesisht në Britani të Madhe, shtetasin shqiptar të cilit i referohet “**Tropoja**” (i paidentifikuar në këtë fazë hetimesh), si edhe të tjerë shtetas të huaj të paidentifikuar të cilëve ju referohet me emërtimin “holandezi”, “jamsi” dhe “plaku”.

Personi në hetim **Luçiano Koçeku** ka vepruar në krye të një grupi kriminal të mirëorganizuar prej tij me objekt aktiviteti në trafikimin e lëndëve narkotike nga shtetet e Amerikës Latine për në kontinentin e Evropës (nëpërmjet kompanive tregtimi fruta, mish, qymyr), në përpunimin dhe ekstraktimin kimik të saj në disa shtete në Evropë (kryesisht Hollandë dhe Belgjikë), në furnizimin me lende narkotike në disa shtete të BE-së (Belgjikë, Hollandë, Britani e Madhe, Irlandë, Itali), në kryerjen e transfertave kontinentale (brenda Evropës) dhe ndërkontinentale të shumave monetare në vlera të konsiderueshme deri edhe në disa miliona euro/paund; në kryerjen e transfertave kontinentale (brenda Evropës) dhe ndërkontinentale të pagesave/përfitimeve në kriptomonedha; të pastrimit të këtij produkti të përfshuar nga kjo veprimtari kriminale nëpërmjet industrisë së ndërtimit në shtetin tonë dhe kryesisht në Tiranë dhe bregdetin jugor të Shqipërisë (e kryer me subjekte ndërtuese që nuk janë në emër të tij), pastrim i kryer nëpërmjet subjekteve ekonomike ndërtuese “Nova Construction” dhe “LTD” të cilat janë në emër Ilir Shtufi dhe kunatit të personit nën hetim **Luçiano Koçeku, Gëzim Islami** (dhe në disa raste edhe të vëllait të tij **Kujtim Shtufi**, në një rol dytësor lidhur me hetimet), por që në mënyrë indirekte ato menaxhohen, drejtohen prej shtetasit **Luçiano Koçeku** (i cili në komunikimet e kryera në SkyEcc paraqitet si pronari real i tyre, duke pasur në kontroll të plotë ndërtimet, pasuritë e ndërtuara dhe shitjet e tyre)²¹³.

Nga tërësia e bisedave të zhvilluara nga personi nën hetim **Luçiano Koçeku**, me shtetasit e sipërcituar lidhur me investimet (blerjet) e lëndës narkotike në Amerikën Latine, dhe pjesën takuese të tij, për të cilën duhet të kryej pagesa tek furnitoret në vendet e Amerikës Latine, si edhe përfitime të cilat janë përfshuar prej tij gjatë periudhës 11.02.2020- 06.03.2021, provohet se janë kryer pagesa (të copëzuara

²¹³ Referojuni komunikimeve të këqyrura mbi komunikimet me objekt evidentimi të pasurive të **Luçiano Koçeku**.

në kohë) të cilat në përlllogaritje janë në vlerën totale prej **12,635,670 euro, 14,192,689 Paund, 5,035,000 dollar dhe 1.5 milion pesos** ²¹⁴.

Nga ky aktivitet kriminal rezulton e provuar se ai është i lidhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë në disa raste të sekuestrimeve të lëndëve narkotike të kryera nga autoritetet e huaja, dhe konkretisht:

7. Nga komunikimet e kryera në SkyEcc janë pohuar nga personi nën hetim **Luçiano Koçeku** disa raste të humbjeve të sasive të lëndëve narkotike ku është shprehur se i kanë rënë **“600 në 17 Dhjetor 2019; 1.2 në 25 Dhjetor 2019, 1 ton në 24 Dhjetor plus punën e 1 ton në 24 Prill 2020”** dhe se më tej nga komunikimet mes tyre janë mësuar të dhëna se këto sasi lëndësh narkotikë të cilat kanë qenë në kontenierë (ku dyshohet se mund të kenë qenë edhe në disa raste **sojë**, në të cilën ka qenë e fshehur lënda narkotike) dhe se këto kontenierë janë të dërguar nga e njëjta kompani **“maxi granis ose maxigrans”** dhe se pronari i saj sipas dokumentacioneve të kësaj kompanie ka emrin **“Luis”** i dyshuar me gjeneralitetet **Luis Sebriano- i arrestuar për trafikim të lëndëve narkotike (operacioni Black Eagle)**.

8. **“Punën e 1 ton në 24 Prill 2020”**, nga ana e këtyre shtetasve shqiptare, përdorues të SkyEcc, në komunikimet e tyre (ai i datës 30.06.2020) niset një fotografi me përmbajtjen **“Contanier MRKU2397966 has arrived at the terminal. The Contenier is blocked by costumes. Vessel Name- CAP SAN LORENZO Voyage In- 012N. Carrier Operator- MAERSK LINE AS (PDF)C/O dhe Arrival Date 4/23/2020”** dhe se: sa më sipër dhe të dhënave të përfuara nga bisedat e shtetasve shqiptare në SkyEcc, dyshohet se bëhet fjale për një sasi lënde narkotike (e papërcaktuar në llojin e saj) e dyshuar se bëhet fjalë për sasinë 1(një) ton lënde narkotike, e ndodhur në konteniere, e cila është sekuestruar nga autoritetet e shtetit të Paraguaj më datë **23/24.04.2020**. (lidhur për këtë rast është dërguar letërporosi Autoriteteve të shtetit të Paraguaj, në pritje të përgjigjes).

9. Në datën 29.05.2020 në Birmingham Angli sasia e lëndës narkotike prej 162 kg kokainë e trafikuar nga grupi kriminal dhe besohet që përgjatë periudhës 2 maj deri 29 maj 2020 të jenë trafikuar një sasi prej 882.5 kg.

10. Më datë 14.01.2020 në arrestimin e shtetasit Indrit Kulaj në Barcelonë, Spanjë në sekuestrimin e një sasie prej 441 kg lëndë narkotike kokainë (ku nga komunikimet provohet se ka pasur pjesë në të)

11. Në sekuestrimin e kryer më datë 29.06.2020 të shtetasit Bes Lala në Angli.

12. Në të dhënat hetimore të cilat janë evidentuar nga operacioni **“Black Eagle”**, nga autoritetet belge, ku në to ka qenë person i pidentifikuar me pseudonimin **“loku”** por që në tërësinë e aktivitetit dhe personave të lidhur me të paraqitet person i lidhur dhe me rol të njëjtë si Genci Bedinaj, Indrit Kulaj etj.

Lidhur me trafikimin e lëndës narkotike në shtetin e Anglisë, është provuar përfshirja e **personit nën hetim Luçiano Koçeku**, në këtë aktivitet të paligjshëm, në të cilin provohet pjesëmarrja në të/pjesës takuese edhe e vëllait të tij të **Din alias Abedin Koçeku**, si edhe dy shtetasve **Kastriot Vladi dhe Astrit Vladi** edhe personave të tjerë ende të pidentifikuar në këtë fazë të hetimeve.

²¹⁴ (për kohën e komunikimeve është vlerësuar se 1 Euro=3525 pesos), e dhënë e përfuara nga kryerja e komunikimeve të kryera ndërmjet PIN 60CEA0 dhe K4LX0K (të identifikuar të përdorur nga shtetasi shqiptar Artur Koçeku (Koçeku) alias Luçiano (Luçiano) Koçeku (Koçeku) dhe Pin BDF588 (i pidentifikuar, në dyshim shtetas i huaj).

Për sa kërkuar autoriteteve ligjzbatuese të Mbretërisë së Bashkuar (*Kërkesë për ndihmë juridike nr.L260 Prot., E.K datë 07.05.2024*), lidhur me ngjarjen e datës 29.05.2020, ku **Luçiano Koçeku** shprehet se, “*janë kapur 75 buke*” dhe se nga leximi i komunikimeve të tij në SKYECC me shtetasin **Din Koçeku** dhe **Astrit Vladi**²¹⁵ është mësuar se bëhet fjalë se: “*date 29.05.2020 i janë kapur 75 buke dhe se kanë qënë mjete Audi A6 dhe se shoferi i tyre shtetasi Paul Shaën është arrestuar vecante, pasi mund te jete larguar nga mjete, ku po nga leximi i bisedave në SKY ECC është mësuar se personi i cili është arrestuar nga policia britanike quhet SHAË Paul, Steven, i datelindjes 18.04.1986, i lindur në Manchester, adrese banimi ne 15 Kirkstone Drive Middleton , Manchester, Post Code M24 5QF është arrestuar më datë 29.05.2020 (12:50), me oficerin qe kryen arrrestimin PC 3017 dhe me Costudy Officer CIV 50790 Plant dhe se offece – 01 posses -Cotrolled Drug E/I To Supply në kuadër të hetimeve të kryera, dhe të cilat janë vendosur në dispozicion ku konfirmohet fakti se, më datë 29.05.2020 është kryer arrestim i shtetasit të huaj Paul Shaë, sasisë prej 74x1 kg “tulla” kokainë nga furgoni i marrë me qera nga Paul Shaë për në pjesën e pasme të Audit të Liam Cherrett dhe se për më tepër informohet për *modus operandin* e këtij grupi kriminal, personat e përfshirë në të dhe sasisë e lëndës narkotike të sekuestruar më atë datë, si edhe në data të mëhershme të pasura nën hetim nga këto autoritete.*

Të gjitha këto të dhëna të përfuara nga autoritetet e drejtësisë Britanike janë në koherencë me komunikimet e kryera në platformën SkyEcc nga personi nën hetim Luçiano Koçeku, me shtetasit Din Koçeku, Astrit Vladi, Kastriot Vladi dhe persona të paidentifikuar në këtë fazë hetimesh, ku nga kqyrja e këtyre komunikimeve të kryera mes tyre por edhe me të tjerë persona (të paidentifikuar) është mësuar se ata janë poseduesit real të lëndës narkotike, personat që kanë pjesën e tyre në këtë rast të sekuestruar, personat që janë organizatorët e këtij trafiku lënde narkotike nëpërmjet kësaj linje tokësore dhe ajrore Hollandë- Angli dhe se janë personat të cilët kanë kontaktin me shtetas të huaj në hierarki në këtë aktivitet të përbashkët të cilit i referohen “hollandezit”

Lidhur me aktivitetin e personit nën hetim **Dino Koçeku** në shtetin e Anglisë dhe kryesisht të lidhur me aktivitetin e drejtuar nga **Kastriot Vladi dhe Astrit Vladi**, nga hetimet mësohet se ekziston komunikim jo vetëm i kryera nëpërmjet Luçiano Koçekut dhe Astrit e Kastriot Vladi, por edhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndërmjet Dino Koçeku dhe Kastriot Vladi. Ky komunikim i kryer mes tyre në SkyEcc është në kronologji dhe i kryer në kuadër të trafikimit të lëndës narkotike në Angli dhe nëpërmjet të njëjtës mënyrë se si është evidentuar aktiviteti kriminal i narkotikëve i këtij grupi kriminal të hetuar nga autoritetet policore Britanike dhe të përcjella prej tyre me anë të letërporosisë, ku pasqyrohen komunikimet e kryer në SkyEcc ndërmjet Dino Koçeku dhe Kastriot Vladi.

Lidhur me trafikim të lëndëve narkotike, shpërndarje edhe tregtim të saj kryesisht në Britani të Madhe (Birmingham), të kryera këto me linja të ndryshme, ku më konkretisht pasqyrohet linja e përdorur nëpërmjet shtetasve të huaj (*britanik dhe hollandez*), si edhe shqiptar të cilët transportojnë lëndën narkotike nëpërmjet mjeteve të vogla të përshtatura me hapësira të krijuara nga ta dhe të transportuara deri në nisjen e saj edhe nëpërmjet avionëve, ku në komunikimet e kryera ndërmjet

²¹⁵ provohet se janë të lidhur me ngjarjen e datës 29.05.2020, ku ata i referohen “punë e tyre”, “shoferi jon”, “audi gri” dhe “bukët” e tyre si edhe paraqesin interesim që nga ana e tij (shoferit) të mos jepen të dhëna autoriteteve policore te Britanisë.

shtetasve Abedin Koçeku dhe Kastriot Vladi, **të kryera në disa data konkrete të muajit Maj 2020** mësohet se si ata e organizonin punën e tyre dhe të grupit të tyre, ku rezulton i përmendur edhe Turi (Artur Koçeku) duke përfshirë kështu edhe mënyrën sesi ishin organizuar për të kryer edhe transportimin e lëndës narkotike **më datë 29.05.2020**, ku ka ndodhur edhe sekuestrimi i saj në Birmingham nga autoritetet policore britanike (*referojuni kqyrjes së komunikimit mes tyre*), ku pjesërisht bëhen me dije:

Po nga këto komunikime mes tyre janë përfutur të dhëna lidhur me rastin e sekuestrimit të lëndëve narkotike më datë 29.05.2020 në Birmingham, Angli, e pasqyruar në kronologji nga data e porositjes me 26.05.2020 dhe deri në datën e ngjarjes më 29.05.2020, ku në këto biseda personi nën hetim Dino Koçeku (PIN FF789D) ka informacion të plotë lidhur sasinë e lëndës narkotike, mjetet e përdorura, vendin ku do të kryhet transporti, personat të cilët ndodhen në atë vend dhe për gjithë veprimet e kryera që ndodhin pas arrestimit të kryer nga autoriteteve policore Britanike.

Gjithashtu, po nga kqyrja e këtyre komunikimeve të kryera mes tyre janë evidentuar të dhëna mbi investimin e këtyre shumave monetare të përfutura nga aktivitetit i paligjshëm, për në industrinë e ndërtimit, dhe konkretisht ka dyshime se ato fshihen prej tyre në ndërtimet e kryera nga subjekti “Nova Construction” dhe derivate të këtij subjekti (*të cilat qëndrojnë në emër të shtetasit Ilir Shtufi*), ku në bisedat mes vëllezerve del dukshëm fakti i të sjellurit pronar të ndërtimeve të kryera nga subjekti ndërtues i sipërcituar.

Të gjitha këto përfitime të arritura përmes këtij aktiviteti të paligjshëm të investuara në pasuri të lujtshme dhe të paluajtshme ka dyshime se jo qëllimisht janë fshehur në emër të tjerë shtetasve/subjekteve ekonomike nisur nga fakti i të menduarit që për shkak të dënueshmerisë së pasur (*Dino Koçeku i dënuar më parë në Itali për trafik narkotikësh*) mund të jenë subjekte të evidentuara për hetim në kuadër të pastrimit të produkteve të ardhura nga veprimtaria kriminale e kryer prej tyre. (*Referojuni Kqyrjeve të kryera për to*).

Personi nën hetim Dino Koçeku është në koherencë të vijueshme lidhur me aktivitetin e trafikimit të lëndëve narkotike të organizuar nga i vëllai i tij Luçiano Koçeku. Ai ka komunikime të drejtëpërdrejta lidhur me përgatitjen e sasive të lëndës narkotike, amabalazhimit të saj dhe të cilësisë së saj, duke pasur edhe shkëmbime të fotografive përkatëse të sasive të lëndës narkotike për konfirmim të cilësisë në dukje në foto dhe të paketimit të saj.

Gjithashtu, po nga kqyrje e komunikimeve të kryera mes personave nën hetim Luçiano Koçeku dhe Dino Koçeku, ku në to janë evidentuar të dhëna mbi investimin e këtyre shumave monetare të përfutura nga aktivitetit i paligjshëm i narkotikëve, në blerje të mjeteve luksoze (*jo në emër të tyre*), si edhe në industrinë e ndërtimit, dhe konkretisht ka dyshime se ato fshihen prej tyre në ndërtimet e kryera nga subjekti “Nova Construction” dhe derivate të këtij subjekti (*të cilat qëndrojnë në emër të shtetasit Ilir Shtufi*), si edhe referuar edhe bisedës së kryer mes tyre më datë 10.01.2020, ora 16:24 ku personi në hetim Dino Koçeku (*përdorues i PIN FF789D*) i ka kërkuar Luciano Koçekut se “*po pate naj okazjon per makin me mall per mu me thuj se kam fol me gzimjn me tha ta maj un ne emer pa problem se di qa do me mar ti po nuk more g klas ti ta marr un ose qa dush ti se ai keli ja kishte dhan mKinen maksit dhe ai vite fun muj*”.

Raste të evidentuara ku personi nën hetim **Dino Koçeku** kryen veprime të drejtëpërdrejta lidhur me përfshirjen e tij në trafikim të lëndëve narkotike, ku në këtë veprimtari të paligjshme shfaqet se ka

aktivitet më vetë²¹⁶ dhe me llogari tërësisht të tija në investimet e kryera prej tij por duke shfrytëzuar lidhje dhe njohjet e personit nën hetim Luçiano Koçeku në kryerjen e transportit të saj nëpër shtete të Europës për dhe kryesisht drejtë Anglisë dhe për të vijaur më tej me shijen në tregje ku operohet nga personat nën hetim Astrit dhe Kastriot Vladi, si edhe saktësohet në komunikimin e kryer në SkyEcc ndërmjet Dino Koçeku (FF789D) dhe Luçiano Koçeku (60CEA0), ku i dërgon fotografi të lëndës në dukje si ajo e lëndës narkotike të paketuar me logon identifikuese

Për sa i përket shtetasit **Ervin Koçeku** (përdorues i PIN GGL7ID), në bisedat e zhvilluara (në periudhën kohore 2020) përmes platformës së enkriptuar SkyEcc me shtetasin Luçiano Koçeku (PIN 60CEA0) mësohet se Ervin Koçeku është në dijeni të aktivitetit të paligjshëm në fushën e lëndëve narkotike, ku sipas komunikimeve mësohet se vepron së bashku me shtetasin Luçiano Koçeku (i vëllai), ku gjatë periudhës së këtyre komunikimeve (2020) qëndron në Shqipëri dhe se ndjek aktivitetin e përpunimit, shpërndarjes dhe përfitimit të shumave monetare të gjeneruar prej saj, shuma këto të cilat shpesh i merr personalisht, si edhe i shpërndan në të tjerë persona, të kryera këto në dijeni të plotë nga i vëllai, personi nën hetim Luçiano Koçeku.

Gjithashtu, po nga kqyrje e këtyre komunikimeve të kryera mes tyre janë evidentuar të dhëna mbi investimin e këtyre shumave monetare të perfituara nga aktivitetit i paligjshëm, në blerje të mjeteve luksoze (jo në emër të tyre), si edhe në industrinë e ndërtimit, dhe konkretisht ka dyshime se ato fshihen prej tyre në ndërtimet e kryera nga subjekti “Nova Construction” dhe derivate të këtij subjekti (të cilat qëndrojnë në emër të shtetasit Ilir Shtufi), ku në bisedat mes vëllezërve del dukshëm fakti i të sjellurit pronar të ndërtimeve të kryera nga subjekti ndërtues i sipërcituar.

Në krahasim nga aktiviteti i shtetasve Dino Koçeku dhe Luçiano Koçeku (për të cilët nga tërësia e bisedat të tyre mësohet se në kohën e këtyre bisedave kanë pasur armë zjarri) shtetasi Ervin Koçeku në këto biseda evidentohet si një person që ka dyshime që investon në blerje të armëve të zjarrit të llojeve të ndryshme, si edhe të faktit që ka tendencë të pasurit të tyre me vete në lëvizje.

Personi nën hetim **Kastriot Vladi** (përdorues i PIN 3E0D4C), në bisedat e zhvilluara (në periudhën kohore të vitit 2020) përmes platformës së enkriptuar SkyEcc me shtetasin Luçiano Koçeku (PIN 60CEA0) mësohet se aktiviteti i tij i paligjshëm në fushën e lëndëve narkotike është i shtrirë në shtetin e Britanisë së Madhe, ku për shtetasin Luçiano Koçeku paraqitet një person i besuar në këtë aktivitet të paligjshëm jo vetëm në furnizim me lëndë narkotike të tregut

Për sa i përket personit nën hetim Astrit Vladi, (përdorues i PIN D787B0), në bisedat e zhvilluara (në periudhën kohore 25.11.2019-21.01.2021) përmes platformës së enkriptuar SkyEcc me shtetasin Luçiano Koçeku (PIN 60CEA0) mësohet se aktiviteti i tij i paligjshëm në fushën e lëndëve narkotike është i shtrirë në shtetin e Britanisë së Madhe, ku për shtetasin Luçiano Koçeku paraqitet një person i besuar në trafikim të sasive të konsiderueshme të lëndës narkotike nga shtete si Peru, Paraguaj etj., mbërritje të saj në portet e Europës dhe më tej në transportimin e saj përmes kamioneve, mjeteve të vogla si edhe avioneve për në Britani të Madhe, ku më tej në këtë vend operon së bashku me vëllain e tij Kastriot Vladi, ku paraqitet të ketë nën kontroll tregun Britanik dhe

²¹⁶ Si edhe pasqyrohet në komunikimin e kryer më datë 18.06.2020 ora 17:48, ku Dino Kocku (FF789D) i komunikon “a gjen dot 4 buk pastra kuqe ne bruskel. I do ai shoferi im”.

në vijim gjenerimin e shumave monetare të konsiderueshme për të cilat sigurohet po në të njëjtën mënyrë për t'i kaluar nga një shtet në tjetrin si edhe në Shqipëri. Nga kqyrja e komunikimeve të kryera në platformën SkyEcc mes tij dhe shtetasit Luçiano Koçeku është përfshirë e dhëna se këto shtetas kanë një bashkëpunim në kohë lidhur me trafikun e lëndëve narkotike si atë ndërkombëtare por edhe atë brenda shteteve të Evropës, si edhe brenda brianit të së Madhe, duke mësuar se ashtu si veprojnë më vetë *(së bashku me vellezërit e tij Kastriot Vladi dhe lidhjet e tyre)* ashtu edhe vepron/jnë sëbashku me shtetasin Luçiano Koçeku dhe personat e besuar të këtij të fundit

Lidhja e shtetasit Astrit Vladi provohet se është e shtrirë në kohë, dhe e lidhur në ngarkesa me lëndë narkotike të cilat porositen të vijnë nga Amerika Latine, të investohen prej tyre *(vëllezerve Vladi)* në pjesë të caktuara me të tjerë persona të huaj/shqiptarë dhe, se më tej vijohet me transportimin e tyre në shtetet europiane *(dhe të besuarve të tyre, kryesisht të krahinës së tyre Lurë- Dibër- Kukës, të cilët janë edhe persona të besuar dhe lidhje edhe e vëllezerve Koçeku)* nëpërmjet linjave të autobuzëve, mjeteve të pajisura me vende të përshtatshme për të fshehur lëndën narkotike dhe shumat e lekëve si edhe linjave ajrore. Ky rrjet i shpërndarjes dhe i shitjes së lëndëve narkotike është mësuar se është i miëorganizuar dhe se në të lidhen interesat e Vladëve dhe Koçekëve, ku secili ka të mirëpërcaktuar se çfarë duhet të siguroj, si në shofer, mjete logjistike, vende të fshehta të llojit shtëpi, magazina etj., pajisje telefonash të enkriptuar etj. *(të gjitha këto të dhëna janë të evidentuara në kryerjet e komunikimeve të kryera prej tyre në SkyEcc).*

Nga hetimet ka rezultuar se lidhur me ngjarjen e datës 29.05.2020, për të cilën autoritetet britanike informojnë për operacionin Belsshaar, dhe ku paraqiten në tërësi personat e arrestuar, lënda narkotike e sekuestruar, komunikimet e kryera në platformën Encrochat, si edhe personat e tjerë të lidhur me këto komunikime, nga analizimi i komunikimeve të kryera prej Koçekut dhe konkretisht në komunikimet mes tij dhe personit me PIN D787B0 *(i përdorur nga Astrit Vladi)* paraqitet përfshirja e tij në këtë aktivitet kriminal, ku evidentohet në rolin e organizatorëve të kësaj linje trafiku, ku edhe pse nuk është aty fizikisht, arrijnë të drejtoj dhe kontrollojnë aktivitetin prej vendi ku qëndron *(në Shqipëri, si edhe shtetasit Luçiano Koçeku dhe Dini Koçeku).*

Shtetasi **Astrit Vladi** ka vijuar të ketë një komunikim në kohë dhe në vijueshmëri lidhur me këtë ngjarje dhe se në këtë komunikim me vëllain e tij Kastriot Vladi përpiket që të dijë sasinë e lëndës narkotike të tyre, sigurinë që ka vendi i mbajtjes së saj pasi ka frikën e mësimit të saj nga autoritetet policore si edhe të faktit se kjo linjë transporti është e djegur *(jo më e sigurt për ta)* si edhe mbi komunikimet (shpjegimet) që shtetasit e huaj të arrestuar kanë dhënë *(e paraqitur e plotë në kqyrjet e plota të komunikimeve të tij me Kastriot Vladi / Luçiano Koçeku).*

Lidhur me përfshirjen e shtetasve **Kastriot Vladi dhe Astrit Vladi** në trafikun e lëndës narkotike, provohet se ata krahas “*humbjes*” së datës 29.05.2020 në Birmingham, këto persona kanë pasur edhe disa humbje të tjera, dhe ndër to e cila është evidentuar me datë të saktë është edhe ajo e “*humbur/rënë*” disa “*rruge*” *(nënëkuptuar ju janë sekuestruar në disa raste sasi të lëndëve narkotike)* **më datë 12.12.2019 ju janë sekuestruar të paktën 520 kg lëndë narkotike** e llojit kokainë, lëndë narkotike e konstatuar gjatë një inspektimi në Portin e Roterdam, ku kjo lëndë narkotike ishte në një kontenier me Mango, e ardhur prej Brazilit dhe e destinuar për një kompani Gjermane.

Përveç përfshirjes së personave nën hetim në veprimtari të trafikimit të lëndëve narkotike janë përftuar të dhëna me interes në drejtim të pastrimit të parave për të cilat vijon veprimtaria si më poshtë vijon.

Personat nën hetim **Adrian Rama, Elton Mehmeti, Alfredo Hamzai, Ardian Zykaj, Luçiano Koçeku, Orgest Birçaj, Orest Sota**, përveçse janë të përfshirë në veprimtari të trafikimit të lëndëve narkotike, ata janë të përfshirë edhe në pastrimin e produkteve të veprës penale, konkretisht të të ardhurave që rrjedhin nga veprimtaria kriminale përgjatë periudhës 2017- e në vijim.

Për personat nën hetim **Artur Shehu e Arben Ismailaj dhe Leonard Bishaj** ka indicie të mjaftueshme për përfshirje të tyre në veprimtari kriminale të trafikimit të narkotikëve dhe të dhëna të mjaftueshme për falsifikim të dokumentave (*e parashkruar kjo për shkak të kohës së kryerjes së saj*), të cilat përbëjnë bazë të mjaftueshme për përfshirje të tyre më pas në veprimtari kriminale të “Pastrimit të produkteve penale” si dhe me veprimet e kryera në kuadër të bashkëpunimit të veçantë me personat e tjerë nën hetim, të përfshirë në veprimtari kriminale të trafikimit të lëndëve narkotike, ata përfshihen në veprime të kundërligjshme të pastrimit të produkteve të veprës penale.

Përgjatë kësaj veprimtarie kriminale personat nën hetim **Adrian Rama, Alfredo Hamzai, Ardian Zykaj, Elton Memeti** janë ndihmuar nga personi nën hetim **Besnik Myftari**, ku duke analizuar mënyrën e të vepruarit, provohet qëllimi dhe dijania e tij për paligjshmërinë e të ardhurave që përdoren për të investuar në pasuri.

Gjithashtu, personat nën hetim **Adrian Rama e Elton Memeti** bashkëpunojnë me personin nën hetim **Edmond Jaupi** në investime që kryejnë, si dhe ky i fundit është përfshirë në veprime duke fshehur pronësinë e vërtetë të një mjeti lundrues “gomone”, e cila i përket personit nën hetim Adrian Rama.

Nga hetimet e kryera në tërësi përftohen të dhëna të rëndësishme nëpërmjet të cilave provohet që ~~persona të përfshirë në veprimtari kriminale lidhen me njëri-tjetrin, kryejnë veprime investimi, tjetërsimi të pronave me njëri-tjetrin në zona të njëjta, duke ndihmuar dhe bashkëpunuar në këtë veprimtari kriminale. Lidhjet e tyre në këto investime tregojnë jo vetëm për njohje të tyre, por edhe dijeninë e secilit prej tyre në paligjshmërinë e veprimeve që kryhen, duke vepruar në bashkëpunim të veçantë me njëri-tjetrin dhe me dashje direkte në pastrimin e produkteve të veprës penale, në të tre fazat e saj, si më poshtë vijon:~~

- Veprimtaria kriminale e tyre është konstatuar në transferim, transportim të të ardhurave të rrjedhura nga veprimtaria kriminale e trafikimit të narkotikeve, të njohur si **faza e “vendosjes”** apo nëpërmjet sistemeve alternative, nëpërmjet sistemit haçala, duke krijuar më pas mekanizmat për t’i pastruar ato nëpërmjet:
- Investim në blerje të pasurive të paluajtshme duke pasqyruar fshehur natyrën e vërtetë të veprimit; apo pronësisë me qëllim shmangien e justifikimit të burimit të ligjshëm; apo vështirësimin e gjurmimit të pasurisë dhe lidhjen e saj me personat nën hetim (**shtresëzim**);
- *Falsifikimin e dokumentave të përfitimit të pronësisë duke krijuar pronësi të pavërtetë ose duke shtuar sipërfaqet e pronësisë. Kjo realizohet nëpërmjet njohjeve dhe lidhjeve të shumta, duke patur mundësi për të regjistruar pronat, krijuar apo shtuar sipërfaqe, realizuar kjo nëpërmjet sigurimit të prokurave të përfaqësimit;*
- *-copëzimet e shumta të tyre dhe më pas tjetërsimet e tyre, në format e blerjes, shkëmbimit apo formave të tjera, me qëllim vështirësimin e gjurmimit dhe përfitimin e këtyre, duke shmangur dhe*

shkëputur lidhjen ndërmjet përfituesit fillestar (personit) në emër të të cilit regjistrohen pronat dhe përfituesit fundor të tyre që janë personat nën hetim.

- dhënien e trojeve të përfituara në këto forma, subjekteve zhvillues ndërtues, në marrëveshje ndërmjet tyre, duke integruar dhe përzier në këtë mënyrë të ardhurat e paligjshme me ato të ligjshme, provuar në disa raste në dijëni të plotë të subjekteve ndërtues; *Një modus operandi i tillë është konstatuar edhe me veprimet e kryera nga grupet kriminale që kanë vepruar në zonën e Palasë, Himarë, apo Dhërmi Vlorë, apo Tiranë.*
- - *duke integruar të ardhurat e rrjedhura nga veprimtaria kriminale e trafikimit të narkotikëve në shoqëritë tregtare të zotëruara nga personat nën hetim apo në krijim të shoqërive tregtare në zotërim apo fshehur tek persona të tjerë me qëllim pastrimin e të ardhurave që rrjedhin nga aktiviteti kriminal, duke krijuar qarkullim monetar nëpërmjet gjenerimit të detyrimeve për të rritur qarkullimin dhe më pas investimin e tyre në pasuri të paluajtshme, **fazë e njohur -ajo e integritit.***

Kjo veprimtari kriminale shfaqet dhe provohet e dokumentuar në rastet si më poshtë vijon:

- i. Veprimet e kryera nga personat nën hetim **Adrian Rama, Artur Shehu, Elton Memeti, Alfredo Hamzai, Ardian Zykaj** në truallin e ndodhur në rrugën “Dervish Hima” pranë stadiumit “Air Albania” njohur ndryshe si “*toka tek juvenilja*”, kryer të paktën nga vitet 2017 e në vijim.
- ii. Veprimet e kryera nga personat nën hetim **Adrian Rama, Artur Shehu, Arben Ismailaj, Alfredo Hamzai e Ardian Zykaj** me vilat e ndodhura në kompleksin “Green Coast” Palasë, Himarë në vitet 2019 e në vijim.
- iii. Veprimet e kryera nga personat nën hetim **Arben Ismailaj, Artur Shehu, Alfredo Hamzai e Ardian Zykaj** në lidhje me tokat e përfituara për të ndërtuar kompleksion “Green Coast” duke filluar nga viti 2009 e në vijim.
- iv. Veprimet e kryera nga personat nën hetim **Arben Ismailaj, Alfredo Hamzai, Ardian Zykaj e Luçiano Koçeku** kryer në bashkëpunim të vecantë në kuadër të grupit të strukturuar kriminal në lidhje me ndërtimin e kompleksit “Green Coast 4”.
- v. Veprimet e kryera nga personat nën hetim **Alfredo Hamzai, Ardian Zykaj, Ardian Rama, Elton Mehmeti e Besnik Myftari** me marrjen e licensës së televizionit dhe radio, si dhe me mjetin me targa AB020 BA.
- vi. Veprimet e kryera nga personat nën hetim **Adrian Rama, Elton Memeti e Erjon Rama, e Edmond Jaupi** për pastrimin e të ardhurave të rrjedhura nga aktiviteti kriminal në formën e investimeve nëpërmjet faturimeve ndërmjet shoqërive “Kryon.83” me “ICLIMA ALBANIA” sh.p.k. me Nipt M01818009Q e Shoqëria “Ecs Eco Climate Solution” sh.p.k. me Nipt L22218013G, duke i investuar ato në blerje të pasurive të paluajtshme, apo në kryerjen e veprimeve për fshehjen e pasurisë së luajtshme, mjet lundruer “gomone”.
- vii. Veprimet e kryera nga personat nën hetim **Adrian Rama, Elton Memeti e Erjon Rama** në gjetjen e banorëve të zonave në Vlorë të cilët disponojnë troje të paregjistruara, lidhjen e kontratave me ta duke blerë sipërfaqe apo duke marrë përsipër nxjerrjen e dokumentacioneve, si dhe lejeve të ndërtimit në këto zona.
- viii. Veprimet e kryera nga personat nën hetim **Alfredo Hamzai, Ardian Zykaj, Orgest Bircaj dhe Orest Sota** në lidhje me investime në pasuri të paluajtshme në ndërtime; apo investime

në shoqëri të tjera ku ata shfaqin interesa përfshi këtu kompanitë “2 A Construction”, “Onix”, “Top Seven” dhe “Top Seven Construction”.

- ix. Veprimet e kryera nga personat nën hetim **Luçiano Koçeku, Ilir Shtufi e Gëzim Islami** në investime në ndërtime në zonën e Tiranës nëpërmjet shoqërive “LTD” sh.p.k; “Nova Construction” sh.p.k dhe ndërtimin e objekteve të ndryshme në Tiranë.

Në lidhje me veprimet e kryera nga personat nën hetim **Adrian Rama, Artur Shehu, Elton Memeti, Alfredo Hamzai, Ardian Zykaj dhe Besnik Myftari** në truallin e ndodhur në rrugën “Dervish Hima”, pranë stadiumit “Air Albania”, njohur ndryshe si “*toka tek juvenilja*”, kryer të paktën nga vitet 2018 e në vijim.

Nga analizimi i veprimeve të kryera në lidhje me këtë pasuri, si dhe bisedat e përfuara nga përgjimet dhe komunikimet “SkyEcc” provohet se personat nën hetim **Adrian Rama, Alfredo Hamzai, Ardian Zykaj, Elton Memeti dhe Artur Shehu** kanë kryer veprime të kundërligjshme të cilat përbëjnë pastrim të produkteve të veprës penale sipas nenit 287 të Kodit Penal të cilat konsistojnë në:

- mbulimin e natyrës së vërtetë të disponimit, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë për të shmangur justifikimin e burimit të ligjshëm të të ardhurave për shkak të vlerës që ka kjo sipërtoke toke nisur nga pozicioni i saj gjeografik dhe zhvillimit të zonës;
- transferimin e pasurisë tek disa persona (*veprime të njëpasnjëshme*) me qëllim fshehjen e origjinës së paligjshme, përfutur nga të ardhura të rrjedhura nga aktiviteti kriminal;
- si dhe në fshehjen e transferimit të pasurisë tek persona pa probleme, por që janë të lidhur me persona që kryejnë aktivitet kriminal, fakte të cilat tregojnë se këto pasuri zotërohen nga vetë personat nën hetim, por veprimet janë kryer për fshehur lidhjen e tyre me tokën apo zhvillimin e saj, si dhe lidhjen me njëri-tjetrin veprime të cilat janë dokumentuar edhe në raste të tjera, të cilat tregojnë mënyrën e të vepruarit të këtij grupi kriminal.

Në dosjen, tashmë gjyqësore, janë të administruara prova të tilla të sipërcituara që tregojnë të dhëna se personat nën hetim kanë kryer veprat penale respektive, sikurse është evidentuar edhe në episodet përkatëse dhe analiza në mënyrë të detajuar e fakteve kriminale të dyshuara në këtë rast, si dhe përfshirja e personave nën hetim është analizuar në pjesën e rrethanave të fakteve dhe burimet e provave dhe nuk ka vend për rianalizimin e tyre më gjatë në këtë pjesë të vendimit gjyqësor. Në vlerësim të gjykatës, arsyeshëm lind dyshimi i bazuar në prova se faktet penale kanë ndodhur sikurse paraqiten.

Në vijim, Gjykata konstaton faktin se veprat penale për të cilat dyshohen personat nën hetim **Ardian Zykaj (alias Blerim Miftari), Alfredo Hamzai (alias Genc Bedini, alias Genci Tanasi), Adrian Rama, Orgest Birçaj, Orest Sota, Elton Memeti, Artur Shehu, Arben Ismailaj, Dritan Aga, Luçiano Koçeku (alias Artur Mersin Koçeku), Dino Koçeku (alias Abedin Koçeku), Ervin Koçeku, Astrit Vladi, Kastriot Vladi, Ilir Shtufi, Gëzim Islami, Leonard Bishaj, Edmond Jaupi, Besnik Myftari, Erjon Rama**, janë ato të parashikuara nga nenet 283/a, 287, 333/a dhe 334/1 të K.Penal (*Theksojmë se secili person nën hetim për veprat atribuuar atij dhe jo për të gjitha veprat në tërësi*). Nuk rezulton që këto vepra penale të jenë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale pasi personat të cilët dyshohen se kanë kryer këto vepra penale i kanë kryer ato në harkun kohor që në referim të nenit 66 të K.Penal nuk janë parashkruar, si dhe nuk rezulton që këto vepra të jenë

amnistuar, përkundrazi rezulton se politika penale e këtyre veprave penale është e rëndë dhe në fokusin e organeve ligjzbatuese dhe atyre të drejtësisë.

Në vështrim të kushtit të tretë, Gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat këta shtetas nuk mund të merren si të pandehur apo që të mund të dënohen, pasi personat nën hetim kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç, pasi veprat penale për të cilën ata dyshohen se kanë kryer janë krime. Nuk rezulton që personat nën hetim *Ardian Zykaj (alias Blerim Miftari), Alfredo Hamzai (alias Genc Bedini, alias Genci Tanasi), Adrian Rama, Orgest Birçaj, Orest Sota, Elton Memeti, Artur Shehu, Arben Ismailaj, Dritan Aga, Luçiano Koçeku (alias Artur Mersin Koçeku), Dino Koçeku (alias Abedin Koçeku), Ervin Koçeku, Astrit Vladi, Kastriot Vladi, Ilir Shtufi, Gëzim Islami, Leonard Bishaj, Edmond Jaupi, Besnik Myftari, Erjon Rama*, të jenë të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tyre mendore, gjithashtu Gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprës penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

Përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit, Gjykata duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë më konkretisht:

- *ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;*
- *largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;*
- *rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.*

Për caktimin e masave të sigurimit, Gjykata përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Këto kriteret përcaktojnë llojin e masës së sigurimit që duhet të marrë gjykata për rastet konkrete që ka në shqyrtim. *Kriteri i parë* është përshtatshmëria e masës së sigurimit me shkallën e nevojave të sigurimit që kërkohen në rastin konkret, pra sa më e madhe të jetë nevoja e sigurimit aq më e rëndë duhet të jetë masa e sigurimit që caktohet. *Kriteri i dytë* është ruajtja e një raportit të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së sigurimit, duke mbajtur parasysh dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga K.Penal. *Kriteri i tretë*: Kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete.

Në mbështetje të sa më sipër, Gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masave të sigurimit ndaj personave nën hetim *Ardian Zykaj (alias Blerim Miftari), Alfredo Hamzai (alias Genc Bedini, alias Genci Tanasi), Adrian Rama, Orgest Birçaj, Orest Sota, Elton Memeti, Artur Shehu, Arben Ismailaj, Dritan Aga, Luçiano Koçeku (alias Artur Mersin Koçeku), Dino Koçeku (alias Abedin Koçeku), Ervin Koçeku, Astrit Vladi, Kastriot Vladi, Ilir Shtufi, Gëzim Islami, Leonard Bishaj, Edmond Jaupi, Besnik Myftari, Erjon Rama*, është i nevojshëm pasi:

Në vlerësim të Gjykatës, ekziston rreziku, që për shkak të rrethanave të faktit sesi janë kryer veprat penale objekt hetimi në kuadër të procedimit penal nr. 287/1 të vitit 2021 të Prokurorisë së Posaçme ekziston mundësia për të ndodhur të gjitha kushtet e veçanta të parashikuara nga neni-228/3 të K.Penale: rreziku i ikjes/largimit; ekzistenca e shkaqeve që venë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, si dhe rreziku i kryerjes së krimeve të rënda ose të të njëjtit lloj me ato për të cilat po hetohet, për secilin nga personat nën hetim.

PO ashtu, Gjykata çmon se masa e sigurimit “*Arrest në burg*”, parashikuar nga neni 238 të Kodit të Procedurës Penale e kërkuar nga organi i akuzës në rastin objekt gjykimi ndaj personave nën hetim *Ardian Zyka (alias Blerim Miftari), Alfredo Hamzai (alias Genc Bedini, alias Genci Tanasi), Adrian Rama, Orgest Birçaj, Orest Sota, Elton Memeti, Artur Shehu, Arben Ismailaj, Dritan Aga, Luçiano Koçeku (alias Artur Mersin Koçeku), Dino Koçeku (alias Abedin Koçeku), Ervin Koçeku, Astrit Vladi, Kastriot Vladi, Ilir Shtufi*, dhe masa e sigurimit “*Arrest në shtëpi*”, parashikuar nga neni 237 të Kodit të Procedurës Penale, e kërkuar ndaj personave nën hetim *Gëzim Islami, Leonard Bishaj, Edmond Jaupi, Besnik Myftari, Erjon Rama*, janë të përshtatshme dhe të drejta pasi:

1. Për sa i përket personit nën hetim Adrian Rama, ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se ai është i përfshirë prej disa vitesh në veprimtari të trafikimit të lëndëve narkotike të llojit “kokainë” në nivel ndërnacional dhe ndërkontinental, duke qenë pjesë e grupeve kriminale që mundësojnë trafikim të lëndës narkotike nga vendet e Amerikës Latinë në drejtim të Evropës, veprimtari e cila gjeneron të ardhura të mëdha, parë kjo edhe në raport me investimet e bëra prej tij në zona me vlerë të madhe, përfshirë Tiranën (madje edhe vetë Kryeqytetin në zonë elitare) dhe bregdetin e Jugut. Këto ardhura nëpërmjet skemave të mirëmendura, të planifikuara, investohen nëpërmjet mekanizmave të ndryshme në tre format e pastrimit të parave, në bashkëpunim të veçantë në pasuri të paluajtshme, biznese dhe aktivitete.

Në vlerësim të veprave penale për të cilat ai dyshohet, rrezikshmërisë për shkak të dënimit të mundshëm për shkak të veprave të dyshuara, rrezikshmërisë që rezulton nga rrethanat konkrete të çështjes, si përfshirja në një veprimtari kriminale transnacionale/transkontinentale të trafikimit të narkotike dhe në atë të pastrimit të parave, apo ekzistenca e rrezikut real të ikjes dhe mundësisë reale për ta mundësuar këtë vlerësohet që masat e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” apo “arrest në shtëpi”, si dhe ndonjë nga masat e tjera me karakter shtrëngues e ndalues të parashikuara nga nenet 232 e 240 të K.Pr.Penale, nuk përmbushin nevojat e sigurimit dhe nuk janë proporcionale në këtë moment të procedimit penal. Kjo në vlerësim edhe të rrezikshmërisë së autorit rezultuar nga rrethanat konkrete të çështjes, mbi përfshirjen aktive të personit nën hetim në veprimtarinë kriminale të trafikimit të lëndëve narkotike, të ushtruar në mënyrë të organizuar dhe të vazhdueshme dhe në sasira të mëdha. Mënyra e kryerjes së veprës, përdorimi i strukturave organizative (madje bashkëpunimi i gjerë edhe me grupe të tjera kriminale), koordinimi ndërmjet pjesëmarrësve dhe qëllimi i përfitimit material evidentojnë një shkallë të lartë rrezikshmërie shoqërore dhe intensitet të veçantë të dashjes kriminale. Gjithashtu, përfshirja aktive e tij në pastrimin e të ardhurave që rrjedhin nga aktiviteti kriminal, duke investuar në pasuri të paluajtshme, të luajtshme e të tjera, mënyrës së kryerjes së tyre nëpërmjet skemave të sofistikuara, të planifikuara dhe mirëmenduar, pasojave që vijnë nga kjo veprimtari kriminale. Personi nën hetim ka lidhje me grupe kriminale që mundësojnë sigurimin e dokumentave të falsifikuara, fakti që nga komunikimet e

mjaftueshme për të provuar se ekzistencën e rrezikut të ikjes. Përfshirja në vite në këtë veprimtari tregon mundësinë reale të vijimit të aktivitetit kriminal, duke marrë në konsideratë natyrën e organizuar dhe vazhduese të veprimtarisë kriminale të evidentuar gjatë hetimeve dhe rrezik real për kryerje përsëri të të njëjtave veprave penale.

Masat alternative, si “detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, “garancia pasurore” apo “arrest në shtëpi”, apo ndonjë nga masat e tjera alternative me karakter shtrëngues e ndalues nuk janë proporcionale dhe të përshtatshme në vlerësimin të rëndësisë së faktit, rrethaneve konkrete të çështjes; dhe personalitetit të personit nën hetim dhe nuk garantojnë nevojat e sigurimit në drejtim të hetimit për sigurimin dhe vërtetësinë e provave.

15. Për sa i përket personit nën hetim Orest Sota vlerësohet përfshirja e tij në grupe kriminale që trafikojnë lëndë narkotike mënyra e kryerjes së veprës, përdorimi i strukturave organizative, koordinimi ndërmjet pjesëmarrësve dhe qëllimi i përfitimit material evidentojnë një shkallë të lartë rrezikshmërie shoqërore dhe intensitet të veçantë të dashjes kriminale. Përfshirja në pastrim të produkteve të veprës penale duke investuar në shoqëri tregtare mënyrës së kryerjes së tyre nëpërmjet skemave të sofistikuar, të planifikuara dhe mirëmenduara, pasojave që kanë ardhë nga kjo veprimtari kriminale, kohëzgjatja në kryerjen e veprës penale, përfshirja intensive e tij në veprimet e trafikimit të lëndësve narkotike në sasi të mëdha, pastrimit të parave e cila është e vazhdueshme dhe aktuale. Masat alternative, si “detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, “garancia pasurore” apo “arrest në shtëpi”, apo ndonjë nga masat e tjera alternative me karakter shtrëngues e ndalues nuk janë proporcionale dhe të përshtatshme në vlerësimin të rëndësisë së faktit, rrethaneve konkrete të çështjes; dhe personalitetit të personit nën hetim dhe nuk garantojnë nevojat e sigurimit në drejtim të hetimit për sigurimin dhe vërtetësinë e provave.

16. Për sa i përket personit nën hetim Dritan Aga ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se ai është i përfshirë prej disa vitësh në veprimtari të trafikimit të lëndëve narkotike të llojit “kokainë” në nivel transnacional dhe ndërkontinental, ai pjesë e grupeve kriminale që mundësojnë trafikimi nga vendet e Amerikës Latinë në drejtim të Evropës, veprimtari e cila gjeneron të ardhura. Këto ardhura nëpërmjet skemave të mirëmendura, të planifikuara, investohen nëpërmjet mekanizmave të ndryshme në tre format e pastrimit të parave, në bashkëpunim të vecantë në pasuri të paluajtshme, biznese dhe aktivitete.

Në vlerësim të veprave penale për të cilat ai dyshohet, rrezikshmërisë për shkak të dënimit, por rrezikshmërisë që rezulton nga rrethanat konkrete të çështjes, si përfshirja në një veprimtari kriminale transnacionale të trafikimit të narkotike duke udhëtuar dhe duke punuar në laboratore në Ekuador, tregon mbi rrezikshmëri të lartë shoqërore. Udhëtimi i tij nuk ka qenë i shkëputur, por ka ardhë si rezultat i njohjeve të hershme me pjesëtarët e grupit e provuar kjo edhe nga investimi që ai ka kryer në formën e dhurimit në emër të bashkëjetueses së tij të quajtur Erida tek “toka tek juvenilja”, duke patur kështu një përfshirje intensive brenda grupit kriminal. Ekzistenca e rrezikut real të ikjes dhe mundësisë reale për ta mundësuar këtë si pjesë e një rrjeti kriminal vlerësohet që masat e sigurimit “detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, apo “arrest në shtëpi” nuk përmbushin nevojat e sigurimit dhe nuk janë proporcionale. Kjo në vlerësim edhe të rrezikshmërisë së autoritet rezultuar nga rrethanat konkrete të çështjes, mbi përfshirjen aktive të personit nën hetim në veprimtarinë kriminale të trafikimit të lëndëve narkotike, e ushtruar në mënyrë të organizuar dhe të vazhdueshme.

Nevojat e sigurimit marrë parasysh të gjitha këto kritere të analizuara përmbushen vetëm nëpërmjet caktimit të masës së sigurimit "Arrest në shtëpi" marrë parasysh edhe gjendjen familjare të tij. Masat alternative, si "detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", "garancia pasurore" apo ndonjë nga masat e tjera alternative me karakter shtrëngues e ndalues nuk janë proporcionale dhe të përshtatshme në vlerësimin të rëndësisë së faktit, rrethanave konkrete të çështjes; dhe personalitetit të personit nën hetim dhe nuk garantojnë nevojat e sigurimit në drejtim të hetimit për sigurimin dhe vërtetësinë e provave.

Me masat e dhëna ndaj secilit prej personave nën hetim ruhet raporti i drejtë që ekziston ndërmjet rëndësisë së fakteve penale të përshkruar si më sipër, si dhe sanksionit të veprave penale të parashikuara në nenet përkatëse, ato të parashikuara nga nenet 283/a, 287 e 333/a të K.Penal, të cilat parashikojnë sanksione vetëm me burgim, duke qenë kështu vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe po ashtu vepra penale, në fushën e narkotikëve, trafikim, që është vepër me rrezikshmëri të lartë shoqërore, dhe krim ndërkufitar, si dhe ajo e pastrimit të parave në masë shumë të madhe, e cila madje kualifikohet si pasojë e rëndë, pasur në konsideratë vlerat e mëdha të investuara dhe integruara në ekonominë e vendit. Gjithashtu, Gjykata mban në konsideratë faktin se këta shtetas (*duke përjashtuar këtu shtetasit që nuk e kanë kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, z. Jaupi dhe z. Myftari*) e kanë kryer veprën penale në formën e bashkëpunimit të posaçëm, atë të "*Grupit të strukturuar kriminal*", duke rritur kështu rrezikshmërinë e personave që janë drejtues e pjesëmarrës dhe kryejnë vepra penale në formën e një formacioni me rrezikshmëri të konsiderueshme shoqërore. Pasur parasysh përcaktimet ligjore, konkretisht nenet 28, pika 4 të Kodit Penal, në lidhje me nenet 333/a dhe 334 të Kodit Penal, kuptohet se ligjvënësi, për shkak të rrezikshmërisë që paraqesin këto organizime të veçanta (*konkretisht "Grupi i strukturuar kriminal"*), për shkak se shtrihen në kohë, perfeksionohen e forcohen, duke shkelur nga njëra anë jo vetëm të drejtat dhe liritë e njerëzve, por cenojnë edhe sigurinë dhe rendin publik, duke u kthyer në kërcënim për ekzistencën e vetë shtetit të së drejtës, ka penalizuar vetë ekzistencën e këtyre organizimave, pa qenë nevojë që të kryejnë apo të provohet kryerja e ndonjë veprave penale nga ana e tyre.

Këto janë vepra penale formale, ku ligjvënësi për shkak të rrezikshmërisë potenciale ka kriminalizuar që në origjinë idenë apo përgatitjen për kryerjen e veprave penale nëpërmjet kësaj mënyre bashkëpunimi, duke përbërë vetë vepër penale këto organizime që kanë qëllime nga ato që përcaktohen në ligjin material penal. Nga ana objektive, për të qenë përpara këtyre veprave penale duhet të provohen elementët përkatës, por padyshim ajo që i kthen këto grupime në kriminale është synimi apo qëllimi i tyre për të kryer vepër ose vepra penale. Logjikisht është shumë e vështirë për organin procedues që të provojë apo të identifikojë grupin e strukturuar kriminal kur ai ende nuk ka kryer një vepër penale, megjithatë këto janë sfida që ndeshen e sheshohen rast pas rasti në çështje konkrete.

Me anë të veprës penale "*Grupi i strukturuar kriminal*", sipas nenit 333/a të K.Penal, ligjvënësi ka dashur që të mbrojë marrëdhëniet juridike që rrezikohen nga vetë ekzistenca e grupit të strukturuar kriminal, duke qenë kjo vepër penale për nga natyra formale e duke ndëshkuar ligjvënësi vetë faktin e ekzistencës se formacionit që ka për qëllim kryerjen e një ose më shumë veprave penale, me pasojë realizimin e përfitimit material ose jomaterial. Ndërkohë që në nenin 334/1 të K.Penal "*Vepra penale*

të kryera nga grupi i strukturuar kriminal”, parashikohet rrethana rënduese e kryerjes së veprës penale nga grupi i strukturuar kriminal dhe dënimi që i shtohet dispozitës përkatëse të kryer, kur vepra penale konkrete është kryer në bashkëpunim të posaçëm. Pra, këto dy dispozita ligjore kanë objekte krejt të ndryshme dhe pavarësisht se ligjvënësi ka zgjedhur që për efekt të sanksionit penal rrethanën cilësuese apo rënduese të kryerjes së veprës penale në bashkëpunim nga grupi i strukturuar ta paraqesë si dispozitë ligjore më vete, kjo mund të ishte integruar edhe në pjesën e posaçme të dispozitave konkrete penale, por që nuk përthith figurën e veprës penale “Grupi i strukturuar kriminal”.

Në tërësi, sipas rasteve të evidentuara (dhe sipas rasteve për personat nën hetim konkretë), në mënyrë të detajuar në pjesën e përshkrimit të rrethanave të fakteve dhe burimit të provave (ku është paraqitur edhe një analizë lidhur veprimet e kryera të cilat konfigurohen në veprime të kundërligjshme në shkelje të ligjit tonë penal material), Gjykata konstaton se në rastin objekt gjykimi, mënyra e organizimit të personave nën hetim në kuadër të trafikimit të lëndëve narkotike jo vetëm ndërkufitare në shtetet Evropiane por edhe ndërkontinentale (nga Amerika e Jugut në Evropë), gjithë mënyra e furnizimit, rrjeti i përdorur, mënyra e shpërndarjes, fakti se edhe pas dështimeve apo kapjeve të sasive të mëdha të lëndës narkotike, personat vijojnë të jenë të angazhuar në këtë veprimtari të kundërligjshme (aspekt kjo edhe e rrezikshmërisë së tyre), mënyra e sigurimit të lëndëve narkotike (duke përfshirë edhe prodhimin e saj nëpërmjet laboratorëve të vendosur në Evropë), lloji i lëndës narkotike (kokainë-një nga lëndët narkotike më të rrezikshme), të ardhurat e larta të siguruara dhe riinvestimi i tyre në lëndë narkotike në vijim dhe në pastrim të produkteve të tyre, tregojnë nivelin më të lartë të krimit të organizuar ndërkombëtar në fushën e lëndëve narkotike, të llojit “kokainë”. Po ashtu, mënyra e dërgimit të të ardhurave të përfuara nga veprimtaria e kundërligjshme dhe investimi i tyre në Shqipëri, në pasuri të patundshme, në zona elitare, Tiranë, bregdetin e Jugut (Palasë, Vuno, Himarë, Vlorë), lehtësia me të cilat ata sigurojnë sipërfaqe toke (madje në zona të gjelbërta dhe mundësia e tyre për të ndikuar tek autoritetet shtetërore për të hequr sipërfaqe të caktuara kullotë, etj., nga zonat e gjelbërta apo nga zona të tjera me rëndësi të caktuar), siguria e tyre në lejen që u jepen nga institucionet shtetërore për zhvillimin dhe ndërtimin, dyshimet për takime dhe lidhje me funksionarë të lartë të shtetit shqiptar (gjë që pasqyrohet jo vetëm në letërporositë e ardhura nga autoritetet e huaja, por edhe në mënyrën sesi flasin të pashqetësuar dhe të garantuar për të vijuar investimet e tyre këta shtetas, ku dukshëm kanë marrë apo marrin në vazhdim garanci nga instancat përgjegjëse shtetërore), mënyra e veprimit, duke krijuar shoqëri tregtare (të cilat tashmë kanë vite që operojnë në treg), dhe duke kaluar në nivelin më të lartë të integritetit të parave apo produkteve të veprimtarisë kriminale, krijon arsyeshem dyshimin se një nivel i tillë investimi dhe pastrimi i produkteve të veprimtarisë kriminale, sjellë edhe pasoja të rëndë, në konkurrencën e ndershme, lirinë e tregut, dhe tregun e lirë dhe të ndershem (ku çmimet si rregull duhet të vendosen nga oferta dhe kërkesa në treg për një mall të caktuar), në investimin në zona që duhet të gëzojnë një mbrojtje më të gjerë dhe investimet në to duhet të jenë të kontrolluara dhe të mirëkoordinuara nga shteti me qëllim edhe mbrojtjen e mjedisit (këtu për bregdetin e jugut).

Sa më sipër Gjykata, në vështrim të neneve 228, 229, 230, 237, 238 dhe 245 të K.Pr.Penale, çmon se kërkesa e Prokurorisë së Posaçme për caktimin si masë sigurimi ndaj personave nën hetim *Ardian Zyka* (alias *Blerim Miftari*), *Alfredo Hamzai* (alias *Gene Bedini*, alias *Genci Tanasi*), *Adrian*

*Rama, Orgest Birçaj, Orest Sota, Elton Memeti, Artur Shehu, Arben Ismailaj, Dritan Aga, Luçiano Koçeku (alias Artur Mersin Koçeku), Dino Koçeku (alias Abedin Koçeku), Ervin Koçeku, Astrit Vladi, Kastriot Vladi, Ilir Shtufi, atë të masës së sigurimit personale të "Arrestit në burg", parashikuar nga neni 238 të Kodit të Procedurës Penale, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale respektive, dhe për caktimin si masë sigurimi ndaj personave nën hetim **Gëzim Islami, Leonard Bishaj, Edmond Jaupi, Besnik Myftari, Erjon Rama**, atë të "Arrestit në shtëpi", parashikuar nga neni 237 të Kodit të Procedurës Penale, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale respektive, është e mbështetur në prova dhe në ligj, bazuar kjo në parimin e proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë së kufizimit të lirisë së personit, sanksionuar nga neni 5 të KEDNJ-së, si dhe parë në raport me nenet 17 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në përfundim Gjykata vendos pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme pasi ajo është e mbështetur në prova dhe në ligj dhe masat e sigurimit personale me karakter shtrëngues garantojnë më së miri nevojat e sigurimit, parë kjo në raport me rrezikshmërinë e veprave penale të dyshuara, rrezikshmërinë e personave të dyshuar që i kanë kryer këto vepra dhe sigurohet proporcionaliteti dhe përshtatshmëria në kufizimin e lirisë së personit.*

Duke vlerësuar në tërësi rëndësinë e çështjes dhe me qëllim garantimin e sekretit hetimor, bazuar në nenin 103 të K.Pr.Penale, Gjykata vendos ndalimin e publikimit tërësisht të këtij vendimi gjyqësor deri në përfundim të hetimeve të çështjes penale objekt shqyrtimi.

Për ekzekutimin e masave të sigurimit të ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Lidhur me të drejtën e ankimit, Gjykata bën me dije se, kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 (pesë) ditëve, nga njoftimi i vendimit të gjykatës.

V. Konkluzioni

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të neneve 228, 229, 230, 237, 238, 244 dhe 245 të K.Pr.Penale

VENDOSI:

I. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

1. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, "arrest në burg" parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Ardian Zykaj**, i biri i Zykë dhe Selvi, i datëlindjes 16.08.1970, me nr. personal H00816134J, lindur në Vlorë dhe banues në rrugën "Llazar Pulluqi", nd. 11, h. 1, ap. 10, NjA 5, Tiranë, me gjendje civile beqar, me një fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, *alias* **Blerim Miftari**, datëlindja 02.02.1974, me kartë identiteti Kosovare me nr. ID0546115 dhe pasaportë Kosovare me nr. P00815094, i dyshuar për kryerjen e veprave penale "Trafikimi i

narkotikëve”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë, të grupit të strukturuar kriminal, “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

2. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Alfredo Hamzaj**, i biri i Sali dhe i Dallandyshe, lindur më 19.06.1972, në Vlorë, me nr. personal H20619083S, lindur në Vlorë dhe banues në Rrugën Demokracia, nd. 001, Vlorë, me gjendje civile i divorcuar, me dy fëmijë, me gjendje gjyqësore i dënuar (jashtë Shqipërisë), *alias Genc Bedini*, dtl. 17.11.1974 me numër dokumenti kosovar ID1547638 dhe numër pasaporte P01644289, *alias Genci Tanasi*, dtl. 13.08.1972, me numër personal 1408972450130 dhe numër pasaporte të Maqedonisë së Veriut K1187590, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal.
3. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Adrian Rama**, i biri i Besnik dhe Drita, i datëlindjes 26.08.1983, lindur në Tiranë dhe banues në rrugën “*Abdyl Prashku*”, h.1, nd. 1814, ap. 19, Tiranë, me nr. personal I30826059T, me gjendje civile i divorcuar, pa fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/1, 334/1 të Kodit Penal.
4. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Orgest Birçaj**, i biri i Fatosh dhe i Filoreta, i datëlindjes 15.05.1983, lindur në Vlorë dhe banues në rrugën “*Mevlan Halim Dervishaj*”, nd. 33, h.1, Vlorë, me nr. personal I30515124P, me gjendje civile beqar, me një fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/2 e 334/1 të Kodit Penal.

5. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Orest Sota**, i biri i Lefter dhe i Antoneta, i datëlindjes 04.01.1992, lindur në Vlorë dhe banues në rrugën “Grigor Heba”, nd. 1831, në Tiranë, me nr. personal J20104040Q, me gjendje civile beqar, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.
6. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Elton Memeti**, i biri i Gjergji dhe Floresha, i datëlindjes 17.07.1984, lindur në Tepelenë dhe banues në rrugën “Naim Frashëri”, nd. 60, h. 3/5, ap. 21, NjA 7, Tiranë, me nr. personal I40717083O, me gjendje civile beqar, pa fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.
7. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Artur Shehu**, i biri i Ramis dhe Enise, i datëlindjes 29.07.1966, lindur në Vlorë dhe banues në SHBA, me nr. personal G60729063O, shtetas shqiptar dhe i pajisur me pasaportë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal.
8. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Arben Ismailaj**, i biri i Kadri dhe i Sefire, lindur më 13.08.1963, lindur në Vlorë dhe banues në rrugën “Ymer Rahima”, nd. 19, h. 5, ap. 5, Vlorë, me numër personal G30813102F, me gjendje civile i martuar me dy fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar*

kriminal” dhe “ *Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*” parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

9. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Dritan Aga**, i biri i Dalip dhe i Ruzhdies, i datëlindjes 11.11.1981, lindur në Tiranë dhe banues në rrugën “Pjetër Budi”, nd. 19, h. 4, Ap. 26, NjA 2, Tiranë, me nr. personal I11111036A me gjendje gjyqësore beqar, me dy fëmijë të mitur, me gjendje gjyqësore i dënuar më parë, *Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “ *Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

10. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Luçiano Koçeku alias Artur Mersin Koçeku**, i biri i Mersim dhe i Sulltane, i datëlindjes 25.01.1982, me numër personal I20125096T, lindur në Bulqizë, Dibër dhe banues në rrugën “Erisa Fatmir Poleshi”, Nd 83, H.1, Paskuqan, 1047, Kamëz, me gjendje civile beqar, me tre fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për veprat penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “ *Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

11. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Dino alias Abedin Koçeku**, i biri i Mersim dhe i Sulltane, i datëlindjes 18.04.1975, me numër personal H50418100F, i lindur në Fushë -Lurë dhe banues në rrugën “Abdyl Elmazi”, Nd 174, H.1, Paskuqan, 1047”, Kamëz, me gjendje civile i divorcuar, me fëmijë, me gjendje civile i martuar, me shtetësi shqiptare, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “ *Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

12. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Ervin Koçeku**, i biri i Mersim dhe i Sulltane, i datëlindjes 24.02.1986, me numër personal I60224104R, lindur në Bulqizë, Dibër dhe banues në rrugën “Erisa Fatmir Poleshi”, Nd 85, H.1, Paskuqan, 1047, Kamëz, me gjendje civile i martuar me tre fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë i dyshuar

për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë, të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

13. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Astrit Vladi**, i biri i Shaqir dhe i Mendie, i datëlindjes 17.05.1976, me numër personal H60517084R, lindur në Armollë dhe banues në rrugën “Migjeni”, nd 16, H1, Njësia Administrative nr 11, 1026, Tiranë, me gjendje civile i martuar me dy fëmijë, aktualisht i arrestuar për llogari të një procedimi tjetër, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.
14. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Kastriot Vladi**, i biri Shaqir dhe i Mendie, i datëlindjes 18.04.1986, me numër personal I60418022I, lindur në Fushë-Luë Dibër dhe banues në rrugën “Ilia Plasa”, Nd 13; H 1, Njesia Admisnitrative nr 11; 1029, Tiranë, me gjendje civile i martuar, me gjendje i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.
15. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Ilir Shtufi**, i biri i Xhemal dhe i Zonjë, i datëlindjes 13.10.1973, me numër personal H31013090C, lindur në Tiranë dhe banues në adresën rruga “Kajo Karafili”, nd .14, hyrja 2 apt 53, Njësia Administrative nr. 10, Tiranë, me gjendje civile i martuar, me fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë; i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.
16. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në shtëpi*” parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Gëzim Islami**, i biri i Vehap dhe i Qete, i datëlindjes 15.04.1963, me numër personal G80415340L, i lindur në Herbel, Dibër dhe banues me adresë “Koli Bano”, Nd 15, H.1, Ap 1, Njësia Administrative nr. 11, 1026, Tiranë, me gjendje civile i martuar me fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar

më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

16.1. Urdhërimin e personit nën hetim **Gëzim Islami**, që të mos largohet nga banesa e tij në: adresë “Koli Bano”, Nd 15, H.1, Ap 1, Njësia Administrative nr. 11, 1026, Tiranë.

17. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në shtëpi*” parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Leonard Bishaj**, i biri i Ferik dhe Drite, datëlindja 24.03.1969, lindur në Vlorë dhe banues në rrugën “Murat Tërbaçi”, nd. 73, h.3, ap. 19, Vlorë, me nr. personal G90324083R, me gjendje civile i martuar me dy fëmijë madhorë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

17.1. Urdhërimin e personit nën hetim **Leonard Bishaj**, që të mos largohet nga banesa e tij në: rrugën “Murat Tërbaçi”, nd. 73, h.3, ap. 19, Vlorë.

17.2. Personi nën hetim nuk duhet të vendosë kontakte me persona me të cilët ka kryer veprime si përfaqësues i personit nën hetim Artur Shehu apo me noterë.

18. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në shtëpi*” parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Edmond Jaupi**, i biri i Sami dhe Pëllumbesh, datëlindja 21.09.1975, lindur në Tepelenë dhe banues në rrugën “Bajram Curri”, p. 23-1-1, nd. 034, NjA 5, Tiranë, me gjendje civile i martuar, me dy fëmijë madhorë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*” kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenet 287/3 të Kodit Penal.

18.1. Urdhërimin e personit nën hetim **Edmond Jaupi**, që të mos largohet nga banesa e tij në: rrugën “Bajram Curri”, p. 23-1-1, nd. 034, NjA 5, Tiranë.

19. Caktimin e masës së sigurimit personale me karakter shtrëngues, “*arrest në shtëpi*” parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale, **ndaj personit nën hetim Besnik Myftari**, i biri i Haziz dhe i Hatixhe, i datëlindjes 14.04.1968, me nr. personal G80414170N, lindur në Tiranë dhe banues në rrugën “Ismail Qemali”, nd. 18, h. 3, ap. 10, NjA 5, Tiranë, me gjendje civile i martuar, me tre fëmijë, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë parashikuar nga neni 287/3 të Kodit Penal.

19.1. Urdhërimin e personit nën hetim **Besnik Myftari**, që të mos largohet nga banesa e tij në: rrugën “Ismail Qemali”, nd. 18, h. 3, ap. 10, NjA 5, Tiranë.

BESNIK dhe Drita, i datimitjes 08/03/2026
Ishmi”, nd. 20, h. 1, NjA 2, Tiranë, me nr. personal I60305071N, me gjendje civile beqar, me një fëmijë të mitur, me gjendje gjyqësore i padënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”, kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal, “Grup i strukturuar kriminal” dhe “Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 287/1 e 28/4, 333/a/2, 334/1 i Kodit Penal.

20.1. Urdhërimin e personit nën hetim **Erjon Rama**, që të mos largohet nga banesa e tij në: rrugën “Shyqyri Ishmi”, nd. 20, h. 1, NjA 2, Tiranë.

20.2. Personi nën hetim nuk duhet të vendosë kontakte me persona me të cilët ka kryer operacione tregtare në drejtim të pasurive të paluajtshme, të luajtshme apo shoqërive tregtare të lidhura me ato të vëllait të tij apo personit nën hetim Elton Memeti.

II. Për ekzekutimin e masave të sigurimit ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

III. Bazuar në nenin 103 të K.Pr.Penale, ndalimin e publikimit tërësisht të këtij vendimi gjyqësor deri në përfundim të hetimeve të çështjes penale objekt shqyrtimi.

IV. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 (pesë) ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të gjykatës ose nga e nesërmja e marrjes dijeni për të.

U shpall në Tiranë, sot më datë 10 qershor 2026!

GJYQTARE
FLOJERA DAVIDI
